

**ZBATUESHMËRIA E LIGJIT PËR MASA
NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET
FAMILJARE**

Mirënjohje

Ky raport studimor u mbështet nga projekti PACEP financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe zbatuar nga Instituti Demokratik Amerikan (NDI)

Raporti është pasuruar nga mendimet dhe rekomandimet e praktikuesve të Ligjit për Masa ndaj Dhunës në Familje dhe studiuesve të ndyshëm të cilët u konsultuan veçanërisht Prof. Dr. Aurela Anastasi, Prof. Dr. Vasilika Hysi dhe Dr. Elona Gjebrea. Ndhimesë të vyer në koordinimin e punës dha Instituti Parlamentar i Kuvendit të Shqipërisë.

Author

Mirela Arqimandriti, eksperte per çështje të barazisë gjinore

Shkurtime

AMA	Autoriteti i Mediave Audiovizive
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BE	Bashkimi Evropian
BGJ	Barazia Gjinore
CEDAË	Komiteti mbi eliminimin e diskriminimit të grave
COVID-19	Sëmundja Koronavirus
DHBGJ	Dhuna me bazë gjinore
DHF	Dhuna në familje
DHNG	Dhuna ndaj Grave
FSHDKPAK	Fondacioni shqiptar për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar
GREVIO	Grupi i ekspertëve për veprim kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje
KS	Konventa e Stambollit
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
INSTAT	Instituti i Statistikave
IP	Instituti Parlamentar
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
LDHF	Ligji për dhunën në familje
LGBT	Lezbike, gay, biseksuale dhe transgjinore
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NBGJ	Nëpunës i barazisë gjinore
NDI	Instituti Kombëtar Demokratik
NJVV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJQ	Organizata joqeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
REVALB	Sistemi elektronik i regjistrimit dhe i ruajtjes së të dhënave për rastet e dhunës në familje pranë njësisë vendore
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SKA	Strategjia Kombëtare e Arsimit
SKBGJ	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore
UN	Enti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Tabela e Përmbajtjes

MIRËNJOHJE	2
SHKURTIME	3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	5
HYRJE.....	8
METODOLOGJIA.....	10
KUFIZIME TË KËTIJ RAPORTI	11
SEKSIONI I – SITUATA E DHUNËS NË FAMILJE DHE DHUNËS ME BAZË GJINORE NË SHQIPËRI	12
PERCEPTIMET.....	12
PREVALENCA (PËRHAPJA).....	13
SEKSIONI II - KUADRI LIGJOR DHE STRATEGJIK NË LUFTËN KUNDËR DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE	18
PARANDALIMI	18
MBROJTJA.....	24
NDJEKJA PENALE	29
POLITIKAT E INTEGRUARA	36
SEKSIONI III. NDËRSEKTORIALITETI I DHUNËS: NJË ANALIZË E ÇËSHITJEVE NDËRSEKTORIALE QË LIDHEN ME DHF 40	
GRATË ME AFTËSI TË KUFIZUARA	40
GRATË ROME E EGJIPTIANE.....	42
GRATË LESBIKE, BISEKSUALE, TRANS APO TJETËR	43
SEKSIONI IV - REAGIMI INSTITUCIONAL NDAJ DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE	44
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE SI INSTITUCION KOORDINUES.....	45
POLICIA SI PIKA E PARË E KONTAKTIT	47
SISTEMI I DREJTËSISË.....	51
INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE PËR ARSIMIN, PUNËSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL	54
MEKANIZMAT VENDORË	55
SEKSIONI V – STRATEGJIA KOMBËTARE PËR BARAZINË GJINORE: NJË VIT ZBATIM	59
SEKSIONI VI - ANALIZË KRAHASUESE E KUADRI LEGJISLATIV DHE PRAKTIKËS SË MIRË TË VENDEVE TË TJERA....	65
REKOMANDIME	71
ANEKSE	74
LISTA E PERSONAVE TË INTERVISTUAR:.....	74
LISTA E PLOTË E LIGJEVE DHE POLITIKAVE NË LIDHJE ME DHUNËN ME BAZË GJINORE	75
REFERENCA DHE BIBLIOGRAFI.....	78

Përmbledhje Ekzekutive

Dekadën e fundit Shqipëria ka ndërmarrë hapa të konsiderueshëm për të përmirësuar kuadrin ligjor dhe institucional për parandalimin dhe adresimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Është për t'u vlerësuar dhe shënuar se përpjekjet për ofrimin e mekanizmave mbrojtës kanë qenë në përmirësim ndër vite dhe raportimi i dhunës nga vetë gratë e vajzat është në rritje. Kuadri ligjor dhe ai i politikave është gjerësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kërkesat e konventave në të cilat Shqipëria është palë. Në mënyrë që përgjigja ndaj këtij fenomeni, që ende mbetet shumë shqetësues në Shqipëri, të jetë efikase, është e rëndësishme të vijohet me përpjekje për të përmirësuar e forcuar kuadrin ligjor, por mbi të gjitha duhet përmirësuar institucionalizimi i shërbimeve në terren nga institucionet përgjegjëse.

Kjo analizë fokusohet në zbatueshmërinë e Ligjit për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare, i ndryshuar (LDHF nga tani e tutje në këtë dokument), i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2006, në sajë të përpjekjeve të organizatave të shoqërisë civile në mbrojtje të të drejtave të grave, të cilat mblodhën 20.000 firma qytetarësh për ta sjellë ligjin në Kuvendin e Shqipërisë. Në këtë analizë diskutohen gjerësisht masat ligjore aktuale dhe përgjigja institucionale ndaj dhunës me bazë gjinore dhe identifikohen masa që mund të merren për adresimin sa më efikas të këtij fenomeni me pasoja të rënda për familjen dhe shoqërinë shqiptare. Nga analiza del qartazi se parandalimi i dhunës ndaj grave dhe vajzave është punë e të gjithëve. Ajo nuk mund të adresohet nga një institucion i vetëm. Një përgjigje e koordinuar dhe ndër-institucionale që përfshin organizatat qeveritare, shoqërinë civile, komunitetin, shkollën, biznesin dhe median është qasja thelbësore për identifikimin e viktimave, referimin e suksesshëm dhe ofrimin e shërbimeve, si dhe për zbatimin e nismave efektive për të parandaluar dhunën ndaj grave e vajzave dhe rritjen e mundësive për viktimat për të kërkuar dhe aksesuar mbështetje.

Disa nga gjetjet kryesore të kësaj analize në nivel strategjik janë:

Në lidhje me kuadrin ligjor:

1. Kuvendi i Shqipërisë duhet të forcojë kontrollin parlamentar në lidhje me rolin e organeve që duhet të zbatojnë ligjin për dhunën me bazë gjinore dhe ligjin e barazisë gjinore.
2. Megjithëse në nenin 6 pika ç, teksti i LDHF specifikon organizimin e trajnimeve për parandalimin dhe trajtimin e çështjeve të dhunës në familje, ai nuk specifikon shpeshësinë e trajnimit që Konventa e Stambollit (KS) e kërkon të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm.
3. Ndërsa strategjia e barazisë gjinore përfshin OJF-të e grave në mesin e partnerëve zbatues për aktivitete ndërgjegjësuere, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut mungojnë në listë. Këto institucione duhet të përfshihen si partnerë për pjesën tjetër të periudhës së zbatimit të SKBGJ 2021-2030.
4. Megjithëse mediat mund të luajnë një rol kyç në adresimin e dhunës me bazë gjinore, ato nuk përfshihen shprehimisht në LDHF. Ndërsa SKBGJ 2021-2030 rendit

- mediat si partnere në zbatimin e disa aktiviteteve, ende nuk ka një strategji të vendosur për t'u angazhuar me median dhe sektorin privat. LDHF dhe VKM-ja 327 për funksionimin e MKR-ve nuk i referohen mediave apo sektorit privat.
5. LDHF nuk e specifikon aksesueshmërinë e informacionit për viktimat në një gjuhë që ato e kuptojnë sikurse kërkohet në Konventën e Stambollit.
 6. LDHF, që në emërtim të tij, është kufizues dhe fokusohet kryesisht në dhunën në marrëdhëniet familjare, duke lënë jashtë fushëveprimin forma të tjera të dhunës së përjetuar, si përndjekja, dhuna kibernetike, dhuna nga individë që nuk kanë lidhje me familjen, që do të thotë se shërbimet, ndërkohë që nuk janë të ndaluara shprehimisht, nuk janë gjithashtu shprehimisht të disponueshme për personat që i kanë mbijetuar këtyre formave të dhunës.
 7. LDHF nuk parashikon lirinë e personit që raporton dhunë që të zgjedhë një oficer policie të gjinisë që dëshiron sikurse e kërkon Konventa e Stambollit.
 8. Duke marrë parasysh kufizimet në kohë, burime materiale, transportin, etj. të koordinatorit vendor kundër dhunës, do të kishte qenë më efikase që policia të monitoronte zbatimin e urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes.
 9. Urdhret e mbrojtjes siç parashikohen në LDHF, ende nuk mbulojnë viktimat e formave të tjera të dhunës.
 10. Pavarësisht ekzistencës së LDHF, duke marrë parasysh sfidat specifike me të cilat përballen gratë me aftësi të kufizuara, do të ishte më e përshtatshme që te ligji për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, dhuna ndaj grave e vajzave me aftësi të kufizuara të përfshihej si një parim më vete pasi nuk mund të përafrohet me asnjë nga parimet e tjera të të artikuluar në nenin 4 të këtij ligji.
 11. Megjithëse LDHF parashikon një autoritet koordinues për zbatimin e ligjit, në parashtrimin e detyrave të këtij institucioni nuk përshkruhen pothuajse aspak çfarë dhe si do të bëhet koordinimi dhe cilat do të jenë detyrat koordinuese të këtij institucioni. Gjithashtu nuk parashikohen masa që duhet të marrin institucionet e tjera përgjegjëse për të luajtur rolin e tyre në këtë mekanizëm të koordinuar në nivel qendror.
 12. Në LDHF nuk parashikohet asnjë nga autoritetet përgjegjëse për zbatimin e tij të mbledhë dhe publikojë të dhëna që kanë të bëjnë me dhunën me bazë gjinore. LDHF nuk parashikon një rol për Institutin e Statistikave.
 13. LDHF grupon institucionet arsimore dhe institucionet përgjegjëse për punësimin në një dhe parashikon pak detyra dhe përgjegjësi për to.
 14. E gjithë gama e informacionit dhe të dhënave që mund të vihen në dispozicion ende nuk përdoret mjaftueshëm dhe nuk ka një sistem apo bazë të dhënash të centralizuar për mbledhjen dhe publikimin e të dhënave, prandaj nevojitet më shumë harmonizim për shfrytëzimin e plotë të të dhënave.

Në lidhje me përhapjen dhe perceptimet për dhunën me bazë gjinore:

15. Normat dominante shoqërore në Shqipëri ende justifikojnë sjellje që mundësojnë dhunën ndaj grave dhe vajzave.

16. Vajzat dhe gratë nga grupe të marginalizuara, si për shembull vajza dhe gra me aftësi të kufizuara, nga komuniteti Rom dhe Egjiptian apo gra dhe vajza nga komuniteti LGBT, përjetojnë forma të shtuara të dhunës për shkak të situatës së tyre.
17. Raportimi i dhunës me bazë gjinore, edhe pse është në rritje vitet e fundit, është ende i ulët. Arsyet kryesore lidhen me normat shoqërore që dekurajojnë 'prishjen' e familjes, me mosbesimin të institucionet përgjegjëse dhe me mungesën e njohurive mbi shërbimet dhe mekanizmat në dispozicion për të raportuar dhe marrë mbështetje.

Në lidhje me përgjigjen institucionale ndaj dhunës me bazë gjinore:

18. Jo të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e kuadrit ligjor kundër dhunës me bazë gjinore i kanë përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.
19. Ministritë e linjës dhe institucionet e tjera nuk raportojnë sipas standardeve të kërkuara gjatë përgatitjes së raporteve për mekanizmat ndërkombëtarë dhe në shumicën e rasteve nuk shoqërojnë aktivitetet e kryera me buxhete specifike, gjë që e bën të vështirë raportimin e treguesve në SKBGJ 2021-2030.
20. Edhe pse mekanizmat e referimit në nivel vendor janë ngritur në të gjitha bashkitë e vendit, jo të gjitha funksionojnë në mënyrë efikase dhe jo të gjitha i kanë parashikuar burimet e nevojshme financiare dhe njerëzore për adresimin e rasteve të dhunës.
21. Nevojitet koordinim më i mirë ndërmjet aktorëve vendorë, veçanërisht ndërmjet policisë dhe koordinatorit vendor të DhF si dhe rol më aktiv i prokurorisë, zyrës së përmbartimit dhe anëtarëve të tjerë të MKR-së. Koordinimi mund të përmirësohet edhe në nivel qendror, gjë që mund të lehtësojë dhe përmirësojë koordinimin e institucioneve të nivelit vendor brenda mekanizmave të referimit.

Përgjatë raportit do të ofrohen analiza më të detajuara të kornizës ligjore dhe veprimeve që institucione të ndryshme kanë ndërmarrë në përmbushje të rolit të tyre si dhe do të rekomandohen hapa të nevojshëm për t'u zbatuar në praktikë.

Hyrje

Dhuna me bazë gjinore dhe çdo formë tjetër e dhunës ndaj grave ka qenë një sfidë shoqërore për dekada të tëra, megjithatë ajo doli edhe më shumë në pah gjatë pandemisë COVID-19 kur për shkak të niveleve të rritura të raportimit, Kombet e Bashkuara (OKB) e etiketuan atë si “*pandemia në hije*”. Dhuna me bazë gjinore prek kryesisht gratë dhe vajzat në mbarë botën dhe në Shqipëri. Vlerësimet e publikuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) tregojnë se rreth 1 në 3 (30%) gra në mbarë botën kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri intim ose dhunë seksuale nga jo partneri gjatë jetës së tyre.¹ Ndërsa të dhënat e Institutit të Statistikave (INSTAT) për Shqipërinë tregojnë se në tërësi, rreth 1 në 2 gra, ose 52,9 % e grave pohojnë se kanë përjetuar të paktën një herë dhunë gjatë jetës së tyre dhe 36,6 % pohojnë se aktualisht janë duke përjetuar dhunë.² Format më të shpeshta të dhunës janë përjetuar dhe përjetohen gjatë një lidhjeje dashurie ose në familje dhe ushtrohen nga partneri intim.

Të dhënat fillestare mbi ndikimin e pandemisë COVID-19 në mirëqenien e grave treguan se “stimujt socio-ekonomikë që shkaktojnë stres, si punësimi si dhe stimujt të jashtëm si pasiguria ushqimore dhe marrëdhëniet familjare kanë një ndikim të rëndësishëm, jo vetëm në përvojat e dhunës apo ndjenjat e sigurisë, por gjithashtu mbi mirëqenien e grave në përgjithësi”.³ Vetë Bashkimi Evropian (BE) ka njohur praninë e dhunës ndaj grave dhe vajzave në shtetet e tij anëtare dhe ka ndërmarrë një hap të rëndësishëm me Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit)⁴, fuqiptotë për të parandaluar dhe luftuar çdo formë të dhunës ndaj grave, duke propozuar direktivën e Parlamentit Evropian dhe Këshillit për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Me miratimin dhe marrjen e masave për funksionimin e plotë të këtij dokumenti, çdo vend anëtar i BE apo aspirant ka një armë të rëndësishme në luftën kundër dhunës me bazë gjinore.

Shqipëria është në pararojë sa i përket përpjekjeve për të hartuar një kuadër ligjor dhe politikash kundër dhunës me bazë gjinore, për të angazhuar institucione dhe burime njerëzore e materiale për t’iu pëgjigjur dhunës me bazë gjinore e mbrojtur viktimat e saj. Megjithatë, të dhënat statistikore tregojnë se kërkohet shumë punë sidomos për parandalimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e grave e vajzave të mbijetuara nga dhuna e ushtruar ndaj tyre.

¹World Health Organization, 2021. Online: <https://ëëë.ëho.int/neës-room/fact-sheets/detail/violence-against-ëomen>

²Instituti i Statistikave i Shqipërisë, 2022. Gratë dhe Burrat në Shqipëri, 2021. Online: <http://ëëë.instat.gov.al/media/8713/burra-dhe-gra.pdf>

³UN Ëomen. 2021. Measuring the Shado@ Pandemic: Violence Against Ëomen during COVID-19. Albania Country Report. Online: <https://albania.unëomen.org/sites/default/files/2022-03/Measuring-shadoë-pandemic-Albania.pdf>

⁴Këshilli i Evropës. Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit). Online: <https://rm.coe.int/168046246b>

Ky raport u ndërmor me kërkesën e Institutit Parlamentar Shqiptar - strukturë e Kuvendit të Shqipërisë - me mbështetjen e Projektit PACEP financiar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) zbatuar nga Instituti Demokratik Amerikan (NDI).

Raporti është i ndarë në seksione. **Seksioni i parë** i raportit parashton përhapjen dhe perceptimet mbi dhunën me bazë gjinore në Shqipëri, për të vendosur në kontekst analizën pasardhëse ligjore dhe të zbatueshmërisë. **Seksioni i dytë** analizon kuadrin ligjor shqiptar bazuar në katër shtyllat kryesore të Konventës së Stambollit. **Seksioni i tretë** analizon dhunën me bazë gjinore me një qasje ndërsektoriale duke u fokusuar në parimin e gjithëpërfshirjes dhe natyrës së dhunës me bazë gjinore për grupe specifike të popullsisë. **Seksioni i katërt** paraqet gjetjet e kësaj analize sa i përket zbatueshmërisë së legjislacionit nga institucionet përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor. **Seksioni i pestë** fokusohet në zbatimin e deritanishëm të Strategjisë Kombëtare për Barazi Gjinore (2021-2030). **Seksioni i gjashtë** ofron një sërë modelesh dhe praktikash nga vende të tjera të cilat mund të ndihmojnë në përmirësimin e kuadrit ligjor shqiptar. **Së fundi**, raporti përmbillet me një sërë rekomandimesh drejtuar ligjvënësve dhe institucioneve që kanë përgjegjësinë të zbatojnë legjislacionin në fushën e luftës kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Metodologjia

Shqipëria ka një legjislacion për mbrojtjen nga dhuna në marrëdhëniet familjare që prej vitit 2006 i cili i është nënshtruar rishikimeve dhe ndryshimeve në vitet 2008, 2010, 2018 dhe 2020. Ky ligj asnjëherë nuk ka ndryshuar tërësisht dhe nuk është rishikuar siç do të ishte e udhës, por ka pësuar ndryshime pjesore. Ndryshimet në ligj e përforcuan përgjigjen ndaj fenomenit të dhunës dhe sollën forma të reja të mbrojtjes së grave e vajzave viktime të dhunës në marrëdhëniet intime. Megjithatë, ky studim por edhe të tjerë⁵ të realizuar për të matur nivelin e dhunës ndaj grave e vajzave dhe të dhënat rreth zbatimit të kornizës ligjore dhe rasteve të trajtuara në gjykatë tregojnë se akoma ka shumë punë përpara si për zbatueshmërinë e kuadrit ligjor kundër dhunës ndaj grave e vajzave, ashtu edhe në nevojën për përmirësim të kuadrit ligjor dhe politikave.

Më specifikisht, ky studim përpiqet t'u përgjigjet pyetjeve të mëposhtme kërkimore:

- Në cilën masë Ligji për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare është zbatuar nga institucionet të cilat përmenden specifikisht me detyra të veçanta në këtë ligj?
- Cilat janë sfidat që hasin institucionet përgjegjëse në zbatimin e legjislacionit për dhunën ndaj grave/dhunën në familje?
- Cilat janë praktika të mira prej të cilave mund të përmirësohet kuadri ligjor kundër dhunës me bazë gjinore?
- Sa i plotë është kuadri ligjor në adresimin e dhunës me bazë gjinore?

Për t'u përgjigjur këtyre pyetjeve kërkimore, nga muaji korrik deri në muajin tetor 2022, hulumtimi përfshiu disa metoda studimore, duke përfshirë rishikimin e kuadrit ligjor dhe të politikave, vëzhgimin e përgjigjes institucionale ndaj dhunës me bazë gjinore, kërkime bazuar në studime të të tjerëve, intervista, anketa dhe rishikim të të dhënave statistikore.

Së pari, një rishikim i thellë i kuadrit ligjor dhe atij të politikave shqyrtoi ligjin dhe politikën shqiptare në lidhje me katër shtyllat e Konventës së Stambollit: Parandalimi; Mbrojtja; Ndjekja penale dhe Politikat e integruara. Gjithashtu aspekte të rëndësishme në lidhje me *Acquis Communautaire* të Bashkimit Evropian (BE) dhe Planin e Veprimit për barazinë gjinore, u rishikuan. Studimi përpiqet të identifikojë çdo ndryshim ende të nevojshëm në kuadrin ligjor në fuqi.

Së dyti, u shqyrtua literatura ekzistuese dhe të dhëna të disponueshme nga studime të ndryshme të realizuara nga studiues të tjerë si dhe rishikim i të dhënave statistikore për të identifikuar praktikatat e mira, të dhëna në nivele ndërkombëtare, studime që mbështetën rishikimin e kuadrit ligjor dhe seksione të tjera të raportit si dhe kërkime në lidhje me dhunën ndaj grave dhe vajzave.

⁵ Shih QDNJD, Studim, "Sistemi gjyqësor si pararendës në mbrojtjen e të drejtave të viktimeve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje", Tiranë 2021, <https://ëëë.hrdc.al/index.php/al/sherbime/studime>

Së treti, kërkesa për të dhëna dhe informacione u janë dorëzuar të gjitha institucioneve të përmendura në Ligjin për Masat Kundër Dhunës në Marrëdhëniet Familjare dhe janë shqyrtuar dhe analizuar të gjitha të dhënat statistikore të disponueshme publikisht dhe/ose të marra përmes kërkesave për informacion. Analiza e të dhënave synonte të shqyrtonte tendencat me kalimin e kohës në lidhje me raportimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore.

Së katërti, u zhvilluan intervista të thelluara me aktorë përkatës, duke përfshirë ekspertë ligjorë dhe gjinorë, zyrtarë publikë dhe organizata të shoqërisë civile, që punojnë për barazinë gjinore dhe luftën kundër dhunës me bazë gjinore. Intervistat u përpoqën të mbështesnin gjetjet nga analiza ligjore, hulumtimi, mbledhja e të dhënave dhe burime të tjera.

Së pesti, një anketë u administrua në dy institucione kyçe të identifikuara në ligj. Kjo anketë iu drejtua nëpunësve gjinorë dhe koordinatorëve kundër dhunës në familje si dhe punonjësve të policisë së shtetit shqiptar. Për këtë u përgatit një pyetësor i cili u nda përmes emaileve me një grup të selektuar të punonjësve të policisë shqiptare dhe me koordinatorët lokalë të dhunës në familje në të gjitha bashkitë e Shqipërisë. Pyetësori kishte për qëllim të maste nivelin e njohjes së përgjegjësive të tyre dhe ligjin si dhe perceptimet e tyre për sfidat me të cilat përballëshin në kryerjen e detyrave të tyre.

Kufizime të këtij raporti

Mbledhja e të dhënave parësore për këtë raport u krye për 3 vitet e fundit, veçanërisht që prej fillimit të pandemisë COVID-19, ndaj nuk mund të bëhen krahasime në periudha më të gjata kohore për të parë ndryshimet përkatëse ligjore dhe përgjigjet institucionale. Më tej, mbledhja e të dhënave institucionale dhe statistikave varet nga përgjigjet e këtyre të fundit që nuk janë gjithnjë të plota ose nuk mbledhen.

Seksioni I – Situata e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në Shqipëri

Ky seksion paraqet një analizë të tendencave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në pesë vitet e fundit. Analiza bazohet në të dhënat e mbledhura nga të gjitha institucionet përkatëse, studimet mbi prevalencën dhe perceptimet e dhunës me bazë gjinore. Qëllimi i këtij seksioni është të ofrojë një sfond për fenomenin dhe se si kanë ndryshuar të dhënat me kalimin e kohës.

Perceptimet

Të gjitha të dhënat ndër vite tregojnë se gratë janë dukshëm të disavantazuara kur bëhet fjalë për dhunën me bazë gjinore. Sondazhet dhe studimet kanë hedhur dritë mbi vlerat dhe normat e vazhdueshme patriarkale që mbështesin të menduarit për familjen shqiptare dhe rolin e gruas në to. Sondazhi mbarëkombëtar i popullsisë për dhunën ndaj grave, i realizuar nga Instituti i Statistikave, me mbështetjen e UNDP, UN Women e shumë organizatave e ekspertëve të fushës, tregoi se rreth 1 në 2 ose 52.2% e grave të moshës 18-74 vjeç mendojnë se të gjithë ose shumica e njerëzve në komunitet besojnë se dhuna midis një burri dhe një gruaje është një çështje private dhe se të tjerët nuk duhet të ndërhyjnë dhe 46.5% thanë se të gjithë ose shumica e njerëzve në komunitet besojnë se një grua duhet të tolerojë njëfarë dhune për të mbajtur familjen e saj të bashkuar.⁶ Për më tepër, 27.5% e grave thanë se të gjithë ose shumica e njerëzve në komunitet besojnë se kur një grua rrihet nga burri i saj do të thotë që ajo është pjesërisht fajtores ose fajtores. Një grup tjetër, rreth 27.5%, pohoi se një grua duhet të ketë turp ose 'siklet' të flasë me këdo jashtë familjes së saj për abuzimin ose dhunën në martesën e saj.⁷

Një tjetër sondazh i udhëhequr nga OSBE tregoi se gratë janë të shqetësuara për çështjen e dhunës në Shqipëri. 88% mendojnë se dhuna ndaj grave është e zakonshme dhe 53% se është shumë e zakonshme. 32% e grave të anketuara njohin personalisht dikë nga familja ose miqtë e tyre dhe 37% njohin dikë në lagjen e tyre që i është nënshtruar dhunës.⁸ Përtej gjetjeve sasiore, shumë gra të intervistuar treguan më tej eksperiencat e tyre për Shqipërinë si një shoqëri ku gratë janë të kufizuara në zgjedhjet e tyre dhe pritet të vënë familjen e tyre në vend të parë. 47% e grave të anketuara besojnë se shumica e miqve të tyre do të pajtoheshin me shprehjen se "një grua e mirë duhet t'i bindet burrit të saj edhe nëse ajo nuk është dakord". 19% e personave të anketuar besojnë se miqtë do të pajtoheshin se është detyrim i gruas që të bëjë seks me burrin e saj edhe nëse ajo nuk e ndien këtë.⁹

⁶ INSTAT, 2019. Dhuna ndaj Grave e Vajzave në Shqipëri. Online:

⁷ Ibid. Online: <https://ëëë.undp.org/albania/publications/national-population-survey-violence-against-women-and-girls-albania>

⁸ OSCE, 2019. Mirëqenia dhe Siguria e Grave në Shqipëri. Online: https://ëëë.osce.org/files/f/documents/c/8/434849_1.pdf

⁹ Po aty.

Sipas një sondazhi mes të rinjve, 88% e të intervistuarve mendonin se dhuna ndaj grave është një fenomen i përhapur dhe asnjë nga të anketuarit nuk e mohoi ekzistencën e saj.¹⁰ Gratë përbëjnë shumicën (50% të tyre) e atyre që besojnë se dhuna ndaj grave është një fenomen i përhapur në Shqipëri, krahasuar me meshkujt (37% e tyre). I njëjti sondazh zbuloi se një shumicë dërrmuese e të anketuarve besonin se dhuna seksuale ndaj grave është një fenomen i përhapur (80%), qoftë nga partnerët, personat e besuar apo të huajt. Ndarja e mëtejshme e të dhënave për Shqipërinë tregoi se gratë e reja dhe gratë që jetojnë me fëmijë kishin nivelin më të lartë të përvojës me dhunën që nga fillimi i pandemisë. Pothuajse 1 në 2 gra që jetonin me fëmijë kishin përjetuar një formë dhune. Në mënyrë të ngjashme, 1 në 2 gra të moshës 18 deri në 49 vjeç kishin përjetuar dhunë.

Prevalenca (Përhapja)

Studimi i INSTAT i vitit 2019, zbuloi se rreth 1 në 2 ose 52,9% e grave të moshës 18-74 vjeç kishin përjetuar 'ndonjëherë' një ose më shumë nga pesë llojet e ndryshme të dhunës gjatë jetës së tyre. Më konkretisht, 47% e grave (ato që janë ose kanë qenë të martuara dhe/ose kanë jetuar me një partner) kanë përjetuar "ndonjëherë" dhunë në familje nga partneri intim. 65.8% e grave kishin përjetuar "ndonjëherë" dhunë gjatë kohës që kishin qenë në marrëdhënie me një mashkull por pa jetuar me të. Ndër të gjitha gratë e moshës 18-74 vjeç, 18.2% kanë përjetuar dhunë nga jopartneri "ndonjëherë", 18,1% kanë përjetuar ngacmime seksuale "ndonjëherë" dhe 12,6% kanë përjetuar "ndonjëherë" ndjekje.

Analiza shtesë zbuloi një korrelacion të fortë midis dhunës nga partneri intim dhe dhunës nga jopartneri. Në veçanti, 3 nga 4 ose 75.8% e grave që kanë përjetuar dhunë nga jopartneri që në moshën 15-vjeçare kanë përjetuar gjithashtu dhunë në familje nga partneri intim. Me fjalë të tjera, gratë që kanë përjetuar dhunë nga një jo partner që nga moshë 15 vjeç kanë dy herë më shumë gjasa të përjetojnë dhunë në familje nga partneri intim (75.8%), krahasuar me gratë që nuk kanë përjetuar dhunë nga një jo partner që nga moshë 15 vjeç (32.1%). Sondazhi zbuloi gjithashtu se 3.1% e grave të moshës 18-74 vjeç ishin abuzuar seksualisht gjatë fëmijërisë, pra ishin prekur seksualisht kur nuk donin ose ishin detyruar të bënin diçka seksuale që nuk e dëshironin. Analiza hulumtoi marrëdhënien midis abuzimit seksual të fëmijëve dhe dhunës me bazë gjinore në moshën madhore. Gratë që kishin përjetuar abuzim seksual si fëmijë kishin më shumë gjasa të përjetonin dhunë me bazë gjinore në moshë madhore (88.8%), krahasuar me gratë që nuk kishin përjetuar abuzim seksual të fëmijëve (51.5%).

Viti 2021 pati një rritje prej 13% të numrit të femicideve në Shqipëri. Shumica e viktimave nga një anëtar i familjes ose partneri intim kishin marrë urdhra mbrojtjeje kundër sulmuesit të tyre. Kjo nxjerr në pah një çështje tjetër me mungesën e zbatimit të urdhrave të tillë. Mesatarisht, një grua

¹⁰Dhëmbo E., Duci V., Intimate partner violence and sexual violence among young people in Albania, AËEN, 2021. Online: https://aëenetëork.org/ëp-content/uploads/2021/07/AËEN-Dhuna-EN-pagesëeb_compressed.pdf


shqiptare vritej çdo tre javë në Shqipëri gjatë vitit 2021. Mijëra të tjera raportuan në polici sulme, përndjekje dhe forma të tjera të sjelljes abuzive.

Pandemia e COVID-19 përkeqësoi ndjeshëm nivelet tashmë alarmante të dhunës ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri. Një sondazh i kryer nga UN Women për të kuptuar ndikimin e COVID-19 në sigurinë dhe mirëqenien e grave tregoi tendenca shqetësuese. Ai tregoi se më shumë se gjysma e grave në Shqipëri kanë përjetuar ose njohin një grua që ka përjetuar dhunë në familje dhe thanë se e perceptojnë dhunën, abuzimin ose ngacmimin e grave si problem në komunitetet e tyre. Pandemia e COVID-19 solli një rritje të dukshme të treguesve specifikë të lidhur me dhunën ndaj grave dhe përkeqësoi tensionet ekzistuese dhe çështjet e sigurisë për shumë gra, të cilat ndryshojnë në lloj dhe ashpërsi bazuar në statusin socio-ekonomik dhe cenueshmërinë ndaj faktorëve stresues. Një nga statistikat më shqetësuese nga sondazhi ishte se thuhet se 80% e grave shqiptare thanë se abuzimi fizik ose verbal nga partneri ishte rritur në komunitet gjatë pandemisë ndërsa 57% u shprehën se ngacmimi seksual është rritur gjithashtu.


Një sondazh mbi dhunën dhe ngacmimin nga partneri intim mes të rinjve, zhvilluar nga Rrjeti i Fuqizimit të Grave, tregoi një sërë tendencash shqetësuese. Në një ndryshim të madh, 85% e burrave të intervistuar deklaruan se nuk janë ndier kurrë të kërcënuar nga një i huaj, krahasuar me vetëm 55% të grave. Edhe kur bëhet fjalë për ish-partneret, 90% e burrave raportojnë se nuk kanë përjetuar kurrë kërcënime, krahasuar me 78% të grave, që do të thotë se 22% e grave janë ndier të kërcënuara të paktën një herë nga ish-partnerët e tyre. Më tej, sondazhi zbuloi se pothuajse 1 në 10 gra të anketuara janë detyruar të kryejnë marrëdhënie seksuale për herë të parë kundër vullnetit të tyre. Gratë kanë pothuajse tre herë më shumë gjasa, krahasuar me burrat, të detyrohen të kryejnë marrëdhënie seksuale për shkak të frikës nga partneri/ish-partneri. Studime të ndryshme, siç është përmendur më lart, tregojnë se dhuna me bazë gjinore, edhe pse në rritje vitet e fundit, është ende e nën-raportuar. Kjo është e dukshme kur krahasohen anketat e bazuara në popullatë me të dhënat e disponueshme për rastet e raportuara. Një nga arsyet më të përmendura për mos raportimin e dhunës është se gratë nuk kanë besim të institucionet dhe nuk besojnë se do të gjejnë mbështetje nëse denoncojnë.

Sipas të dhënave nga raporti statistikor vjetor i Ministrisë së Drejtësisë, në vitin 2021 janë pranuar 1696 urdhra mbrojtjeje nga gjykatat, një rritje e lehtë krahasuar me vitin 2019 dhe 2020. Megjithatë, nëse shikojmë të dhënat për urdhrat e mbrojtjes të ekzekutuar nga përmbaruesit gjyqësorë, numri zvogëlohet. Në vitin 2020 kishte vetëm 528 tituj ekzekutivë për urdhra mbrojtjeje dhe urdhra mbrojtjeje të menjëhershme. Duke e krahasuar këtë numër me numrin e rasteve të raportuara të dhunës në polici dhe numrin e urdhrave të mbrojtjes të pranuar nga gjykatat, bëhet e dukshme se duhet bërë më shumë për të shtuar përpjekjet për të mundësuar mbrojtjen e duhur të të mbijetuarve. Grafiku i mëposhtëm tregon marrëdhënien mes dhunuesit dhe viktimës në dhënien e urdhrave të mbrojtjes. Nuk është për t'u habitur që shumica dërrmuese e urdhrave të mbrojtjes u lëshohen grave, pasuar nga fëmijët. Për vitin 2022, numri i titujve ekzekutivë për urdhrat e mbrojtjes (deri në shtator) është më i lartë se i gjithë vitit 2021 në 676, por ende i ulët në përgjithësi.

Grafiku 1. Urdhrat e Mbrojtjes



Grafiku 2. Lidhja me dhunuesin



Për vitin 2021, vetëm 41 bashki kanë hedhur të dhënat në sistemin REVALB si dhe i kanë përditësuar ato. Kështu për vitin 2021 rezultojnë të hedhura në sistem 1256 raste të dhunës në familje përkundrejt 1051 rasteve të vitit 2020. Nga këto 1061 gra/vajza dhe 195 burra/djem; 32 të mitur/mitura nga të cilët/cilat 4 djem dhe 28 vajza të mitura; Persona me aftësi të kufizuar (PAK) 7 nga të cilët 7 gra/vajza; nga minoriteti Rom-Egjiptian ka patur 12 raste nga të cilët 9 gra/vajza dhe 3 burra/djem. 972 raste vijnë nga zona urbane dhe 384 nga zona rurale. 575 raste janë të punësuar, 317 të papunë dhe 415 në ndihmë ekonomike (NE).

Për vitin 2022, deri në maj të këtij viti vetëm 32 bashki kanë hedhur të dhënat në sistemin REVALB si dhe i kanë përditësuar ato. Nga të dhënat rezultojnë 277 raste të dhunës në familje vetëm për periudhën janar-maj 2022.

Nga këto 233 raste ishin gra/vajza dhe 44 burra/djem; 15 të mitur/mitura nga të cilët/cilat 5 djem dhe 10 vajza të mitura; Persona me aftësi të kufizuar (PAK) 4 nga të cilët 2 gra/vajza; nga minoriteti Rom-Egjiptian ka patur 1 rast e cila ka qenë grua/vajzë. 189 raste vijnë nga zona urbane dhe 88 nga zona rurale. 130 raste janë të punësuar, 65 të papunë dhe 80 në ndihmë ekonomike (NE).

Këto të dhëna tregojnë se megjithëse sistemi REVALB ka filluar të përdoret prej më shumë se 7 vitesh¹¹ përsëri ka vështirësi të shumta në përdorimin e tij. Nëse përdoren siç duhet nga anëtarët e ETN-së, veçoritë e REVALB mundësojnë monitorimin dhe njohjen e rasteve të dhunës në familje dhe të situatës në nivel vendor dhe kombëtar, si dhe miratimin e masave të nevojshme për adresimin e saj.¹²

Kutiza 1.

Theksojmë se në sistem hidhen të gjitha ato raste që janë trajtuar në mënyrë shumë-sektoriale të koordinuar, nga anëtarët dhe anëtarët e Mekanizmave të Koordinuar të Referimit në nivelin vendor.

Brunilda Dervishaj, Shefe e sektorit të Politikave dhe Strategjive të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

I mbështetur në mënyrë të vazhdueshme nga programet e UNDP-së, REVALB regjistron, gjurmon dhe monitoron rastet e trajtuara nëpërmjet një qasjeje shumëdisiplinore nga MKR duke garantuar që çdo rast i raportuar të menaxhohet dhe trajtohet siç duhet. Të dhënat duhet të futen në sistem nga KVDHF+NBGJ-të në çdo bashki në trajtimin e rasteve, mbledhjen e të dhënave, regjistrimin dhe monitorimin e rasteve. REVALB është i sigurt dhe respekton privatësinë dhe konfidencialitetin e të mbijetuarave të DHF dhe është shumë i varur nga cilësia e të dhënave të mbledhura në nivel vendor dhe shpeshësia e hedhjes së të dhënave në sistem.¹³ REVALB siguron modele të ndryshme raportesh që mund të përdoren nga KVDHF+NBGJ-të për të gjeneruar analiza mbi tendencat e DHF-së në bashkitë e tyre, statistikat e të mbijetuarave të DHF dhe vlerësimin e performancës së ETN-së, por këto veçori të sistemit, të cilat janë të njëjta për të gjitha bashkitë, nuk përdoren.¹⁴ Nga ana tjetër të dhënat e REVALB duke mos u përditësuar kanë boshllëqe nga të dhënat e policisë. E gjithë kjo tregon për një sistem të dobët të dhënash të cilat

¹¹ Në vitin 2015, ish Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (tani MSHMS) prezantoi REVALB-in, i cili është një sistem mbarëkombëtar online i mbledhjes së të dhënave, i pilotuar për herë të parë nga Rrjeti kundër Dhunës me Bazë Gjinore dhe Trafikimit.

¹² MSHMS dhe UNDP, 2019. RAPORT PËRFUNDIMTAR. Analiza e Funkcionimit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje në Nivel Vendor në Shqipëri. Online: https://ëëë.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/al/ëëb_MKR.pdf

¹³ Ibid.

¹⁴ Po aty.

do të ndihmonin institucionet përkatëse të monitoronin dhe konkludonin si duhet për rastet e raportuara të dhunës me bazë gjinore dhe veçoritë specifike të secilit rast.

Konkluzione

Shoqëria shqiptare duhet të punojë ende fort për të ndryshuar perceptimin që dhuna në familje është çështje e brendshme e familjes. Normat dhe qëndrimet sociale rreth gjinisë, roleve gjinore dhe pozitës së gruas në shoqëri mundësojnë përsëritjen e dhunës në shoqërinë shqiptare. Edukimi i popullsisë, sidomos i brezit të ri, kundër dhunës me bazë gjinore duhet të jetë në qendër të vëmendjes dhe përgjigjes ndër-institucionale. Qeveria shqiptare duhet të garantojë nivel të lartë shpërndarjeje për publikun e gjerë të informacionit mbi masat e vëna në dispozicion për parandalimin e akteve të dhunës dhe të marrë hapat e nevojshëm për të përfshirë materiale mësimore mbi çështje të tilla si barazia midis burrave dhe grave, rolet gjinore të pastereotipizuara, respekti i ndërsjellë, zgjidhja e konflikteve pa dhunë në marrëdhëniet ndërpersonale, dhuna gjinore kundër grave dhe e drejta për integritet personal, të përshtatura me kapacitetin në zhvillim të nxënësve në programet mësimore zyrtare dhe në të gjitha nivelet arsimore ashtu siç shkruhet në Konventën e Stambollit, apo siç parashikohet në vetë LDHF.

Sistemi REVALB nuk përdoret sistematikisht nga të gjithë koordinatorët vendorë kundër dhunës për të regjistruar situatën e DHF në nivel vendor dhe mënyrën si mbështetet e mbijetuara që ka raportuar me shërbime. Ka lëvizje të herëpashershme të stafit të specializuar e trajnuar për të trajtuar rastet e dhunës me bazë gjinore dhe përdorur sistemin REVALB. MSHMS si organi udhëheqës në luftën kundër dhunës me bazë gjinore nuk ka një sistem monitorimi të rasteve që do ta ndihmonte të analizonte situatën dhe përgjigjen e koordinuar të institucioneve.

Dhuna ndaj grave dhe vajzave mbetet në nivele shqetësuese por edhe në nivele të raportuara plotësisht. Të dhënat tregojnë se edhe pse vitet e fundit ka një rritje të numrit të raportimeve, që mund të jetë prej ndërgjegjësimit më të madh, punës së aktorëve të ndryshëm dhe ofrimit të mbështetjes, gjithsesi ato nuk përputhen me të dhënat që përftohen nga sondazhet e ndryshme ku duket se dhuna ndodh gjerësisht por shpesh ajo nuk raportohet.

Seksioni II - Kuadri ligjor dhe strategjik në luftën kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje

Ky seksion ofron një analizë të kuadrit ligjor bazuar në katër shtyllat e KS: parandalimi, mbrojtja, ndjekja penale, politikat e integruara. Shqipëria ka qenë ndër vendet e para që e ka ratifikuar këtë konventë në shkurt të vitit 2013 e për rrjedhojë ndjek detyrimet që rrjedhin prej saj si palë nënshkruese. Dokumentat kryesorë që janë analizuar në janë: Ligji për Masat Ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare¹⁵, Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr.327, për Funkcionimin e Mekanizmave të Koordinuar të Referimit (MKR)¹⁶, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030.¹⁷ Në këtë analizë më poshtë do të përmenden ligje dhe strategji të tjera si Kodi Penal, Ligji për Ndhimën Juridike Falas, Ligji për Strehimin Social etj. sipas relevancës.

Parandalimi

Sipas Konventës së Stambollit, parandalimi i dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje kërkon ndryshime të gjera në qëndrimin e publikut në përgjithësi, luftimin e stereotipeve gjinore dhe rritjen e ndërgjegjësimit. Tabela e mëposhtme tregon se çfarë duhet të bëjnë shtetet palë që kanë nënshkruar Konventën e Stambollit për të trajtuar normat dhe qëndrimet sociale për të arritur barazinë gjinore si parakusht për eliminimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave. Tabela më poshtë rendit të gjitha masat që parashikon KS në lidhje me parandalimin e dhunës me bazë gjinore dhe çfarë duhet të bëjnë shtetet palë për t'i përmbushur këto masa. Për këtë arsye masat e parashikuara nga KS janë ballafaquar me legjislacionin shqiptar, përkatësisht me ligjin kundër dhunës në familje, VKM 327 dhe Strategjinë Kombëtare për Barazi Gjinore. Qëllimi i paraqitjes në formë tabelare të kësaj analize është për të hartëzuar masat që janë të pranishme në legjislacionin shqiptar dhe ato që mungojnë, në mënyrë që të propozohen hapa konkretë për mbylljen e hendeqeve ekzistuese në kuadrin ligjor.

PARANDALIMI

¹⁵Ligj Nr.9669, datë 18.12.2006, Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare (ndryshuar me ligjin nr.9914, datë 12.5.2008, nr.10 329, datë 30.9.2010, 47/2018, date 23.7.2018. 125/2020). Online:

<https://ëë.parlament.al/Files/Akte/20201020140600ligj%20nr.%20125%20dt.%2015.10.2020.pdf>

¹⁶Vendimi Nr. 327, datë 2.06.2021, Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimitin e viktimave të dhunës. Online: <https://shendetesia.gov.al/ëp-content/uploads/2021/07/VKM-Nr.-327-dat%C3%AB-2.06-00000002.pdf>

¹⁷Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030. Online: https://shendetesia.gov.al/ëp-content/uploads/2022/02/ËEB_Strategjia-Kombetare-AL.pdf

Nëse një vend ka ratifikuar Konventën e Stambollit, do të duhet të marrë masat e mëposhtme:	LDHF¹⁸	VKM 327	SKBGj 2021-2030
<i>Nxitja e medias dhe sektorit privat, në vendosjen e standardeve që rrisin rolet respektuese gjinore dhe sfidojnë qëndrimet që justifikojnë dhunën ndaj grave</i>	Jo	Jo	Jo
<i>Fushata ndërgjegjësuese</i> Rritja e ndërgjegjësimit për format e ndryshme të dhunës, natyrën e tyre shkatërruese dhe ndikimin që ato kanë te gratë dhe fëmijët	Jo	Po Neni 14.ç	Po Masa II.4.1.a
<i>Edukimi kundër dhunës dhe për barazinë midis grave dhe burrave. Përfshirja e materialeve mësimore mbi barazinë gjinore, dhunën me bazë gjinore, zgjidhjen e konflikteve pa dhunë dhe të drejtës për integritet personal në kurrikulat formale në të gjitha nivelet e arsimit</i>	Po Neni 7, pika 3/1.b	Jo	Po Masa III.4.1.a
<i>Sfidë ndaj stereotipeve gjinore</i> Promovimi i ndryshimeve në modelet sociale dhe kulturore të sjelljes ndaj grave dhe burrave.	Po, pjesërisht neni 6	Jo	Po, Masa III.4
<i>Promovimi i fuqizimit të grave</i> Prezantimi i programeve dhe aktiviteteve për fuqizimin e grave, dhe adresimi i nevojave specifike të njerëzve në situata të cënueshme nga pikëpamja e të drejtave të njeriut	Po	Jo	Po
<i>Programe për autorët e dhunës dhe dhunës seksuale</i> Krijimi i programeve për të mësuar mbi autorët e dhunës me bazë gjinore, puna me ta për të adoptuar sjellje jo të dhunshme për të shmangur përsëritjen e veprës.	Po Neni 10/1	Po	Po Masa III.1.3
<i>Roli i burrave dhe djemve</i> Inkurajimi i angazhimit dhe kontributit aktiv nga burrat dhe djemtë në parandalimin e dhunës.	Jo	Jo	Po, Masa III.4
<i>Trajnimi i profesionistëve</i> Trajnimi i profesionistëve që punojnë me viktimat ose autorët për njohjen dhe reagimin ndaj dhunës dhe për të bërë referimet e duhura.	Po Neni 6/ç	Po Pjesa II, pika 31/n	Po Masa III.2.5.c, Masa III.4.1.c

¹⁸Ligj Nr.9669, datë 18.12.2006, Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare (ndryshuar me ligjin nr.9914, datë 12.5.2008, nr.10 329, datë 30.9.2010, 47/2018, date 23.7.2018. 125/2020). Online:

<https://ëëë.parlament.al/Files/Akte/20201020140600ligj%20nr.%20125%20dt.%2015.10.2020.pdf>

Kutiza 2

VKM Nr. 327 datë 02.06.2021 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës” rregullon procedurat e bashkërendimit të punës mes institucioneve me qëllim parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje.

“Çdo vit ka vijuar zhvillimi i fushatës ndërgjegjësuere të 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës ndaj grave nën fushatën globale UNITE nga 25 nëntor- 10 dhjetor. Fushata e 2021 u zhvillua nën sloganin “Të ndalim dhunën ndaj grave tani”. Gjatë vitit 2021 u zhvilluan mbi 300 aktivitete ndërgjegjësuere vetëm gjatë 16 ditëve të aktivizmit, me pjesëmarrjen e institucioneve, bashkive të vendit, organizatave të shoqërisë civile, partnerëve ndërkombëtarë, veçanërisht mbështetur nga organizatat e UN”.

Aurela Bozo, përfaqësuese e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare

Neni 15 i Konventës së Stambollit i referohet veçanërisht nevojës ***për trajnimin dhe sensibilizimin e profesionistëve***, si praktikues të LDHF, të cilët mund të jenë ofrues të shërbimeve në gjyqësor, punonjës të shërbimeve sociale, shëndetësisë dhe arsimit. Në interpretimin e Konventës së Stambollit, trajnimi mundëson rritjen e ndërgjegjësimit të profesionistëve për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje dhe kontribuon në ndryshimin e këndvështrimit të tyre kur kanë të bëjnë me të mbijetuarat/it. Ndërsa formati dhe përmbajtja e trajnimit është lënë në diskrecionin e shteteve palë, komentari i Konventës së Stambollit e bën të qartë se është e rëndësishme ***të sigurohet që trajnimi të jetë i vazhdueshëm dhe i qëndrueshëm me ndjekjen e duhur për të siguruar që aftësitë e reja zbatohen në praktikë***.

Në legjislacionin shqiptar, trajnimi i profesionistëve organizohet nga ministria përgjegjëse për zbatimin e ligjit për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare, në këtë rast nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS). Në kategorinë e profesionistëve, ligji përfshin punonjësit e shërbimeve sociale, punonjësit e policisë, personelin shëndetësor dhe përfaqësues të OJQ-ve. Ligji nuk përfshin veçanërisht institucionet arsimore dhe përfaqësuesit e gjyqësorit, por në fund të nenit 6/ç i referohet organeve të drejtësisë si organizatorë të sesioneve të trajnimit. ***Teksti i nenit nuk specifikon shpeshësinë e trajnimit që siç theksohet më lart Konventa e Stambollit e kërkon të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm***. Gjithashtu konstatohet se puna për rritjen e ndërgjegjësimit në nivel bashkie nuk fokusohet vetëm në 16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore por gjatë gjithë vitit dhe sipas mundësive të ofruara kryesisht nga organizatat që mbrojnë të drejtat e grave.

Temat e trajnimit mbulohen nga SKBGJ (2021-2030), e cila parasheh 61 sesione trajnimi për anëtarët e MKR-ve në të gjitha bashkitë ndërmjet viteve 2021 dhe 2025. Duke marrë parasysh që janë 61 bashki, mund të supozohet se është planifikuar vetëm një seancë trajnimi. Në praktikë, OJQ-të e grave dhe institucionet shtetërore shpesh kryejnë trajnime të vazhdueshme në ndërhyrjet e tyre. Megjithë punën e kryer nga organizatat e grave si edhe institucionet shtetërore

për të trajnuar punonjësit që merren me çështje të dhunës me bazë gjinore, **ekziston nevoja për të institucionalizuar trajnimin e vazhdueshëm në punë për këta punonjës në baza vjetore për të shkuar përtej sesioneve që ndodhin një herë në disa kohë.** Nga ana tjetër institucioni koordinues duhet të marrë masa që trajnimet e organizuara si nga institucionet publike, ato private apo tjetër të jenë të mirëkoordinuara, të ditura dhe të regjistruara.

Masa III.4.1.c e SKBGJ parashikon *“Trajnimin e Nëpunësve të Barazisë Gjinore (NBGJ) qendrorë e vendorë, Koordinatorëve / Koordinatorëve Vendorë kundër dhunës në familje, Specialistëve / Specialistëve të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe profesionistëve/profesionistëve të arsimit, për të kontribuar në punën me djem dhe burra si aleatë të krijimit të brezit të barazisë.”*¹⁹ Kjo masë do të drejtohet nga Shkolla Shqiptare për Administratën Publike (ASPA), për gjithsej 12 sesione trajnimi në nivel vendor dhe një në nivel qendror. **Është e rëndësishme që të ketë një strategji të qëndrueshme për angazhimin e burrave dhe djemve, për të arritur qëllimet për parandalimin e DHBGJ/DHB. Këto trajnime edukuese dhe ndërgjegjësuese duhet të organizohen më shpesh, të paktën çdo vit për kohëzgjatjen e SKBGJ-së.**

VKM 327 për funksionimin e MKR-ve ngarkon koordinatorët vendorë të DhF në organizimin e sesioneve trajnuese për anëtarët e MKR-së sipas ligjit për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare. Rritja e ndërgjegjësimit është një nga kërkesat kryesore të Konventës së Stambollit, nën shtyllën e parandalimit. Konventa e Stambollit kërkon nga shtetet palë që të *“Promovojnë ose realizojnë rregullisht dhe në të gjitha nivelet, fushata ose programe të rritjes së ndërgjegjësimit, duke përfshirë ato në bashkëpunim me institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe organet e barazisë, shoqërisë civile dhe organizatat joqeveritare, veçanërisht organizatat e grave, sipas rastit, për të rritur ndërgjegjësimin dhe perceptimin nga publiku i gjerë, në lidhje me manifestimet e ndryshme të të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente, pasojat e tyre për fëmijët dhe nevojën për të parandaluar një dhunë të tillë”.*²⁰ Materialet promovuese duhet të shpërndahen gjerësisht tek publiku i gjerë dhe të sigurohet që ky i fundit të jetë plotësisht i informuar për të gjitha format e dhunës për t'i ndihmuar ata ta njohin atë dhe të veprojnë. Sipas raportit shpjegues të konventës, këto fushata ndërgjegjësuese duhet të zhvillohen rregullisht, të fokusohen në barazinë mes burrave dhe grave dhe të fokusohen në pasojat e dëmshme për fëmijët.²¹ Në përputhje me këtë dispozitë të Konventës së Stambollit, SKBGJ 2021-2030 parashikon masa specifike për organizimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese kundër praktikave të dëmshme të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Frekuenca e aktiviteteve të tilla të fushatës shënohet qartë si në baza mujore në datën 25 të çdo muaji, ashtu dhe në ditët e shënuara ndërkombëtare.²²

¹⁹Strategjia e Barazisë Gjinore 2021 – 2027. Fq.91

²⁰Konventa e Stambollit, Neni 13, fq. 6.

²¹ Explanatory Report. Online: <https://rm.coe.int/1680a48903>

²² NSGE 2021-2030. P. 69. Online: https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2022/02/IEB_Strategjia-Kombetare-EN.pdf

Përpjekjet parandaluese duhet të fillojnë që në moshë të re dhe të shtrihen në të gjitha nivelet e arsimit, në arsimin formal dhe joformal. Neni 14 i konventës së Stambollit kërkon që shtetet palë të përfshijnë materiale mësimore mbi barazinë midis burrave dhe grave, luftimin e stereotipeve gjinore në objektet arsimore, objektet sportive, kulturore dhe të kohës së lirë, si dhe në media. Konventa e Stambollit tregon qartë se materiale të tilla mësimore duhet të përfshihen në institucionet e arsimit fillor, të mesëm dhe të lartë dhe të përshtaten me karakteristikat dhe nevojat e nxënësve. SKBGJ (2021 – 2030) përfshin një dispozitë të tillë vetëm për arsimin e lartë. Masa III.4.1. parashikon përfshirjen në kurrikulat universitare dhe pasuniversitare të moduleve të maskulinitetit, djemve dhe burrave, duke ia ngarkuar përgjegjësinë Fakultetit të Shkencave Sociale, i cili pritet ta zbatojë ndërmjet gjysmës së dytë të vitit 2022 dhe gjysmës së dytë të vitit 2023. Në SKBGJ (2021 – 2030) mungojnë dy pjesë në krahasim me kërkesat e Konventës së Stambollit. Nga njëra anë, fokusi është vetëm në arsimin e lartë, ndërsa Konventa e Stambollit kërkon qartë përshtatjen e materialeve mësimore edhe për arsimin fillor dhe të mesëm. Nga ana tjetër, Konventa e Stambollit kërkon integrimin e materialeve të tilla mësimore në objektet e arsimit joformal si dhe në sport. Kjo nuk është e specifikuar qartë në SKBGJ (2021 – 2030). Ky boshllëk në SKBGJ (2021 – 2030) plotësohet disi nga LDHF, i cili sipas nenit 7 ngarkon ministrinë përgjegjëse për çështjet e arsimit të përgatisë materiale mësimore për edukimin e nxënësve dhe/ose studentëve për të luftuar dhe parandaluar dhunën në marrëdhëniet familjare. Gjithashtu, Strategjia Kombëtare e Arsimit (SKA, 2021 – 2026)²³ parashikon edukimin gjinor të nxënësve përmes përfshirjes në kurrikulat e materialeve mësimore lidhur me barazinë gjinore, stereotipet gjinore, dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje.²⁴

Në funksion të parandalimit të dhunës së mëtejshme, Konventa e Stambollit kërkon që shtetet palë të krijojnë ose mbështesin programe rehabilitimi për autorët e dhunës si masë parandaluese, në mënyrë që t'i parandalojnë ata të përsërisin veprën penale dhe ndryshojnë modelet problematike të sjelljes. Në rishikimet e vitit 2020 në LDHF, u shtua një dispozitë për rehabilitimin e dhunuesit. Ligji e bën të detyrueshëm regjistrimin e autorëve në programet e rehabilitimit, i cili përfshihet në urdhrin e mbrojtjes për të mbijetuarit.²⁵

Rëndësia e angazhimit të medias²⁶ dhe sektorit privat në luftën kundër dhunës ndaj grave, stereotipeve gjinore dhe manifestimit të patriarkalizmit në çdo shoqëri nuk mund të nënvlerësohet. Neni 17 i Konventës së Stambollit e bën të qartë këtë pikë kur kërkon nga shtetet palë të inkurajojnë sektorin privat, sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit si dhe mediat për të vendosur udhëzime dhe standarde rregullatore për të parandaluar dhunën

²³Strategjia kombëtare e Arsimit 2021-2026. Online: <https://arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2021/05/Draft-Strategjia-per-Arsimin-2021-2026-1.pdf>

²⁴Strategjia kombëtare e Arsimit 2021-2026. Produkti A1.3.9. Edukimi gjinor i nxënësve nëpërmjet përfshirjes në kurrikula të përmbajtjeve mësimore që synojnë edukimin gjinor. Hartimi i kurrikulës/orëve mësimore të edukimit gjinor. Nxënësit do të marrin informacion mbi barazinë gjinore, stereotipat gjinorë, dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje nëpërmjet kurrikulës/orëve mësimore.

²⁵Ligji për Masat Kundër Dhunës në Marrëdhëniet Familjare. Neni 10/1, pika 1

²⁶Këshilli i Evropës, 2016. Inkurajimi i pjesëmarrjes së sektorit privat dhe medias në parandalim e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje: neni 17 i Konventës së Stambollit. Online: <https://rm.coe.int/1680a48903>

ndaj grave dhe për të rritur respektin për dinjitetin e tyre. Qëllimi i këtij neni është i dyfishtë. Nga njëra anë kërkon që ata të marrin pjesë në zhvillimin e politikave lokale, rajonale dhe kombëtare për parandalimin e dhunës ndaj grave. Nga ana tjetër, kërkon pjesëmarrjen e tyre për të realizuar përpjekje të tilla. Megjithatë, Konventa e Stambolit formulon me kujdes këtë pjesë për të mbajtur parasysh pavarësinë e medias dhe lirinë e shprehjes.

Ligji nr. 97/2013 për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar në disa nene, parashikon parandalimin e diskriminimit me bazë gjinore dhe ndalimin e inkurajimit të dhunës. Kodi i transmetimit sepas nenit 46 rregullon parimet e transmetimit. Kodi i Transmetimit në fuqi është i vakët përsa i përket dhunës ndaj grave, promovimit të barazisë gjinore dhe parandalimit dhe luftimit të seksizmit në transmetimet audiovizive dhe në reklamat tregëtare. Versioni i ri Kodit të Transmetimit që është hedhur në konsultim publik prej muajit qershor 2022 parashikon një seksion të ri të dedikuar barazisë gjinore, parandalimit të dhunës me bazë gjinore dhe seksizmit. Gjithashtu seksionet e veçanta lidhur me programet, të miturit, personat me aftësi të kufizuar adresojnë çështje të parandalimit të dhunës me bazë gjinore. Raporti shpjegues i Konventës së Stambolit e bën të qartë se masat vetërregulluese mund të mos jenë të mjaftueshme për të arritur këtë objektiv, por i takon vetë medias që të jetë proaktive dhe të marrë masa për të luftuar dhunën me bazë gjinore përmes rolit të saj edukativ, si dhe në mjedisin e vet.²⁷ **Tre dokumentet ligjore të paraqitura në tabelën e mësipërme nuk përmbajnë masa të tilla specifike siç parashikohen në nenin 17 të Konventës së Stambollit.**

Angazhimi i burrave dhe djemve është një nga parimet kryesore dhe qasjet e domosdoshme për të luftuar kundër dhunës me bazë gjinore. Për rrjedhojë këta të fundit duhet të shihen edhe si pjesë e zgjidhjes për të luftuar stereotipet gjinore dhe për të çnormalizuar dhunën ndaj grave dhe vajzave. **Megjithëse SKBGJ e përmend shkurtimisht në kuadrin e masave parandaluese, nuk vërehet se ka strategji të mirëfilltë për angazhimin e tyre dhe nuk ka asnjë referencë në LDHF.**

Konkluzione:

Parandalimi është një nga shtyllat kryesore dhe strategjitë më të rëndësishme për t'i dhënë fund dhunës me bazë gjinore. Megjithëse LDHF përmban disa masa parandaluese aty këtu, këto nuk janë të mjaftueshme. Është e rëndësishme që të gjitha autoritetet përgjegjëse të identifikuar në ligj dhe të tjera që nuk përmenden në të të kenë role dhe strategji specifike për parandalimin e dhunës dhe nxitjen e barazisë gjinore. Është gjithashtu e rëndësishme që qasja parandaluese të jetë mbarëkombëtare, të përfshijë gjithë hallkat e shoqërisë dhe të mos mbështetet në veprime dhe aktivitete sporadike, por ndërhyrje që fillojnë në mjediset mësimore dhe zgjaten edhe më tej. Ndryshimi i mendësive dhe normave shoqërore që ende e mundësojnë dhe justifikojnë dhunën kërkon rrjedhimisht përpjekje sistemike, afatgjata dhe transformuese. Kjo duhet të reflektohet qartë në LDHF si edhe në SKBGJ.

²⁷ Po aty.

Ndërsa LDHF dhe SKBGj përfshijnë një mori aktorësh dhe institucioneve përgjegjëse, ka të tjerë aktorë dhe institucione që janë lënë jashtë dhe mund të luajnë një rol më aktiv. Për shembull referimi ndaj rolit të medias, bashkëpunimi me sektorin privat, përfshirja e institucioneve të drejtave të njeriut etj. Po në linjë me këtë, angazhimi i burrave dhe i djemve nuk duhet të jetë vetëm një nga aktivitetet apo qëllimet specifike të SKBGJ, por ata duhet të përfshihen qartësisht në LDHF, mundësisht në një seksion më vete për parandalimin e dhunës.

Ministria e Arsimit dhe Sportit përmendet në LDHF dhe ka disa përgjegjësi por këto nuk janë të mjaftueshme për të garantuar politika afatgjata dhe gjithëpërfshirëse. Është e rëndësishme të ketë harmonizim ndërmjet SKBGJ dhe Strategjisë Kombëtare të Arsimit si edhe LDHF në mënyrë që të ketë një strategji koherente dhe qasje të mirëkoordinuar.

Mbrojtja

Konventa e Stambollit parashikon masat mbrojtëse si mekanizëm dytësor kur ato parandaluese kanë dështuar. Mbrojtja përfshin shërbime të specializuara, referim në polici dhe shërbime të tjera sociale. Të gjithë këta organizma përveçse duhet të zbatojnë kuadrin ligjor, duhet të kuptojnë shqetësimet e të mbijetuarve dhe të jenë të ndjeshëm kur merren me to. Masat mbrojtëse zënë një vend të rëndësishëm në tekstin e KS për shkak të domosdoshmërisë së adresimit të fenomenit kur masat parandaluese nuk kanë qenë të suksesshme. Për këtë arsye tabela më poshtë paraqet të gjitha masat që Konventa e Stambollit parashikon që shtetet palë duhet të ndërmarrin për të mbrojtur viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Krahas këtyre masave janë vendosur nenet specifike në kuadrin ligjor shqiptar ku këto masa gjenden ose është identifikuar aty ky ka boshllëqe. Kjo formë tabelare ndihmon për të hartëzuar masat ekzistuese dhe ato të munguara që analizohen më me detaje në tekstin vijues.

Mbrojtja			
Nëse një vend ka ratifikuar Konventën e Stambollit, do të duhet të marrë masat e mëposhtme:	LDHF	VKM 327	SKBGj 2021-2030
Informacion mbi të drejtat e tyre Viktimat duhet të informohen për të drejtat e tyre dhe të dinë se ku dhe si të marrin ndihmë në një gjuhë që e kuptojnë.	Po Neni 8/3	Po, një nga detyrat e koordinatorit kundër DhF	Jo
Viktimat duhet të kenë akses në shërbimet e specializuara të mbështetjes së grave, të cilat shpesh janë gra për gratë dhe të përkushtuara ndaj një lloji të caktuar dhune. Viktimat gjithashtu duhet të kenë akses në shërbimet e përgjithshme si këshilla/ndihma ligjore,	Po, Neni 6	Po, përmes gjithë dokumentit	Po Objekti vi specific III.3

këshillim psikologjik, ndihmë financiare, strehim, arsim, kujdes shëndetësor, shërbime sociale dhe ndihmë në gjetjen e punësimit			
Mekanizmat rajonalë dhe ndërkombëtarë të ankesave Viktimat duhet të informohen dhe të kenë akses në rajonet përkatëse dhe mekanizmat ndërkombëtarë të ankesave.	Jo	Jo	Jo
Strehëza Viktimat duhet të kenë akses në Strehim.	Po, Disa nene	Po, Disa nene	Po, Objekti va specifik e III.2.4
Qendra për menaxhimin e krizave të dhunës seksuale dhe përdhunimit Viktimat duhet të kenë akses në një qendër të afërt lehtësisht të aksesueshme duke ofruar menjëherë këshillim mjekësor, kujdes për traumat dhe shërbim mjekoligjor	Po, Neni 7	Po Seksioni III	Po Masa III.2.1
Mbrojtje dhe mbështetje për fëmijët dëshmitarë të dhunës	Po, Neni 13/1	Jo	Jo

Neni 19 i Konventës së Stambollit kërkon që shtetet palë t'u japin informacion të mbijetuara/ëve të dhunës pas incidentit, në mënyrë që t'i drejtojnë dhe mbështesin në kohën e duhur. Kjo përfshin informacion mbi lloje të ndryshme të shërbimeve mbështetëse dhe masat ligjore në dispozicion të tyre, ku mund të merret ndihmë dhe ndihma që është e disponueshme.

Për më tepër, ky nen thekson se aty ku është e nevojshme të jepet ky informacion në një gjuhë që i/e mbijetuari/a e kupton dhe ku informacioni është i aksesueshëm. Ligji për DhF në Shqipëri i referohet informacionit që duhet t'i jepet të mbijetuarve të dhunës nga "autoritetet përgjegjëse", të cilat në kuptimin e ligjit u referohen të gjitha institucioneve të renditura në nenin 5, që do të thotë se kudo që viktimat raportojnë, institucioni ka detyrim t'i informojë ata/ato për shërbimet në dispozicion.

Janë dy çështje që ligji mund t'i kishte trajtuar më mirë në gjuhën e përdorur. Neni 8 është mjaft i ngushtë pasi i referohet vetëm informacionit për "shërbimet sociale" të disponueshme për viktimën, duke përjashtuar kështu shërbimet e tjera, si p.sh. ndihma juridike. Ndërsa në praktikë ky informacion mund të mos jetë i kufizuar, ligji i referohet vetëm një lloj shërbimi për të cilin duhet të jepet informacioni. Ky nen mund të rishikohet duke bërë plotësimet me dhënien e informacionit për ndihmën juridike parësore dhe dytësore, përfshirë përjashtimin nga taksat, ndihmën psikologjike dhe mundësinë e shmangies së ballafaqimit me dhunuesin, mes përdorimit të regjistrimit audiovideo.

Gjithashtu, **neni 19 i Konventës së Stambollit kërkon** që një informacion i tillë të jetë i disponueshëm në një gjuhë që e kupton personi që bën raportimin. Ligji për DhF nuk ka një dispozitë të tillë në vetvete dhe nuk i referohet legjislacionit përkatës, siç është Ligji “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.²⁸ Edhe ky i fundit parashikon që ligjet dhe aktet nënligjore, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, duhet të jenë të disponueshme në formate të aksesueshme, si braille, gjuhë e lehtë etj. Në mënyrë të ngjashme, Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025,²⁹ nuk bën asnjë referencë për të mbijetuarat e dhunës, me përjashtim të viktimave të trafikimit.

Neni 20 i Konventës së Stambollit kërkon krijimin e shërbimeve të përgjithshme mbështetëse, të cilat përfshijnë këshillimin ligjor dhe psikologjik, ndihmën financiare, strehimin, arsimimin, trajnimin dhe ndihmën për gjetjen e punësimit, për të siguruar riintegrimin e duhur dhe rehabilitimin e tyre nga dhuna. Këto shërbime duhet të kenë burime të përshtatshme dhe t'u ofrohet trajnimi i duhur profesionistëve për të ndihmuar viktimat. Neni 6 i LDhF, i cili detajon detyrat e autoritetit kryesor përgjegjës në zbatimin e ligjit, i referohet shërbimeve të përgjithshme sociale në dispozicion të të mbijetuarve të dhunës. Për shembull, ai parashikon që institucioni përgjegjës për zbatimin e ligjit duhet të koordinojë shërbimet e mbrojtjes sociale për personat e mbijetuar të dhunës. Më tej duhet të sigurojë ofrimin e shërbimeve psikologjike, shëndetësore dhe të tjera për riintegrimin e tyre. Punësimi dhe trajnimi renditen në kuadër të ministrisë përgjegjëse për çështjet e punësimit. Këto masa plotësohen me akte të tjera legjislacioni. Ligji për Strehimin Social³⁰, për shembull, përfshin të mbijetuarit e dhunës në kategorinë prioritare të njerëzve që mund të përfitojnë nga forma të ndryshme të mbështetjes për strehim. Gjithashtu, ndihma juridike falas mbulohet nga Ligji për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti.³¹ Personat që i kanë mbijetuar dhunës mund të përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike për aq kohë sa janë nën urdhër mbrojtjeje. Shërbimet e përgjithshme të mbështetjes janë të detajuara në VKM-në për funksionimin e MKR-së, pasi përbërja e Mekanizmit të Referimit lidhet drejtpërdrejt me shërbimet e përgjithshme të ofruara për të mbijetuarit, si shërbimet sociale, riintegrimi afatmesëm dhe afatgjatë, të cilat janë nën kujdesin e ofruesve të shërbimeve në nivel lokal.

Së fundi, SKBGJ 2021-2030 përmban vetëm një objektiv specifik, për aksesin në drejtësi, i cili mund të llogaritet në shërbime të përgjithshme, por të tjerët siç përmenden në raportin shpjegues të Konventës së Stambollit nuk përmenden në SKBGJ 2021-2030, e cila fokusohet kryesisht në shërbimet e specializuara. Duhet të theksohet se shërbimet mbështetëse të

²⁸Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”. Online:

<http://special.aipa.al/ligji-nr-932014-per-perfshirjen-dhe-aksesueshmerine-e-personave-me-aftesi-te-kufizuara/>

²⁹Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025 (këtu e në vijim “PKVBPPRE 2021-2025”). Online: <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/359>

³⁰Ligj Nr. 22/2018 Për Strehimin Social. Online: <https://financa.gov.al/ep-content/uploads/2018/12/ligj-nr.-22-dt.-3.5.2018.pdf>

³¹Ligji Nr. 111/2017 Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti. Online: <https://eëë.drejtësia.gov.al/ep-content/uploads/2019/02/LIGJ-nr.-111-2017-date-14.12.2017.pdf>

përgjithshme dhe të specializuara për të mbijetuarat e dhunës janë të shpërndara midis pjesëve të ndryshme të legjislationit dhe nuk ka një qasje të harmonizuar se si, kur dhe nga kush ofrohen.

Kutiza 3

"Në Ligjin nr. 9669 datë 18.12.2006 *"Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare"* i ndryshuar si dhe në Protokollin për Menaxhimin e Rasteve të Dhunës në Familje në Nivel Vendor të parashikohet një periudhë kohe e paguar/njohur nga punëdhësi, një e drejtë kjo që buron nga legjislationi vendas dhe ai ndërkombëtar për të mbijetuarat e dhunës. Mendojmë se ky ndryshim do t'u vinte ne ndihmë grave/vajzave që raportojnë dhunën. Mbështetur në legjislation viktimat e dhunës në familje kanë të drejtën e rehabilitimit, si dhe lehtësimin e pasojave të dhunës në familje², kanë gjithashtu të drejtën e mbështetjes për traumat e pësuar.³ Në mënyrë që viktima e dhunës në familje t'i provojë punëdhënësit arsyen e justifikuar të mungesës në punë, propozojmë që Komisaritet e Policisë t'i pajisin viktimat e dhunës në familje me dokument të caktuar/ose gratë që raportojnë mund të paraqesin tek punëdhënësi kopjen e Kërkesë Padisë me objekt "lëshimin e UMM/UM", fakt ky që provon se procesi gjyqësor ka filluar."

Afërdita Prroni, Qendra për të Drejtat e Njeriut në Demokraci

Përveç shërbimeve të përgjithshme, Konventa e Stambollit parashikon shërbime më të specializuara, afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për personat e mbijetuar ndaj të gjitha formave të dhunës të përmendura në Konventën e Stambollit. Llojet e mbështetjes, siç parashtrihen në raportin shpjegues të konventës, përfshijnë strehëzat dhe strehimin e sigurt, mbështetjen e menjëhershme mjekësore, mbledhjen e provave mjeko-ligjore në rastet e përdhunimeve dhe sulmeve seksuale, këshillimin psikologjik afatshkurtër dhe afatgjatë, kujdesin ndaj traumës, këshillim ligjor, shërbime advokimi dhe kontakti, linja telefonike për t'i drejtuar viktimat në llojin e duhur të shërbimit dhe shërbime specifike për fëmijët si viktima ose dëshmitarë të dhunës. **LDHF, që në emërtim të tij, është kufizues dhe fokusohet kryesisht në dhunën në marrëdhëniet familjare**, duke lënë jashtë fushëveprimit forma të tjera të dhunës së përjetuar, si përndjekja, dhuna kibernetike, dhuna nga individë që nuk kanë lidhje me familjen, që do të thotë se shërbimet, ndërkohë që nuk janë të ndaluara shprehimisht, nuk janë gjithashtu shprehimisht të disponueshme për personat që i kanë mbijetuar këtyre formave të dhunës.

Kutiza 4

... Prandaj, duhet të krijohet një ligj për dhunën me bazë gjinore, me mbrojtje më gjithëpërfshirëse për personat e mbijetuar ndaj të gjitha formave të dhunës. Ngritja e një grupi pune me specialistë të ministrive të linjës dhe ekspertë të fushës dhe shoqërisë civile për të filluar konsultimin e ideve dhe më pas për të kaluar në përgatitjen e nismës ligjore dhe të akteve nënligjore. Ligji i ri do të ndikojë në shumë ligje dhe akte nënligjore në fuqi, ndaj grupi do të duhet të shohë të gjithë kuadrin ligjor dhe ta paraqesë si paketë në Kuvend. Për një ligj të mirë, parlamentit do t'i duhet të shohë edhe projektet e akteve nënligjore me qëllim që të këtë përputhje dhe rregullim të plotë mes ligjit dhe akteve.

Vasilika Hysi, Ish Nënkryetare e Kuvendit të Shqipërisë

LDHF parashikon këto shërbime të specializuara: qendra rehabilitimi, shërbime akomodimi; referim të rasteve; mbështetje të menjëhershme mjekësore, sociale dhe psikologjike; mbledhjen e provave mjeko-ligjore. Sigurimi i këshillimit ligjor bëhet në një ligj të veçantë, ndonëse referohet në LDHF. Linjat e Këshillimit nuk përmenden në ligj, vetëm në SKBGJ 2021 - 2030, në masën 3.2 për rritjen e financimit për Linjën Kombëtare të Këshillimit. **Si kërkesë e nenit 24 të Konventës së Stambollit, disponueshmëria e linjave të ndihmës ose mbështetja shtetërore për ato që menaxhohen nga OSHC-të duhet të përmendet në LDHF.** Ndërsa LDHF shpjegon në detaje urdhrat e mbrojtjes, ai është mjaft i paqartë në lidhje me masat e tjera të mbrojtjes dhe shërbimet mbështetëse, duke i renditur ato kryesisht nën përgjegjësitë e autoriteteve të ndryshme shtetërore. **Duke qenë se shërbimet e specializuara janë thelbësore për një përgjigje efektive ndaj dhunës ndaj grave, është e rëndësishme që t'i kushtohet më shumë hapësirë në ligj funksionimit të tyre.** Përveç kësaj, Konventa e Stambollit thekson rëndësinë e mbulimit të duhur gjeografik dhe financimit të mjaftueshëm që këto shërbime të jenë të qëndrueshme. Asnjë prej këtyre elementeve nuk përmendet në ligj, edhe pse SKBGJ 2021-2030 parashtron tregues specifik për mbulimin gjeografik dhe financimin.

Konkluzione:

Një nga pengesat kryesore që hasin gratë në marrjen e shërbimeve dhe mbështetjes në raste të dhunës lidhet me mungesën e njohurive për mekanizmat raportues dhe gamën e shërbimeve që ofrohen. Për këtë arsye Konventa e Stambollit thekson rëndësinë e ofrimit të informacionit për çdo person që raporton dhunë në të gjitha institucionet që kanë një përgjegjësi ligjore në këtë fushë. Edhe legjislacioni shqiptar e parashikon dhënien e informacionit kur një i/e mbijetuar paraqitet në institucionet përkatëse. Megjithatë duhet parashikuar që kjo përgjegjësi i takon të gjitha autoriteteve përgjegjëse dhe të mos jetë e limituar në një lloj shërbimi sikurse parashikon ligji. Për më tepër marrja e informacioneve në një gjuhë që personi e kupton është po ashtu e rëndësishme për të zbatuar parimin e të mos lënit askujt pas. Legjislacioni shqiptar nuk e parashikon këtë, megjithëse KS e konsideron me rëndësi paraqitjen e informacionit në një gjuhë të kuptueshme për atë që po kryen raportimin.

Gama e gjerë e shërbimeve të përgjithshme dhe të veçanta që kërkohen nga KS janë përgjithësisht të përmendura në LDHF, me përjashtim të linjës kombëtare/numrit falas ku çdo person mund të telefonojë për të marrë shërbime. Ajo që vihet re nga LDHF është se edhe pse shërbimet përmenden, ato nuk analizohen më me detaje për të kuptuar si duhen ofruar dhe cilat duhet të jenë parametrat e mbrojtjes së viktimave. Një nga shqetësimet e hasura është mungesa e shërbimeve të territorit. Nëse shërbimet parashikohen në ligj, do të duhet të adresohen edhe në praktikë. Ndryshe ligji është i pazbatuar dhe krijon pasoja negative dhe viktimat humbet besimin te institucionet.

Ngjashëm me masat parandaluese, **do të ishte më efikase nëse LDHF do t'i trajtonte masat mbrojtëse më me detaje, sikurse ka përshkruar masat mbrojtëse që lidhen me urdhrat e mbrojtjes.** Ndaj, një rishikim i ligjit për të përfshirë shpjegimin e detajuar të mekanizmave të mbrojtjes, përveç urdhrave të mbrojtjes, do të garantonte mbrojtje më efektive duke mos lënë vend për paqartësi. Rregullimi mund të bëhet duke parashikuar një nen të veçantë ku të trajtohen të gjitha masat mbrojtëse, përfshirë edhe linjën e këshillimit, ndihmën juridike, psikologjike, shërbimet për viktimat e dhunës seksuale në familje, etj. Gjithashtu mund të parashikohet transferimi i viktimës në qendrat e bashkive të tjera. Megjithatë shtretërit dhe mundësitë janë të pakta.

Ndjekja Penale

Konventa e Stambollit kriminalizon format e ndryshme të dhunës përfshirë edhe dhunën në familje. Kriminalizimi i formave të ndryshme të dhunës, edhe ato forma të cilat ende nuk janë të përfshira në legjislacionet e shteteve palë, ndihmon në ndjekjen penale dhe ndëshkimin e autorëve si një nga masat parandaluese të dhunës. Ndjekja penale, përveç hetimit me seriozitet të çdo raportimi dhune kërkon edhe funksionimin e sistemit gjyqësor në mbrojtje të të mbijetuarve të dhunës duke respektuar standardet më të larta të mos viktimizimit dhe respektit për viktimat. Në këtë pjesë parashtrihen masat që legjislacioni shqiptar merr për të kriminalizuar dhe ndjekur penalisht autorët e dhunës dhe sa ky përputhet me qëllimet dhe tekstin e Konventës së Stambollit.

Ndjekja Penale			
Nëse një vend ka ratifikuar Konventën e Stambollit, do të duhet të marrë masat e mëposhtme:	LDHF	VKM 327	SKBGJ 2021-2030
E drejta e Viktimës			
Mbrojtje e menjëhershme e viktimave	Po	Po	Po
Urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes	Neni		Masa
Urdhrat e mbrojtjes	14		III.1.2

Hetimi Ndhmë ligjore falas			
Mbrojtja e fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë Fëmijëve duhet t'u sigurohen masat e duhura të mbrojtjes Fëmijë viktimë të dhunës seksuale, apo martesës së detyruar, gjymtimit gjenital femëror dhe abortit ose sterilizimit të detyruar do të jenë në gjendje të iniciojnë veprime ligjore për një kohë të mjaftueshme pasi të kenë arritur moshën madhore	Po	Jo	Jo
Vlerësimet e koordinuara të rrezikut Do të kryhet në bashkëpunim me agjencitë dhe institucionet përkatëse, duke marrë përsëritjen e veprave penale dhe aksesin në armë zjarri në konsideratë, si dhe çdo informacion të ri që hetimi mund të nxjerrë në dritë	Po Neni 6,7,13	Po, Neni 3,4,5,7	Jo
Asnjë fajësim për viktimat Hetimet dhe procedurat gjyqësore do të respektojnë viktimat në të gjitha fazat dhe nuk do të shfaqin qëndrime, sjellje dhe praktika që fajësojnë viktimat dhe u shkaktojnë atyre shqetësime shtesë	Jo	Jo	Jo
E drejta e viktimave për informacion dhe mbështetje dhe që të mbahen të informuara për ecurinë dhe rezultatin e rastit të tyre. Qasje në informacion mbi të drejtat e viktimës dhe shërbime të përshtatshme mbështetëse për t'i ndihmuar ato që përfaqësojnë ato të drejta dhe interesa. Mbështetje dhe ndihmë nga organizatat qeveritare dhe joqeveritare dhe këshilltarët e dhunës në familje gjatë hetimeve dhe procedurave gjyqësore. E drejta për ndihmë juridike dhe ndihmë juridike falas. Sigurimi i përkthyesve të pavarur dhe kompetent nëse është e nevojshme. Mbështetje nga ligji për të kërkuar dëmshpërblim nga autorët e dhunës dhe për të paditur autoritetet shtetërore nëse kanë dështuar në detyrat e tyre parandaluese dhe mbrojtëse.	Po	Po	Po

Mbrojtja e menjëhershme e personave të mbijetuar nga dhuna nga agjencitë e zbatimit të ligjit mbulohet nga neni 50 i Konventës së Stambollit, brenda seksionit të ndjekjes penale. Si i tillë, ai kërkon që shtetet palë të sigurojnë që viktimat të kenë akses të menjëhershëm në mbrojtje. Përveç kësaj Konventa e Stambollit rekomandon:

- E drejta e organeve përgjegjëse ligjzbatuese për të hyrë në vendin ku ndodhet një person në rrezik;
- Trajtimi dhe këshillimi i viktimave nga agjencitë përgjegjëse të zbatimit të ligjit në mënyrën e duhur;

- Dëgjimi i viktimave pa vonesë nga personeli i trajnuar posaçërisht, sipas rastit, mundësisht personel gra për të krijuar një marrëdhënie besimi midis viktimës dhe personelit të zbatimit të ligjit; dhe
- Sigurimi i një numri të përshtatshëm oficeresh gra të zbatimit të ligjit, përfshirë në nivele të larta përgjegjësie.

Në LDHF, garancitë e mbrojtjes bëhen në nenin 7/1 dhe më tej në nenin 8, i cili përcakton se autoritetet përgjegjëse kanë për detyrë t'u përgjigjen të gjitha njoftimeve nga një i mbijetuar ose persona të tjerë që raportojnë çdo rast dhune ose kërcënimi për dhunë.

Në rastet kur ka shkelje të urdhrave të mbrojtjes, **ligji nuk specifikon apo referon personelin gra të zbatimit të ligjit ose nuk përcakton se viktimat ka të drejtë të zgjedhë gjininë e oficerit të policisë që dëgjon çështjen e saj.** Ky specifikim në një seksion mbi të drejtat e viktimës do ta bënte më të lehtë për personat e mbijetuar, që ta bënin këtë kërkesë duke përmbushur kështu dispozitat e Konventës së Stambollit. SKBGJ 2021-2030 përmban një masë për trajnimin e oficerëve të policisë për largimin e menjëhershëm të autorëve nga shtëpia e përbashkët kur ndodh dhuna, në përputhje me ndryshimet e vitit 2020 në LDHF. Megjithatë, ai nuk i referohet të dhënave të ndara sipas gjinisë për oficerët e policisë të trajnuar dhe nuk e vë theksin në shtimin e oficerëve të policisë gra si personel të trajnuar të zbatimit të ligjit që merret me rastet e dhunës në familje.

Neni 52 i Konventës së Stambollit konsideron se në situata rreziku është e rëndësishme të arrihet distanca e menjëhershme ndërmjet viktimës dhe autorit, për të cilën një urdhër ndalimi emergjent siguron që dhunuesi të jetë fizikisht i larguar nga viktimat. Konventa e Stambollit ia lë në dorë shteteve palë të vendosin se cili autoritet kompetent do të kryejë një detyrë të tillë. Në Shqipëri, ndryshimet në LDHF në vitin 2018 sollën masa të reja të rëndësishme mbrojtëse. Këto ndryshime ngarkuan policinë me lëshimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes emergjente, të cilët parashikojnë largimin e viktimës nga shtëpia në situatë rreziku imediat dhe shoqërimin e saj në strehëzat emergjente, pastaj brenda 48 orëve gjykata duhet të lëshojë urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje.

Kutiza 5

"Dua të theksoj se kuadri ligjor edhe i politikave në Shqipëri lidhur me barazinë gjinore dhe dhunën në familje është përmirësuar shumë ndër vite, falë vullnetit politik, angazhimit të institucioneve shtetërore ligjvënëse dhe ekzekutive, kontributit të organizatave të shoqërisë civile (sidomos atyre që trajtojnë të drejtat e njeriut apo barazinë gjinore), kontributit dhe mbështetjes së organizatave ndërkombëtare, etj. Megjithatë, sa i takon legjislacionit që trajton çështjen e dhunës ndaj gruas, mendoj që ka nevojë në vazhdimësi për përmirësime ligjore, për shkak të dinamikave dhe problematikave që dalin në praktikë nga zbatimi i legjislacionit ekzistues, por edhe domosdoshëmëria për një ligj të ri, i cili të trajtojë çështje të dhunës ndaj grave në të gjitha format dhe në të gjitha fushat (pra jo vetëm dhunën në marrëdhëniet familjare). Sidoqoftë sfida më e madhe mbetet zbatimi në praktikë i kuadrit legjislativ dhe atij të politikave.

Eglantina Gjermani, ish Kryetare e Nënkomisionit Parlamentar për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Grave, Ambasadore e Shqipërisë në Vienë.

Në ndryshimet e vitit 2020 në LDHF u shtua se në urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes të lëshuar nga gjykata, autori duhet të largohet nga banesa e përbashkët dhe të ndalohej çdo kontakt me viktimën. VKM 327 ngarkon koordinatorin Vendor me monitorimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes dhe informimin e personave të mbijetuar për të drejtat e tyre dhe procedurat për marrjen e tij. Sidoqoftë, koodinatori vendor nuk ka mundësi fizike të monitorojë urdhrat. Detyrat dhe përgjegjësitë e tij janë të shumta. Numri i tyre në shumë bashki është i vogël. Ka një ligj për mbikëqyrjen elektronike që parashikon monitorimin nga shërbimi i provës, po ai nuk parandalon rastet kur dhunuesi i afrohet viktimës kur ajo është jashtë banese. Rekomandimet nga raporti i vlerësimit të GREVIO 2017 për Shqipërinë³² në lidhje me urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes si dhe urdhrat e mbrojtjes janë adresuar në ndryshimet e vitit 2018 në LDHF, **megjithatë zbatimi i tyre në praktikë është shumë problematik** siç do të shpjegohet në seksionet e mëposhtme mbi reagimin institucional ndaj dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Sipas të dhënave nga Rrjeti i Monitorimit Kundër Dhunës Ndaj Grave: "gjatë vitit 2021 janë evidentuar dhe trajtuar nga ana e strukturave të policisë 5312 raste të dhunës në familje. Të dëmtuar nga dhuna dhe krimet e tjera në familje janë 5454 persona. Të ndara sipas gjinisë, të dëmtuara nga dhuna në familje ishin 3960 gra/vajza. Bashkëshorte të dëmtuara nga dhuna ishin 1881 gra. Janë trajtuar me kërkesë padi për lëshimin e UMM/UM 3266 raste të dhunës në familje. Janë evidentuar 169 raste të shkeljes së urdhrave të mbrojtjes. Ka filluar procedimi penal (sipas nenit 130/a të KP) për 1361 raste dhe janë arrestuar 638 autorë. Janë evidentuar 16 raste të

³² GREVIO. 2017. Baseline Evaluation Report Albania. Online: <https://rm.coe.int/grevio-first-baseline-report-on-albania/16807688a7>

veprës penale “Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare” parashikuar në nenin 79/c të Kodit Penal me 16 viktimë, nga të cilat 10 gra/vajza”³³

Edhe raporte dhe studime të organizatave të ndryshme në mbrojtje të grave e vajzave tregojnë për rritje të numrit të rasteve të dërguara për gjykim për çështje për veprën penale të dhunës në familje. Sipas QDNJD rezultojnë se: “nëse i referohemi të dhënave statistikore rezultojnë se për vitin 2020-2021 janë dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë 721 (341 për vitin 2020 dhe 380 për vitin 2021) çështje për veprat penale të dhunës në familje (neni 130/a dhe 321/2 i Kodit Penal). Gjithsej janë gjykuar 712 të pandehur për këto vepra (327 për vitin 2020 dhe 385 për vitin 2021.³⁴)” Në të njëjtin studim prezantohen të dhëna në lidhje me masën e dënimit. “Dënimet variojnë nga 8 ditë në 5 vite. Në 61% të vendimeve gjykata ka vendosur dënime më pak se 1 vit. Në gati 28% të vendimeve gjykata ka vendosur dënime nga 1-2 vite. Në vetëm 11% të vendimeve, gjykata ka aplikuar dënime nga 2-5 vite burgim”.³⁵

Garantimi i sigurisë së viktimës qëndron në qendër të Konventës së Stambollit dhe të çdo ndërhyrjeje për të trajtuar të gjitha format e dhunës ndaj grave. Konventa e Stambollit vendos një detyrim për të siguruar që të gjitha autoritetet vlerësojnë dhe hartojnë një plan për të menaxhuar rreziqet e sigurisë me të cilat përballen viktimat, rast pas rasti dhe duke marrë parasysh situatat e tyre specifike. Vlerësimi i rrezikut iu shtua LDHF-së me ndryshimet e vitit 2018 duke ngarkuar policinë si përgjegjëse për kryerjen e vlerësimit të rrezikut. Megjithatë, VKM 327 e rishikuar në 2021 parashikon që si koordinatori lokal i DHF ashtu edhe policia duhet të kryejnë vlerësimin e rrezikut dhe të hartojnë një plan sigurie bazuar në këtë vlerësim. Një nga problemet që konstatohet në disa ligje është se aktet nënligjore dalin përtej parashikimeve të ligjit dhe kjo krijon paqartësi “kush do të bëjë çfarë” dhe askush nuk e përmbush detyrimin. Është kjo arsyeja që çdo ndryshim në ligj do të duhet të shoqërohet me paketën e projektakteve nënligjore.

Duhet të ketë përafrim midis LDHF-së dhe VKM-së 327 në lidhje me përgjegjësitë për vlerësimin e rrezikut, si një nga masat më të rëndësishme për të parandaluar përshkallëzimin e dhunës. Në Kodin Penal parashikohet dënimi për vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare me burgim të përjetshëm. Nuk lejohet gjykimi i shkurtuar dhe për rrjedhojë nuk përfitohet ulje dënimi.³⁶ Në rastet e plagosjes së rëndë për shkak të marrëdhënieve familjare, kur nga vepra mund të vijë edhe vdekja, dënimi penal varion nga 5-15 vjet. Ky dënim është shumë i ulët krahasuar me dëmin e shkaktuar. **Ndaj, dënimi në nenin 88/2 të Kodit Penal ka nevojë të rishikohet në rastet kur ka ardhur vdekja ose pasojat janë të rënda.**

³³Raport monitorimi: “Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planit të saj të Veprimit 2021-2030”, për vitin 2021, f.13-14. Ky raport u nda në Mbledhjen e pestë të Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore, 9 Shtator 2022.

³⁴QDNJD, Studim, “Sistemi gjyqësor si pararendës në mbrojtjen e të drejtave të viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje”, Tiranë 2021, f.52. <https://ëëë.hrdc.al/index.php/al/sherbime/studime>

³⁵ QDNJD, Studim, “Sistemi gjyqësor si pararendës në mbrojtjen e të drejtave të viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje”, Tiranë 2021, <https://ëëë.hrdc.al/index.php/al/sherbime/studime>, f.62

³⁶ Shih Neni 79/c, Kodi Penal.

Kodi Penal parashikon ekstradimin e personit që ka kryer një vepër penale dhe është larguar jashtë vendit. Ose e ka kryer veprën penale jashtë dhe është shtetas shqiptar ose i huaj por viktima është shqiptare.³⁷

Neni 130/a në të katër paragrafet e tij është riparë tre herë.³⁸ Dënimet variojnë nga 5 ditë deri në 10 vjet dhe kur kryhen në prani të fëmijëve ose në mënyrë të përsëritur nga 1- 5 vjet. Në këtë rast bëhet fjalë vetëm për rrahjen, kanosjen dhe plagosjen e lehtë, pasi plagosja e rëndë dhe vrasja janë vepra penale të veçanta. **Para se të propozohen ndryshime për këtë nen, do të ishte e rekomandueshme të bëhet një vlerësim i politikës penale të zbatuar nga gjykata dhe të ndikimit të saj që nga momenti i ndryshimit e deri tani.**

Ndjekja Penale në Konventën e Stambollit ka disa masa të cilat duhet të përafrohen në Kodin Penal, megjithëse disa prej tyre janë përfshirë në legjislacionin shqiptar. Më poshtë paraqiten masat të cilat duhet të përafrohen sipas Konventës së Stambollit, dhe janë theksuar ato që janë përfshirë në legjislacionin shqiptar.

Sanksione bindëse për autorët. Të sigurohet që veprat penale dhe shkeljet e urdhrave të mbrojtjes do t'i nënshtrohen sanksioneve proporcionale penale ose ligjore duke përfshirë burgimin, ekstradimin siç është parashikuar në Kodin Penal, monitorimin dhe mbikëqyrjen sic parashikohet në ligj³⁹, si dhe heqjen e të drejtave prindërore e cila është parashikuar në ligje që në vitin 2012.⁴⁰

Prokuroria efektive. Hetimi ose ndjekja penale e veprave të dhunshme ndaj grave do të marrë parasysh se gratë janë të prekura në mënyrë disproporcionale nga dhuna; nuk do të varen nga një raport ose ankesë nga viktima dhe madje hetimi duhet të vazhdojë edhe nëse viktima tërheq deklaratën ose ankesën e saj. Kjo e fundit është rregull në ligj. Veprat penale të dhunës në familje

³⁷ Shih nenet 6, 7, 11 të KP

³⁸ Neni 130/a i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim gjer në dy vjet.

Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim gjer në tre vjet.

Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

Po këto vepra, të kryera në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, dënohen nga një deri në pesë vjet.

³⁹ Ligji për mbikëqyrjen elektronike mundëson përdorimin e byrzylykut elektronik për të mbikëqyrur dhunuesin dhe monitoruar atë që të mos i afrohet viktimës.

⁴⁰ Amendamenti Hysi. Shih neni 30, pika 11 dhe neni 43/a i Kodit Penal. Lidhur me zbatimin e Kodit Penal duhet ndërgjegjësim për zbatimin e dënimeve kryesore dhe plotësuese. Zbatimi i dënimeve plotësuese kërkon shërbime në territor për nënën dhe fëmijën.

fillojnë kryesisht nga prokurori ose me kallëzimin e viktimes. Neni 59 dhe 284 i Kodit të Procedurave Penale nuk parashikon që terheqja e ankimit të jetë shkak për pushimin e ndjekjes penale nëse ka filluar ose mosfillimin e saj ose të gjyqimit.

Adresimi i faktorëve që çojnë në dhunë dhe krijimi i programeve të parandalimit të hershëm të shkaqeve që çojnë në dhunë në familje.

Konsiderimi i rrethanave rënduese. Të sigurohet që të merren parasysh rrethanat rënduese, duke përfshirë që viktima është në një lidhje intime ose të ngushtë, krimet kundër një personi të cenueshëm ose në prani të një fëmije, në bashkëpunim me persona të tjerë, nivele ekstreme të dhunës ose dëmtim psikologjik, kërcënim me armë ose dënime të mëparshme për krime të natyrës së ngjashme. Kjo masë është adresuar në Kodin Penal, në nenin 50, që në vitin 2013.

Legjislacioni që kriminalizon dhunën ndaj grave. Duhet të prezantohet ligje që kriminalizojnë dhunën fizike, psikologjike dhe seksuale, ngacmimin seksual, ndjekjen, gjymtimin gjenital femëror, martesën e detyruar, abortin e detyruar dhe sterilizimin e detyruar. Shtetet palë duhet të sigurojnë që kultura, tradita apo i ashtuquajtur "nder" të mos konsiderohen si justifikim për dhunën. Kjo masë është adresuar në Kodin Penal, në nenin 48 dhe 50 të ndryshuar.

Hetim efektiv i policisë. Agjencitë e zbatimit të ligjit do të duhet t'i përgjigjen menjëherë thirrjeve për ndihmë, të menaxhojnë situatat e rrezikshme në mënyrë të përshtatshme dhe të hetojnë të gjitha akuzat për dhunë ndaj grave. Kjo çështje është disi e adresuar me urdhërat e menjehershëm të mbrojtjes, sidoqoftë do të ishte e rekomandueshme të bëhet një vlerësim i dhënies dhe zbatimit të Urdhërave të Menjëhershëm të Mbrojtjes.

Konkluzione:

Megjithë përmirësimet në LDHF në vitet e fundit për të shtuar masat e mbrojtjes ndaj viktimave të dhunës, ende mbeten disa dispozita që mund të përmirësohen. Për shembull, dhënia e urdhrave të mbrojtjes garantohet sipas gjuhës së ligjit për personat që kanë përjetuar dhunë në familje, **duke lënë kështu jashtë forma të tjera të dhunës, përtej asaj në marrëdhëniet familjare.**

Shtesa e vlerësimit të riskut është një arritje për garantimin e sigurisë së viktimës dhe mos lejimin e përshkallëzimit të dhunës. Megjithatë LDHF dhe VKM 327 nuk janë të harmonizuara në këtë masë dhe ngarkimi i Koordinatorit Vendor me përgjegjësinë e përgatitjes së vlerësimit të riskut, edhe pse një masë e mirëpritur, mund të mos jetë realiste duke pasur parasysh kufizimet kohore dhe kufizime të tjera me të cilat ato përballen, pasi shpesh dhuna ndodh jashtë orareve normale të punës e rrjedhimisht kërkon përgjigje të menjehershme. Ndaj është e rëndësishme të shikohet praktika e dy viteve të fundit në lidhje me vlerësimin e riskut për të parë nëse një masë e tillë funksionon në praktikë apo jo.

Politikat e Integruara

Pa koordinim dhe qasje gjithëpërfshirëse në adresimin e dhunës me bazë gjinore, çdo ndërhyrje nga institucione individuale do të ishte e fragmentuar dhe nuk do të sillte rezultatet e duhura për mbrojtjen e viktimave, ndjekjen penale të autorëve dhe parandalimin dhe zhdukjen e këtij fenomeni. Ndaj politikat e integruara përbëjnë një nga shtyllat themelore të Konventës së Stambollit me kërkesa specifike për shtetet palë. Shqipëria ka bërë progres të konsiderueshëm në këtë kuadër, si në kornizën ligjore ashtu edhe politike, duke e vendosur çështjen e barazisë gjinore dhe luftën kundër dhunës ndaj grave në prioritet të politikave publike dhe vullnetit politik. Kjo ka qenë e qartë nga rishikimi thelbësor i ligjit të DHF në 2018 dhe 2020, rishikimi tërësor i VKM për funksionimin e mekanizmave të referimit, hapja e qendrës së parë të trajtimit të dhunës seksuale, themelimi i mekanizmave të referimit në të gjitha bashkitë e vendit dhe shtimi i burimeve financiare në dispozicion të kësaj fushe. Ky seksion do të analizojë më në detaje qasjen e legjislacionit shqiptar për ndërmarrjen e politikave të integruara në adresimin e dhunës me bazë gjinore. Tabela më poshtë paraqet masat konkrete që Konventa e Stambollit kërkon nga shtetet palë për të garantuar që qasja ndaj dhunës me bazë gjinore është e koordinuar, gjithëpërfshirëse dhe i jepet rëndësia e duhur përmes burimeve njerëzore, financiare dhe infrastrukturore.

Politikat e Integruara			
Nëse një vend ka ratifikuar Konventën e Stambollit, do të duhet të marrë masat e mëposhtme:	LDHF	VKM 327	SKBGJ 2021-2030
Bashkëpunimi ndërmjet agjencive Sigurohuni që ekzistojnë mekanizmat e duhur që sigurojnë bashkëpunim ndërmjet gjyqësorit, prokurorëve publikë, agjencive të zbatimit të ligjit, autoriteteve vendore dhe rajonale dhe OJQ-ve	Po	Po	Po
Mbështetni dhe punoni me shoqërinë civile dhe OJQ-të Ato duhet të përfshihen përkrah organeve shtetërore si partnerë të vlefshëm në zbatim të Konventës së Stambollit	Po	Po	Po
Koordinoni veprimet dhe monitoroni zbatimin Krijoni ose caktoni një organ shtetëror për të mbikëqyrur koordinimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e Konventës së Stambollit.	Jo	Jo	Jo
Reagimi i gjithë shoqërisë Konventa e Stambollit i dërgon një mesazh të qartë shoqërisë në tërësi. Të gjithë duhet ta kuptojnë që dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje nuk do të tolerohet	Po	Jo	Po

Financimi për politikat dhe shërbimet Të financojë në mënyrë adekuate të gjithë partnerët e përfshirë në zbatimin e Konventës së Stambollit, duke përfshirë edhe organizatat joqeveritare	Pjesërisht Neni 7	Jo	Po
Legjislacion gjithëpërfshirës dhe politika të ndjeshme gjinore Përfshirja e ligjeve dhe masave mbështetëse për të parandaluar të gjitha llojet e dhunës të përfshira në këtë konventë.	Jo	Jo	Jo
Hulumtimi dhe mbledhja e të dhënave Mblidhni dhe grumbulloni të dhëna dhe bëni kërkime mbi përhapjen e të gjitha formave të dhunës kundër grave dhe efektivitetin e masave të tyre, të cilat do të ndahen me publikun dhe agjenci të ngjashme në vende të tjera, për krahasim dhe për të inkurajuar bashkëpunimin	Po Neni 6, Neni 7	Po, Neni 13	Po

Qasja gjithëpërfshirëse dhe e koordinuar për trajtimin e dhunës ndaj grave në të gjitha format e saj duhet të jetë një parim udhëzues i çdo politike për të luftuar dhunën me bazë gjinore, pasi u siguron personave të mbijetuar ofrimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse nga shumë aktorë dhe ofrues shërbimesh. Konventa e Stambollit kërkon nga shtetet palë të zbatojnë politika që përfshijnë një mori masash nga aktorë të ndryshëm, të cilët ofrojnë një përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj dhunës me bazë gjinore. Megjithatë, ekzistenca e shërbimeve sado të mëdha në numër të jenë nuk është e mjaftueshme për të siguruar përgjigje efektive, sepse këto shërbime duhet të mbështeten në koordinimin dhe bashkëpunimin e shumë agjencive. Raporti shpjegues i Konventës së Stambollit tregon më tej se përvoja nga terreni ka vërtetuar se rezultatet rriten kur agjencitë e zbatimit të ligjit, gjyqësori, organizatat joqeveritare të grave, agjencitë për mbrojtjen e fëmijëve dhe partnerë të tjerë përkatës bashkojnë forcat për shembull për të kryer një vlerësim të saktë të rrezikut ose të hartojnë një plan sigurie për personat e mbijetuar.

Legjislacioni shqiptar ka një fokus të fortë në koordinimin e masave dhe reagimeve ndaj dhunës ndaj grave, veçanërisht në nivel vendor. VKM 327 fokusohet ekskluzivisht në një reagim të koordinuar ndaj dhunës nëpërmjet bashkëpunimit të institucioneve të ndryshme në nivel vendor. LDHF parashikon gjithashtu një grup të plotë politikash dhe masash nga institucione të ndryshme dhe i vendos përgjegjësitë kryesore Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si autoriteti kryesor në zbatimin e ligjit. **Megjithatë, duhet të theksohet se LDHF nuk i shpjegon detyrat koordinuese të autoritetit kryesor dhe as nuk shpjegon marrëdhëniet që duhet të ekzistojnë ndërmjet autoriteteve të ndryshme të përmendura në ligj.** Ndërsa përmendet se agjencia kryesore zbatuese duhet të koordinojë politikat, ajo nuk specifikon se si duhet të koordinojë përpjekjet e saj për të luftuar dhunën ndaj grave.

Konventa e Stambollit vendos theksin në mbledhjen e të dhënave dhe kryerjen e studimeve mbi dhunën ndaj grave si mekanizëm për të informuar politikëbërjen në këtë fushë. Raporti shpjegues

i Konventës së Stambollit kërkon mbledhjen sistematike dhe adekuate të të dhënave si një komponent thelbësor i politikëbërjes efektive. Gjithashtu, nënvizon nevojën për të mbështetur kërkimin në fushën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Paragrafi 2 detajon detyrimin e palëve që të përpiqen të kryejnë anketa në popullatë. Kjo nënkupton mbledhjen e të dhënave që janë statistikisht përfaqësuese në mënyrë që ato të mund të përgjithësohen lehtësisht për të gjithë vendin. Këto anketa mund të ofrojnë njohuri më të përgjithshme të orientuara sociologjikisht mbi përhapjen, natyrën, përcaktuesit dhe pasojat e të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i Konventës.⁴¹ Të tre pjesët kryesore të legjislacionit dhe dokumentet e politikave të listuara në tabelën e mësipërme përmbajnë dispozita që lidhen me mbledhjen e të dhënave. Më konkretisht neni 6 dhe 7 i LDHF përcakton detyrat e ministrisë përgjegjëse për zbatimin e ligjit për mbledhjen e të dhënave si dhe përgjegjësinë e ministrisë përgjegjëse për drejtësinë për mbledhjen dhe publikimin e të dhënave. Gjithashtu, VKM 327 parashikon mbledhjen e të dhënave në nivel vendor në sistemin tashmë të krijuar REVALB.

SKBGJ 2021-2030 përmban më tej masa specifike për mbledhjen dhe ndarjen e të dhënave. Megjithatë, duhet theksuar se edhe pse Instituti i Statistikave nuk është ndër institucionet e listuara në LDHF, ky institucion luan rol vendimtar në mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e të dhënave. **INSTAT tashmë publikon raportin vjetor të Grave dhe Burrave në Shqipëri⁴², i cili përmban ndër të tjera të dhëna për dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje.** Gjithashtu, INSTAT ka kryer disa anketa për dhunën ndaj grave.⁴³ Ekziston një mirëkuptim në nivel global për rëndësinë e mbledhjes më të mirë të të dhënave në lidhje me dhunën ndaj grave. Ajo është njohur në instrumente të ndryshme ndërkombëtare, si në rezolutën e Parlamentit Evropian për eliminimin e dhunës ndaj grave (2009)⁴⁴, në konkluzionet e Këshillit të BE-së për çrrënjosjen e dhunës ndaj grave (2010)⁴⁵ si dhe në Konkluzionet e Këshillit mbi Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës në familje.⁴⁶

Media, edhe pse e pavarur, duhet të përfshihet si aktor i rëndësishëm në ligj, veçanërisht në fushën e parandalimit. Duke njohur dhe respektuar plotësisht pavarësinë dhe paanshmërinë e mediave, është e rëndësishme të fokusohemi edhe në përgjegjësitë dhe ndikimin e tyre në sferën publike. Prandaj, ligji mund të shtojë përgjegjësitë e medias ndër të tjera:

⁴¹Konventa e Stambollit. Neni 3.a përcakton: dhunë kundër grave” kuptohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike ose private.

⁴²INSTAT, 2022. Gratë dhe Burrat në Shqipëri 2021. Online: <http://ëëë.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/barazia-gjinore/publikimet/2021/grat%C3%AB-dhe-burrat-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-2021/>

⁴³ INSTAT, 2019. Dhuna ndaj Grave e Vajzave në Shqipëri. Online:

⁴⁴ European Parliament resolution of 26 November 2009 on the elimination of violence against women. Online: https://ëëë.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-7-2009-0098_EN.html

⁴⁵ Council conclusions on Combating Violence Against Women, and the Provision of Support Services for Victims of Domestic Violence.

⁴⁶ Council conclusions on Combating Violence Against Women, and the Provision of Support Services for Victims of Domestic Violence. Online: <https://eige.europa.eu/gender-based-violence/data-collection>

- Në kuadër të rishikimit të Ligjit për Media Audiovizive, sugjerohet që ky ligj të përafrohet me direktivën 2018 të BE për median e cila duhet të adresojë më mirë çështjet e dhunës me bazë gjinore dhe barazinë gjinore.
- Miratimi i kodeve të etikës dhe masave të tjera të vetërregullimit, veçanërisht lidhur me shpërndarjen e përmbajtjeve diskriminuese të lidhura me dhunën ndaj grave, që justifikojnë ose përforcojnë tolerancën ndaj asaj dhune ose që cenojnë të drejtat e grave.
- Të caktohet një hapësirë minimale e lirë për shpërndarjen e mesazheve që promovojnë vlerat e përcaktuara në LDHF. Kjo mund dhe duhet të realizohet mes RTSH-së që është televizion publik dhe ligji e parashikon këtë rol të këtij televizioni. Gjithashtu, projekti i Kodit të Transmetimit inkurajon të gjithë ofruesit e shërbimeve të medias audiovizive të promovojnë barazinë gjinore, të luftojnë stereotipet gjinore, dhunën me bazë gjinore, seksizmin si dhe të promovojnë modelet pozitive të grave dhe burrave në shoqëri.
- Gjithashtu, LDHF grupon institucionet arsimore dhe institucionet përgjegjëse për punësimin në një dhe parashikon pak detyra dhe përgjegjësi për to. Por duke pasur parasysh rëndësinë e parandalimit dhe edukimit, rol që duhet të mbahet nga institucionet arsimore, si dhe rëndësinë e pavarësisë financiare dhe riintegrimin ekonomik të grave të mbijetuara të dhunës, **kjo pjesë e ligjit duhet të rishikohet për të përcaktuar qartë detyrat e çdo institucioni në lidhje me përgjigjen e koordinuar kundër dhunës dhe riintegrimin e personave të mbijetuar.** Rishikimi duhet të adresojë dhe referojë masat që parashikon ligji për nxitjen e punësimit dhe të strehimit social. Një theks i vecantë i duhet dhënë zbatimit të ligjeve.

Konkluzione:

Megjithëse legjislacioni shqiptar krijon një rrjet të koordinuar institucionesh në nivel qendror dhe vendor, ka ende vend për përmirësim në mënyrë që rolet të jenë të qarta dhe raportimi e monitorimi i zbatimit të ligjit të bëhet në mënyrë sa më efikase. Së pari, edhe pse ligji përcakton një autoritet kryesor përgjegjës për zbatimin e ligjit, nuk e trajton më në detaje rolin koordinues të këtij institucioni, se si autoritetet e tjera përgjegjëse duhet të komunikojnë dhe të koordinohen me autoritetin përgjegjës. Për më tepër ka edhe institucione të tjera të cilat nuk janë përfshirë në ligj dhe që do të mundësonin një qasje edhe më gjithpërfshirëse, si për shembull Instituti i Statistikave dhe media. Gjithashtu rolet dhe detyrimet e disa prej institucioneve janë të pamjaftueshme, si për shembull grupimi i ministrisë përgjegjëse për arsimin me ministrinë përgjegjëse për punësimin. Detyrat e tyre duhet të veçohen dhe zgjerohen më tej.

Seksioni III. Ndërsektorialiteti i dhunës: Një analizë e çështjeve ndërsektoriale që lidhen me DHF

Gratë me Aftësi të Kufizuara

Është vërtetuar përmes hulumtimeve dhe të dhënave se gratë me aftësi të kufizuara përjetojnë një shkallë më të lartë të dhunës sesa burrat me aftësi të kufizuara. Incidenca e keqtrajtimit dhe abuzimit ndaj grave me aftësi të kufizuara gjithashtu e kalon shumë atë të grave të cilat nuk kanë ndonjë paaftësi.⁴⁷ Më tej, për shkak të stigmës që lidhet me raportimin e dhunës seksuale dhe të dhunës me bazë gjinore dhe faktit që autorët ndonjëherë janë anëtarë të familjes, prania e një anëtarë të familjes shoqëruese mund t'i dekurajojë gratë që të tregojnë. Gratë me aftësi të kufizuara janë gjithashtu të diskriminuara dhe përballen me sfida të shtuara për shkak të gjinisë, moshës dhe paaftësisë së tyre. Ekzistojnë vlerësime se 40 -70 % e vajzave me aftësi të kufizuara abuzohen seksualisht para se të mbushin moshën 18 vjeç.⁴⁸

Në Shqipëri ka pak studime, kërkime dhe të dhëna për dhunën ndaj grave e vajzave me aftësi të kufizuara. Ndërsa vitet e fundit janë bërë përmirësime për mbledhjen e të dhënave, si përdorimi i sistemit REVALB i cili identifikon nëse një viktimë ka një paaftësi, ky sistem është ende i fragmentuar. Një studim i vitit 2018 tregoi se vajzat dhe gratë me aftësi të kufizuara janë të ekspozuara ndaj të gjitha formave të dhunës.⁴⁹ Përveç kësaj, ato gjithashtu përballen me dhunën lidhur me aftësinë e kufizuar të tyre, ku gratë me aftësi të kufizuara intelektuale trajtohen më keq, për shkak të vështirësive që mund të hasin në të kuptuarit dhe raportimin e dhunës fizike dhe seksuale. Gratë me aftësi të kufizuara përballen edhe me dhunë pasive, e cila ndikon në mirëqenien e tyre psikologjike dhe mendore, për shkak të paragjyqimeve brenda dhe jashtë familjes. Varësia e tyre ekonomike dhe fizike nga njerëzit e tjerë përkeqëson kushtet që mundësojnë shfaqjen e dhunës.⁵⁰

Prevalenca e lartë e dhunës ndaj grave me aftësi të kufizuara shoqërohet me pak njohuri nga ana e ofruesve të shërbimeve mbi specifikat e dhunës ndaj grave me aftësi të kufizuara. Nuk ka përpjekje sistematike për të trajtuar diskriminimin, mungesën e aksesit dhe paragjykimet në ofrimin e shërbimeve mbështetëse për gratë me aftësi të kufizuara. Mungesa e informacionit dhe njohurive shoqërohet edhe nga faktorë të tjerë si mungesa e aksesit në shërbime të specializuara siç mund të jenë strehëzat. Një raport i vitit 2022 mbi aksesin në strehimore, i kryer nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK)⁵¹, zbuloi se aksesit fizik dhe informacioni ose mungon plotësisht ose nuk plotëson standardet e duhura për të plotësuar nevojat e grave me aftësi të kufizuara.

⁴⁷ Fact Sheet: Violence Against Women and Girls with Disabilities. Online: https://ëëë.un.org/ëomenëatch/daë/csë/csë57/side_events/Fact%20sheet%20%20VAËG%20ëith%20disabilities%20FINAL%20.pdf

⁴⁸ Ibid.

⁴⁹ ADRF. 2018. Raport Vlerësimi. Dhuna ndaj grave e vajzave nga komunitete të pafavorizuara. UN Women.

⁵⁰ Po aty.

⁵¹ Raporti është ende i papublikuar.

Ekzistojnë dy pjesë kryesore të legjislacionit dhe politikave që prekin personat me aftësi të kufizuara. Së pari, ligji për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara i vitit 2014, përmban një mori masash për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara të kenë akses në shërbime të ndryshme, infrastrukturë, arsim dhe akses në drejtësi. Megjithatë, dhuna ndaj grave me aftësi të kufizuara dhe sigurimi i aksesit të duhur të tyre në shërbime nuk përmendet. **Pavarësisht ekzistencës së LDHF, duke marrë parasysh sfidat specifike me të cilat përballen gratë me aftësi të kufizuara, do të ishte më e përshtatshme që ligji për përfshirjen dhe aksesueshmërinë të përfshihej si një nen më vete për t'u përafëruar me parimin e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit të artikuluar në nenin 4 të ligjit.**

Kutiza 6

LDHF mund të them që deri tani mbetet i pazbatuar për komunitetin e grave e vajzave me aftësi të kufizuara. E them këtë sepse gratë dhe vajzat e këtij komuniteti: (i) nuk e njohin ligjin; (ii) nuk kane informacion ne formate te aksesueshme per te ditur shërbimet qe ekzistojnë; (iii) të varur nga kujdestarët apo antarë të tjerë të familjes; (iv) shërbimet mbështetëse për persona me aftësi të kufizuara të munguara; (v) qendrat që ofrojnë shërbime për gratë e vajzat viktima të dhunës të paaksesueshme në mjedise, informacion, komunikim, transport; (vi) stafi i tyre i pakualifikuar për të trajtuar gratë e vajzat me aftësi të kufizuara.

Blerta Çani, Drejtore Ekzekutive, FSHDPAK

Përveç ligjit, qeveria miratoi së fundmi Planin Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.⁵² **Fatkeqësisht, edhe ky plan nuk i referohet aspak dhunës ndaj grave me aftësi të kufizuara.** Qëllimi i politikës 2 të Planit të Veprimit⁵³ kërkon të rrisë aksesin në ndihmë juridike falas për personat me aftësi të kufizuara. Duke pasur parasysh se të mbijetuarat e dhunës janë një nga kategoritë që duhet të përfitojnë nga ndihma juridike falas, domosdoshmëria e aksesit në drejtësi nga të mbijetuarat e dhunës me aftësi të kufizuara mund të përfshihej në këtë seksion. Nëse do të ketë një vlerësim dhe përshtatje të këtij Plani Veprimi përpara se të skadojë, kjo dispozitë mund të shtohet dhe të mblidhen të dhëna për të.

Qëllimi i politikës nr. 1 të Planit të Veprimit synon të rrisë aksesin në infrastrukturë, shërbime dhe informacion për personat me aftësi të kufizuara. Ky seksion mund t'i referohej edhe të mbijetuarve të dhunës me aftësi të kufizuara, të cilët sipas hulumtimit dhe përvojës në terren, përballen me sfida të rëndësishme në aksesin e shërbimeve për të mbijetuarat e dhunës, të cilat variojnë nga mungesa e infrastrukturës së duhur deri te mungesa e informacionit të disponueshëm në një gjuhë të kuptueshme dhe me shërbime të ndjeshme që plotësojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuara. **Prandaj, është e domosdoshme që nëse Plani rishikohet apo**

⁵²Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025. Online: https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2022/03/Plani-Kombetar-PAK-2021-2025_AL.pdf

⁵³Po aty.

përsëritet të mund të përfshijë në këtë objektiv strategjik rritjen e aksesit për gratë me aftësi të kufizuara të mbijetuara të dhunës ose të kenë një nënobjektiv të veçantë.

Së fundmi, SKBGJ 2021-2030 përfshin ndërsektorialitetin si një parim kyç i të gjitha masave që duhen ndërmarrë dhe përfshin nevojën për të dhëna të ndara, ndër të tjera për aftësinë e kufizuar. Megjithatë, nuk ka masa specifike në këtë Strategji që synojnë aksesin e shërbimeve nga gratë me aftësi të kufizuara, të tilla si numri i strehëzave që ofrojnë informacion në formatin e duhur për gratë me aftësi të kufizuara, strehëzat që ofrojnë akses në infrastrukturë ose shërbime të tjera që ofrohen për gratë me aftësi të kufizuara. Përshtatja dhe monitorimi i mjediseve për të krijuar aksesueshëmërinë për çdo person me aftësi të kufizuar është mjaft i rëndësishëm. Prandaj, ndërsa në përgjithësi SKBGJ 2021-2030 i kushton vëmendje grave me aftësi të kufizuara, ky dokument nuk ka masa të synuara dhe specifike për të siguruar që ato të mund të raportojnë dhunën, të marrin shërbime dhe të marrin mbrojtje dhe mbështetje. Këto mund të shtohen ose në SKBGJ 2021-2030, ose në planin e veprimit për personat me aftësi të kufizuara.

Gratë Rome e Egjiptiane

Ashtu si gratë me aftësi të kufizuara, gratë Rome dhe Egjiptiane përballen me diskriminim dhe paragjykim të shumëfishtë për shkak të përkatësisë së tyre etnike, gjinore dhe kulturore. Një raport i vitit 2018 i kryer nga FSHDPAK ka treguar se numri i denoncimeve për dhunë mbetet vazhdimisht i ulët në këtë grup.⁵⁴ Institucionet përgjegjëse për trajtimin e rasteve dhe sigurimin e rehabilitimit të të mbijetuarve e përforcojnë një qëndrim të tillë pasi shpesh shfaqin sjellje diskriminuese. Dhuna fillon herët në familjet Rome e Egjiptiane dhe vazhdon si një rreth vicioz gjatë gjithë jetës së një gruaje. Ekziston ende një nivel i ulët ndërgjegjësimit dhe njohurie për shërbimet e disponueshme për personat që i kanë mbijetuar dhunës, apo edhe mënyrën e identifikimit të saj. Gratë shpesh nuk dinë se ku të kërkojnë ndihmë dhe gjithashtu nuk u besojnë institucioneve dhe qendrave që ofrojnë shërbime. Kur ato shoqërohen nga OSHC-të e grave, rezultatet janë përgjithësisht më të mira dhe aksesit në shërbime është më i lehtë për t'u marrë. **Prandaj, më shumë financim dhe mbështetje për organizatat e grave Rome e Egjiptiane do të ndihmonte në rritjen e shkallës së raportimit dhe aksesit në shërbime.**

Gratë dhe vajzat Rome e Egjiptiane që janë të mbijetuara të dhunës në familje përballen me më shumë vështirësi se të mbijetuarat e tjera të dhunës në familje për shkak të varfërisë, përjashtimit social dhe mungesës së shërbimeve sociale në zonat ku jetojnë. Stigma sociale dhe turpi janë arsyet kryesore pse gratë Rome rrallë flasin publikisht për përvojat e tyre dhe pse nuk raportojnë incidente të dhunës në familje.⁵⁵ Një sondazh i vitit 2017 tregoi se në Shqipëri rreth 1 në 3 gra e

⁵⁴ ADRF. 2018. Raport Vlerësimi. Dhuna ndaj grave e vajzave nga komunitete të pafavorizuara. UN Ëomen.

⁵⁵ UNDP. 2018. Noëhere to turn. Gender-based violence against roma ëomen. Report of a field study of Roma communities in Albania, Montenegro and the former Yugoslav Republic of Macedonia. Online: https://ëëë.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/eurasia/NoëhereToTurn_Roma_UNDP_RBEC.pdf

vajza të këtij komuniteti e konsiderojnë të pranueshme që burri të godasë gruan e tij dhe anasjelltas.⁵⁶

Ndryshe nga plani i veprimit për personat me aftësi të kufizuara, Planit kombëtar i veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë (2021-2025)⁵⁷ bën referencë dhe përmendje specifike të dhunës me bazë gjinore. Në fakt, masa 2.5.1 parashikon prodhimin e materialeve informative për ndihmën juridike falas, edukimin ligjor të publikut mbi barazinë gjinore, dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore në një format të lexueshëm për Romët dhe Egjiptianët. Në vend të formatit të lehtë për t'u lexuar, duhet të ishte në një gjuhë që ata e kuptojnë. Përveç kësaj, masa 3.3. e Planit të Veprimit synon të mbledhë të dhëna për shërbimet e ofruara nga MKR-të për gratë dhe burrat Romë e Egjiptianë, numrin e urdhrave të mbrojtjes të lëshuar për anëtarët e komunitetit dhe numrin e autorëve që përfitojnë nga shërbimet e riintegritit. Megjithatë, nuk është e qartë nëse këto të dhëna janë mbledhur dhe publikuar. Prandaj, vëmendje duhet t'i kushtohet marrjes së masave konkrete për të vënë në dispozicion këto të dhëna, për të analizuar tendencat dhe për të përshtatur politikat dhe procedurat për të adresuar mangësitë dhe sfidat e identifikuarat. **Një masë tjetër që mund të ishte shtuar në planin e veprimit është trajnimi dhe ndërgjegjësimi i ofruesve të shërbimeve, veçanërisht policisë, për mosdiskriminimin dhe sigurimin e mbrojtjes në mënyrë të barabartë për të gjithë ata që raportojnë dhunën, pavarësisht se cilit grup i përkasin dhe pa paragjykitime.**

Gratë Lesbike, Biseksuale, trans apo tjetër

Gratë e vajzat Lesbike, Biseksuale, trans apo tjetër (LBT) jetojnë nën presion psikologjik nga familjet, miqtë e të afërmit, për shkak të orientimit të tyre seksual. Në përgjithësi, gratë e vajzat nga ky komunitet nuk e denoncojnë dhunën. Dhuna është e pranishme edhe jashtë familjes, në shkollë, punë dhe ambiente shëndetësore. Dhuna ekonomike është gjithashtu e pranishme në gratë e vajzat e komunitetit LBT. Prindërit i dhunojnë psikologjikisht dhe fajësojnë veten për orientimin seksual të fëmijëve të tyre.⁵⁸ Pavarësisht ecurisë në ndryshimin e qëndrimeve të opinionit publik dhe ofrimit të shërbimeve për këtë komunitet, ende ka shumë për të bërë për të minimizuar dhunën e ushtruar ndaj grave e vajzave të këtij komuniteti. Komuniteti transgjinnor është më i diskriminuar dhe përballen me sfida shtesë, veçanërisht lidhur me sigurimin e mjeteve të jetesës.⁵⁹ Personat transgjinnorë (veçanërisht gratë transgjinnore) janë më shumë subjekt i dhunës për shkak të dukshmërisë së tyre. Kjo ilustron nga incidentet e sulmeve (dhe një rast i vrasjes) ndaj grave transgjinnore që janë punëtore seksi.⁶⁰

⁵⁶ Po aty.

⁵⁷ Planit kombëtar i veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë (2021-2025). Online: <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/359>

⁵⁸ ADRF. 2018. Raport Vlerësimi. Dhuna ndaj grave e vajzave nga komunitete të pafavorizuara. UN Women

⁵⁹ Po aty.

⁶⁰ Danish Institute for Human Rights. No date. Study on Homophobia, Transphobia and Discrimination on Grounds of Sexual Orientation and Gender Identity. Online: <https://rm.coe.int/study-on-homophobia-transphobia-and-discrimination-on-grounds-of-sexua/16809c908c>

Gjatë pandemisë COVID-19, të dhënat e mbledhura nga organizatat e të drejtave LGBT treguan se dhuna ndaj personave LGBT ishte intensifikuar pasi shumë prej tyre duhej të ktheheshin me familjet e tyre dhe kështu u përballën me ngacmime dhe dhunë. Një sondazh i publikuar nga Aleanca LGBT, tregoi se 1 në 2 persona LGBT kishte përjetuar dhunë psikologjike dhe bullizëm, disa kishin përjetuar ngacmim seksual. Megjithatë, shumë pak prej tyre e kishin raportuar rastin tek autoritetet.⁶¹

Objektivi specifik 1.2 i Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBT, trajton dhunën ndaj personave LGBT në mjediset arsimore, masë që nuk gjendet në planet e tjera të veprimit që prekin gratë rome dhe gratë me aftësi të kufizuara. Edhe pse studime dhe kërkime të ndryshme tregojnë se dhuna përjetohet kryesisht në shtëpi, në vendin e punës dhe në qendrat shëndetësore, nuk ka masa specifike për t'i trajtuar ato, as në Planin e Veprimit për Personat LGBT të SKBGJ 2021-2030.

Konkluzione:

Gratë nga komunitete të marginalizuara përballen me të gjitha format e dhunës si gra të tjera por ato përballen edhe me forma të tjera dhune dhe diskriminimi për shkak të përkatësisë së tyre etnike, orinetimit seksual apo aftësisë së kufizuar. Ligji i DHF nuk i përmend specifikisht këto grupe dhe as nuk përmban nene të cilat të lidhen me parimet kryesore të zbatimit të ligjit. Sikurse u përmend në analizën ligjore, LDHF nuk e garanton informacionin e aksesueshëm për viktimat e dhunës nga këto grupe. Për më tepër strategjitë kryesore për këto grupe nuk e kanë në fokus, ose e kanë pak në fokus adresimin e dhunës me bazë gjinore për gratë dhe vajzat nga këto grupe. Më tej edhe SKBGJ që e përfshin ndërsektorialitetin dhe e ka të qartë parimin e përfshirjes së nevojave të tyre në aktivitetet dhe qëllimet e saj strategjike nuk ka një sërë aktivitetesh që t'i drejtohen specifikisht këtyre grupeve. Më tej stigma, diskriminimi dhe mungesa e informacionit dhe ndërgjegjësimit të shumë profesionistëve të fushës së shërbimeve i shtojnë një tjetër arsye dekurajimi grave dhe vajzave nga këto grupe për të mos e raportuar dhunën. Duhet punuar më tepër si me institucionet ashtu edhe në nivel komuniteti për të luftuar manifestimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave që i përkasin grupeve të pafavorizuara.

Seksioni IV - Reagimi institucional ndaj dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje

Kuadri ligjor shqiptar vendos një qasje relativisht të fortë dhe të koordinuar për trajtimin e dhunës me bazë gjinore, duke identifikuar dhe caktuar përgjegjësi institucioneve të ndryshme që duhet të luajnë rol në çrrënjosjen e këtij fenomeni. Ai vendos një organ koordinues që duhet të sigurojë që autoritetet e tjera në këtë reagim të koordinuar të realizojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre siç parashikohet në ligj. Për të vlerësuar reagimin institucional ndaj dhunës me bazë gjinore

⁶¹ ILGA. 2022. Annual Review@: 2021. Online: <https://ëëë.ilga-europe.org/files/uploads/2022/04/annual-reviewë-2021.pdf>

siç synojnë ligjvënësit në hartimin e LDHF, ky seksion thellohet në çdo autoritet përgjegjës, në nivel qendror, të emërtuar në kuadrin ligjor kundrejt detyrave që kanë kryer vitet e fundit si dhe te reagimi në nivel lokal bazuar në funksionimin e MKR-ve.

Ndërsa çdo seksion më poshtë do të ofrojë një analizë të institucionit specifik, mund të bëhet një shënim i përgjithshëm mbi formulimin e ligjit. **As neni për rolin e autoritetit përgjegjës për koordinimin e zbatimit të ligjit dhe as neni që rendit përgjegjësitë e secilit institucion nuk përmban dispozita se si do të organizohet koordinimi ndërmjet tyre.** Në nenin e organit koordinues nuk parashikohet se si do të monitorohen institucionet e tjera, kush do ta bëjë monitorimin, sa shpesh duhet të kryhet dhe si duhet të raportojnë ministritë e linjës për përmbushjen e përgjegjësisë të tyre sipas ligjit. Një dispozitë mund të shtohet në të dy nenet përkatëse për të përcaktuar qasjen e koordinimit në mënyrë që autoriteti përgjegjës për zbatimin e ligjit të ketë në fuqi mekanizmin për të siguruar që të gjitha institucionet të respektojnë përgjegjësitë e tyre. **Gjithashtu, mungon përgjegjësia për moskryerjen e detyrave të listuara. Është shumë e nevojshme të diskutohet dhe adresohet forcimi i strukturës përgjegjëse për zbatimin e LDHF.** Aktualisht kjo strukturë e vendosur pranë MSHMS është mjaft e dobët si nga burimet njerëzore edhe nga buxheti në dispozicion. Një problem tjetër është konflikti midis detyrave që kjo strukturë ka edhe zbatuese, koordinuese edhe monitoruese.

Nuk ka dispozita specifike për masat për adresimin e institucioneve jofunksionale. Pa mekanizmat e llogaridhënies të vendosura, është e vështirë të sigurohemi që ligji është duke u zbatuar. Si autoritet koordinues, MSHMS mban pjesën më të madhe të barrës jo vetëm në zbatimin e drejtpërdrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të veta që rrjedhin nga ligji, por edhe në monitorimin dhe koordinimin e përpjekjeve me ministritë e tjera të linjës, të cilat teorikisht duhet t'i raportojnë organit koordinues. Disa nga sfidat e identifikuar nga MSHMS në këtë drejtim përfshijnë:

- Niveli i pamjaftueshëm i personelit që rëndon mbi disa individë.
- Ministritë e linjës dhe institucionet e tjera nuk raportojnë sipas standardeve të kërkuara gjatë përgatitjes së raporteve për mekanizmat ndërkombëtarë dhe në shumicën e rasteve nuk shoqërojnë aktivitetet e kryera me buxhete specifike, gjë që e bën të vështirë raportimin e treguesve në SKBGJ 2021-2030.
- Koordinim më i mirë ndërmjet aktorëve vendorë, veçanërisht ndërmjet policisë dhe koordinatorit vendor të DhF si dhe roli më aktiv i prokurorisë, përmbarimit dhe anëtarëve të tjerë të MKR-së.
- Pikës së fundit i duhet shtuar se koordinimi mund të përmirësohet edhe në nivel qendror, gjë që mund të lehtësojë dhe përmirësojë koordinimin e institucioneve të nivelit vendor brenda mekanizmave të referimit.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si Institucion Koordinues

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është autoriteti publik koordinues kryesor në zbatimin e LDHF dhe dokumenteve të tjera të politikave që lidhen me luftën kundër dhunës me

bazë gjinore në Shqipëri. Përveç nenit 7 më poshtë, MSHMS ka një sërë detyrash të tjera si organ koordinues, të cilat i ka kryer ndër vite, si përgatitja e strategjive dhe politikave dhe koordinimi me institucionet e tjera në hartimin e ndërhyrjeve.

Neni 7 pika 2, përcakton: Ministria përgjegjëse për shëndetësinë siguron ndihmën mjekësore në familje, në shërbimet e urgjencës, të mjekut të familjes dhe në qendrat shëndetësore pranë njësive të vetëqeverisjes vendore:

- a. për të ofruar në çdo kohë ndihmë mjekësore, sociale e psikologjike për viktimat e dhunës në familje;
- b. për të bërë në çdo kohë ekzaminimet e nevojshme në institucionet shëndetësore publike përkatëse;
- c. për të evidentuar rastet e dhunës në familje në dokumentacionin përkatës mjekësor të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë;
- d. për të pajisur edhe viktimën me raportin mjekësor përkatës;
- e. për të referuar dhe orientuar viktimën pranë shërbimeve të tjera të mbështetjes dhe mbrojtjes nga dhuna në familje.

Gjithashtu Neni 7 pika 2/1, përcakton: Ministria përgjegjëse për shëndetësinë kryen edhe këto detyra:

- a. organizon trajnime dhe specializime për stafin mjekësor, psikologjik e të punonjësve socialë në fushën e dhunës në familje, duke përgatitur edhe një listë të profesionistëve të trajnuar e të specializuar në këto fusha, në bashkëpunim me urdhrat e ngritur sipas legjislacionit në fuqi;
- b. monitoron përmbushjen e detyrimeve të parashikuara nga ky ligj, nga ana e personelit mjekësor;
- c. parashikon ngritjen e qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale, që të sigurojnë mundësinë e funksionimit të dhomave që shërbejnë për emergjenca pranë spitaleve ku viktima trajtohet. Standardet e ngritjes dhe funksionimit të qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

Një nga përgjegjësitë kryesore të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në këtë rast MSHMS, është të garantojë që ndihma mjekësore të jetë e disponueshme për të gjitha të mbijetuarat e dhunës që raportojnë në qendrat shëndetësore, te mjekët e tyre të familjes apo në spitale. Krahas ofrimit të ekzaminimit, ndryshimet në ligj në vitin 2018 përfshinë gjithashtu edhe lëshimin e raporteve të veçanta mjekësore, të cilat mund të përdoren nga të mbijetuarat gjatë proceseve gjyqësore. Sipas informacioneve të marra nga ministria, ndërkohë që përgjithësisht lëshohen raporte të veçanta mjekësore, nuk ka të dhëna për numrin e këtyre raporteve. Një shqetësim i ngritur është mungesa e njohurive në shumë raste për këtë përgjegjësi ligjore, duke bërë që viktimat të mos mund të marrin raport mjekësor dhe kjo ndikon negativisht në proceset e tyre

gjyqësore.⁶² Për këtë arsye, në qershor 2022 MSHMS u ka kërkuar të gjitha njësitë vendore të kujdesit shëndetësor që të lëshojnë urgjentisht udhëzime për personelin mjekësor lidhur me detyrat e tyre sipas LDHF. Gjithashtu, sipas MSHMS është dërguar një kërkesë për t'i sjellë të dhëna çdo tremujor dhe dy herë në vit MSHMS-së me qëllim mbledhjen e të dhënave mbi lëshimin e raporteve të veçanta mjekësore.

Gjatë viteve, kryesisht me mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë, ministria ka organizuar sesione trajnimi për personelin mjekësor, megjithatë, në përgjigje të këtij raporti ministria vuri në dukje se për shkak të ndryshimeve strukturore në stafe, është e rëndësishme që të organizohen përsëri sesione trajnimi me stafet e reja për të garantuar që ata t'i përmbushin detyrimet e ligjit. Në lidhje me monitorimin e zbatimit të dispozitave të këtij ligji nga personeli mjekësor, ministria vë në dukje se në fillim të vitit 2023 do të dalë një raport mbi zbatimin e SKBGJ 2021-2030 deri në fund të vitit 2022, megjithatë procesi i monitorimit duhet të kryhet më shpesh dhe si pjesë e zbatimit të ligjit. Kjo do të siguronte informacionin dhe të dhënat e nevojshme për të përmirësuar reagimin e institucioneve shëndetësore në rastet e dhunës ndaj grave.

Sipas LDHF ministria përgjegjëse për kujdesin shëndetësor është përgjegjëse edhe për ngritjen e qendrave të menaxhimit të krizës për rastet e përdhunimeve. Shqipëria krijoi qendrën e parë në vitin 2018 dhe që atëherë ka krijuar edhe qendra për menaxhimin e dhunës seksuale ndaj fëmijëve, konkretisht në vitin 2022. Ofrimi i shërbimeve të tilla për qendrën kombëtare të menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale është i rëndësishëm pasi u ofron viktimave një shërbim me një ndalesë, megjithatë duhet gjithashtu të sigurojë që të ketë hapësira në spitale dhe institucione të tjera të kujdesit shëndetësor ku duhet të ofrohet shërbimi i duhur dhe ruajtja e privatësisë dhe mbështetja për të mbijetuarat e dhunës seksuale. Duhet bërë më shumë punë për të informuar publikun për disponueshmërinë e shërbimeve të tilla, sidomos për Qendrën "Lilium". Një raport i fundit mbi hartëzimin e shërbimeve të dhunës seksuale në Ballkanin Perëndimor gjeti se një numër i konsiderueshëm i të intervistuarve kanë shumë pak informacion rreth shërbimeve të disponueshme.⁶³ 72% e të anketuarve nuk kishin asnjë informacion në lidhje me ekzistencën e ndonjë shërbimi që mbështet ekskluzivisht viktimat e dhunës seksuale, ndërsa 11% kishin njohuri për linjat lokale të ndihmës. Vetëm 28% e të intervistuarve raportuan se ishin në dijeni të ekzistencës së qendrës së krijuar së fundmi për menaxhimin e krizës për rastet e përdhunimeve, Qendrës "Lilium".⁶⁴

Policia si pika e parë e kontaktit

Më poshtë përmbledhen detyrat e ministrisë përgjegjëse për sigurinë publike në LDHF.

⁶²Intervista me Znj. Afërdita Prroni, Drejtore e Qendrës për të Drejtat e Njeriut në Demokraci

⁶³ÈAVE Netëork. 2019. Mapping of Sexual Violence Services in the Eastern Balkans and Turkey. UN Èomen. Online: https://eca.unèomen.org/sites/default/files/Field%20Office%20ECA/Attachments/Publications/2019/11/ÈAVE_SV_Report191119_èeb.pdf

⁶⁴Po aty.

Sipas LDHF dhe pikërisht në Nenin 7.1 përcaktohet që Ministria përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike ka këto detyra:

a) krijimin e sektorëve të veçantë për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje pranë drejtorive të policisë;

b) trajnimin e punonjësve të Policisë së Shtetit, që do të trajtojnë rastet e dhunës në familje, me qëllim rritjen e kapaciteteve në identifikimin e rasteve të dhunës në familje, vlerësimin e riskut dhe intervistimin e viktimës e të dhunuesit dhe me aspekte të tjera të lidhura me zbatimin e detyrimeve të parashikuara nga ky ligj;

b/1) miratimin, me udhëzim të përbashkët me ministrinë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje, të modelit dhe të procedurave për vlerësimin e riskut për rastet e dhunës në familje.

Sipas të dhënave të marra nga Policia e Shtetit, të dëmtuar nga dhuna dhe krimet e tjera në familje për vitin 2020 kanë qenë 3497 gra/vajza, ndërsa të mitur nën 18 vjeç, të dëmtuar nga dhuna dhe krime të tjera të ndodhura në familje kanë qenë 237. Janë trajtuar me kërkesë-padi "Për lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes/Urdhrit të Mbrojtjes" 2222 gra/vajza dhe 102 të mitur nën 18 vjeç. Sipas nenit 130/a "Dhuna në familje", të dëmtuar për këtë vepër penale kanë qenë 1111 gra/vajza dhe 90 të mitur nën 18 vjeç. Të dëmtuar nga dhuna dhe krimet e tjera në familje për vitin 2021, kanë qenë 3960 gra/vajza, ndërsa të mitur nën 18 vjeç, të dëmtuar nga dhuna dhe krime të tjera të ndodhura në familje, kanë qenë 269 persona. Janë trajtuar me kërkesë-padi "Për lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes/Urdhrit të Mbrojtjes", 2552 gra/vajza dhe 138 të mitur nën 18 vjeç. Sipas Nenit 130/a "Dhuna në familje", të dëmtuara gra/vajza për këtë vepër penale kanë qenë 1216 dhe 84 kanë qenë të mitur nën 18 vjeç. Sipas të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me ndryshimet strukturore të vitit 2018, organika e strukturave për të miturit dhe dhunën në familje në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në Departamentin e Policisë Kriminale, në Drejtorinë Kundër Krimeve ndaj Personit dhe Pronës, është Sektori i të Miturve dhe Dhunës në familje, me përbërje 1 Shef Sektori dhe 2 Specialistë. Në 12 Drejtoritë Vendore të Policisë, në Sektorin për Krimet, ka një funksion organik "Specialist për mbrojtjen e të miturve dhe dhunën në familje".

Me qëllim rritjen e kapaciteteve të punonjësve të policisë, për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, në vazhdimësi janë organizuar trajnime si nga vetë Policia e Shtetit, ashtu edhe me mbështetjen e organizatave dhe projekteve të ndryshme në këtë fushë. Për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, si dhe njohjen dhe zbatimin e ndryshimeve të akteve ligjore e nënligjore, për periudhën 2020-2021 janë zhvilluar trajnime në Akademinë e Sigurisë dhe në çdo drejtori vendore të policisë si vijon:

- Gjatë vitit 2020 janë zhvilluar 12 trajnime, ku janë regjistruar 183 punonjës policie. Sqarojmë se për shkak të kufizimeve nga Pandemia, gjatë vitit 2020, një numër i konsiderueshëm trajnimesh të planifikuara u anuluan ose u shtynë.
- Gjatë vitit 2021 janë zhvilluar 22 trajnime, ku janë trajnuar 359 punonjës policie.

Me Udhëzim të Përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Nr. 866, datë 20.12.2018 “Për miratimin e modelit dhe të procedurave të vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje,” është miratuar formati i vlerësimit të riskut i cili nuk ka pësuar ndryshime që nga viti 2018. Bazuar në detyrimet ligjore dhe të udhëzimit të sipërpërmendur, punonjësit e policisë kanë detyrimin të kryejnë vlerësimin e rrezikut për çdo rast të dhunës në familje. Megjithatë, sipas znj. Silvana Alimadhi, shefe e Sektorit Kundër Dhunës në Familje në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, meqenëse vlerësimi i rrezikut është një proces relativisht i ri, gjatë kryerjes së tij punonjësit e policisë përballen me disa problematika, si mungesa e koordinatorit vendor.


Si pika e parë e kontaktit, sidomos në rastet më emergjente, policia luan një rol të rëndësishëm në gjithë hallkën institucionale për parandalimin e dhunës dhe mbrojtjen e viktimave nga dhuna e mëtejshme. Për këtë arsye, u administrua një pyetësor për punonjësit e policisë, veçanërisht atyre që e kanë në përgjegjësi të drejtpërdrejtë, adresimin e rasteve të dhunës në familje për të kuptuar si nivelin e njohurive mbi mekanizmat ligjorë e institucionalë ashtu edhe perceptimin e punonjësve të policisë mbi punën e tyre në luftën kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Nga pyetësori që u shpërnda për punonjësit e policisë që merren me dhunën me bazë gjinore morëm vetëm 11 përgjigje. Nga këta persona që u përgjigjën, rreth shtatë prej tyre thanë që kishin marrë një trajnim ose orientim fillestar mbi dhunën me bazë gjinore. Të pyetur mbi përvojat e mëparshme në trajnime për dhunën me bazë gjinore, katër prej tyre u përgjigjën që nuk kishin përvoja të tilla në dy vitet e fundit. Punonjësit e policisë të cilët ishin angazhuar dhe kishin marrë pjesë në trajnime të tilla specifikuan trajnimin mbi dhunën në familje si një prej trajnimeve që kishin marrë. Trajnimi ishte në formë ëorkshop dhe leksionesh me një kohëzgjatje prej 2 javësh dhe i organizuar dhe mbajtur nga UN Eomen Shqipëri. Një tjetër trajnim i cituar nga pjesëmarrësit që plotësuan anketën është edhe trajnimi i ofruar nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA). Gjatë këtij trajnimi një javor punonjësit e policisë së shtetit ishin trajnuar mbi dhunën në familje dhe fëmijët e përfshirë. Një tjetër trajnim i cituar nga të anketuarit ishte edhe trajnimi 3 ditor mbi dhunën seksuale, i ofruar nga UNDP në Shqipëri. Një prej pyetjeve të anketës ishte edhe marrja e mendimit të punonjësve të policisë nëse e marrin mbështetjen e duhur institucionale në menaxhimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore/dhunës në familje. Gjysma e të anketuarve pohojnë se kanë mbështetjen e duhur për kryerjen e detyrave të tyre. Punonjësit e policisë u pyetën gjithashtu mbi dokumentet kryesore që drejtojnë punën e tyre të përditshme. Vlen për t’u cituar që vetëm 3 prej të anketuarve iu përgjigjën kësaj pyetjeje duke cituar 2 dokumenta kryesore: Ligjin për Masat ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare dhe Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë. Ndërsa të tjerët nuk cituan asnjë dokument, duke sjellë kështu në vëmendje mungesën e informacionin nga ana e tyre.

Sipas grafikut më poshtë, 3 punonjës policie që morën pjesë në këtë anketë ishin në dijeni të ndryshimeve thelbësore të viteve të fundit në legjislacionin për dhunën me bazë gjinore/familje. Ndërkohë që pjesa tjetër nuk iu përgjigjën kësaj pyetje duke nxjerrë në pah mungesën e informacionit edhe për ndryshimet më të fundit ligjore. Punonjësit të cilët iu përgjigjën pozitivisht

kësaj pyetjeje kanë renditur disa ndryshime që ndikojnë në punën e tyre si: Largimi i abuzuesit nga banesa; Marrja e Urdhrit Paraprak të Mbrojtjes 48 orë në polici dhe vlerësimi i saj në Gjykatë. Pjesëmarrësit në këtë anketim u pyetën edhe mbi njohuritë që ata kanë për konventat ndërkombëtare për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave. 3 prej tyre iu përgjigjën kësaj pyetjeje duke pohuar që kanë njohuri në një masë të vogël, përkundër të tjerëve që nuk reagojnë mbi këtë pyetje. Në vijim pjesëmarrësve në këtë anketim iu kërkua të vlerësonin nivelin e koordinimit dhe bashkëpunimit me ta në adresimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore në familje.


Grafiku 3. Vlerësimi i policisë për bashkëpunimin me institucionet kundër dhunës me bazë gjinore



Siç mund të vërehet edhe nga grafiku më sipër, janë vetëm tre institucione të cilat kanë marrë një vlerësim maksimal të koordinimit dhe bashkëpunimit me Policinë e Shtetit: Organizatat e Shoqërisë Civile, Institucionet e Kujdesit Shëndetësor dhe Prokuroria. Vlen për t'u analizuar që bashkëpunimin me Gjykatën, tetë pjesëmarrës në anketim e kanë vlerësuar si të dobët.

Një tjetër aspekt i cili duhet analizuar është edhe vlerësimi i ulët që të anketuarit kanë dhënë për koordinimin dhe bashkëpunimin me Bashkinë respektive ose me koordinatoren vendore kundër dhunës. Katër prej tyre e vlerësojnë si jo-ekzistente dhe shtatë e vlerësojnë mesatarisht këtë bashkëpunim dhe koordinim.

Grafiku 4. Vështirësitë që hasin punonjësit e policisë në trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore.



Të anketuarit u pyetën edhe për sfidat me të cilat përballen në menaxhimin e rasteve të DHBGJ/DHF. Sipas grafikut më lart pothuajse të gjithë punonjësit e policisë që morën pjesë në këtë anketim pohojnë koordinimin e dobët të anëtarëve të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit. Një sfidë e rëndësishme është mungesa e burimeve financiare dedikuar për dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje. Ndërkohë që rreth tre të anketuar hasin sfidë detyrat dhe përgjegjësitë që iu mbivendosen. Rreth shtatë pjesëmarrës në këtë anketim mendojnë se duhen më shumë burime financiare të alokuara për adresimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore/dhunës në familje si dhe pohojnë se duhet më shumë staf i dedikuar për menaxhimin e rasteve. Gjithashtu pothuajse të gjithë u shprehën se është shumë e nevojshme dhe emergjente marrja e masave të mbrojtjes siç duhet pas vendimit të Gjykatës dhe Zyrës Përmbarimore.

Sistemi i drejtësisë

Sipas LDHF dhe pikërisht në Nenin 7.3 përcaktohet se Ministria përgjegjëse për drejtësinë ka këto detyra:

- a) të trajnojë ekspertët mjeko-ligjorë në njohjen, diagnostikimin, vlerësimin dhe raportimin e dhunës në familje dhe akteve të dhunës ndaj fëmijëve;
- b) merr masa për përgatitjen profesionale dhe specializimin e përmbaruesve gjyqësorë në ekzekutimin e urdhrave të mbrojtjes, si dhe mbikëqyr veprimtarinë e tyre në realizimin e detyrimeve të parashikuara në këtë ligj;
- b/1) bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Shkollën e Magjistraturës, Dhomën Kombëtare të Avokatisë, për përgatitjen e programeve të trajnimit për çështje të lidhura me dhunën në familje, si dhe vë në dispozicion të autoriteteve përgjegjëse listën e përditësuar të të trajnuarve për këto çështje;
- c) mbikëqyr funksionimin e sistemit të ofrimit të ndihmës juridike për viktimat e dhunës në familje, sipas rregullave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;
- ç) bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor, për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe siguron unifikimin e regjistrimit të këtyre çështjeve;
- d) harton formularë të posaçëm për përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore për dhunën në familje, si dhe publikon këto të dhëna në vjetarin statistikor;
- dh) nëpërmjet strukturave përgjegjëse të varësisë, siguron zbatimin e detyrimit të përgatitjes së raportit mjeko-ligjor dhe psikiatriko-ligjor nga ana e stafit të mjekësisë ligjore, bazuar në kërkesën e institucioneve kompetente dhe/ose të viktimës.

Neni 7 i ligjit për DhF rendit disa përgjegjësi për Ministrinë e Drejtësisë si një nga autoritetet përgjegjëse në zbatimin e këtij ligji. Sipas nenit 7, paragrafi 3, gërma “a”, ministri ka për detyrë të trajnojë ekspertët e mjekësisë ligjore lidhur me vlerësimin, vlerësimin e rrezikut dhe raportimin e rasteve të dhunës në familje. Sipas të dhënave të marra nga Ministria e Drejtësisë, këta profesionistë janë ekspertë në fushën e tyre, prandaj nuk janë organizuar seanca trajnimit. Neni 7, paragrafi 3, gërma “b” ngarkon ministrinë të marrë masa për përgatitjen profesionale dhe specializimin e përmbaruesve gjyqësorë dhe për të siguruar përgatitjen profesionale të tyre në ekzekutimin e urdhrave të mbrojtjes. Sipas të dhënave nga Ministria e Drejtësisë, që nga viti 2019 nuk ka pasur asnjë seancë trajnimit për përmbaruesit gjyqësorë. Megjithatë, ministria thekson me të drejtë nevojën për trajnim të përbashkët të përmbaruesve gjyqësorë me autoritetet e tjera ligjzbatuese, përfshirë policinë, për të siguruar një koordinim dhe bashkëpunim efektiv.

Një nga rolet më të rëndësishme të sistemit të drejtësisë në mbrojtjen e të mbijetuarave të dhunës është lëshimi i urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes. Një raport i kohëve të fundit nga zyra e Avokatit të Popullit ka vënë në dukje një sërë problemesh në këtë drejtim, ku veçanërisht hasen vështirësi në masën mbrojtëse për largimin e dhunuesit nga

shtëpia e përbashkët kur kjo parashikohet në urdhrin e mbrojtjes.⁶⁵ Raporti thekson me të drejtë se në plan të parë duhet të jetë interesi i të mbijetuarës, e jo shqetësimet lidhur me strehimin e dhunuesit. Ministria e Drejtësisë pohon vështirësinë në zbatimin e duhur të urdhrave të mbrojtjes për shkak të mungesës së burimeve njerëzore. Nuk ka një koordinim dhe bashkëpunim të qëndrueshëm mes zyrave përmbareme vendore, oficerëve të policisë dhe koordinatorëve të DhF dhe trajnimi i përmbareuesve nuk është i mjaftueshëm për të siguruar masa mbrojtëse të efektshme.⁶⁶ Ky shqetësim është ngritur edhe nga vetë Ministria e Drejtësisë, e cila vë në dukje mospërputhjen mes vëllimit të punës dhe burimeve të disponueshme për kryerjen e kësaj pune dhe si aspektin më problematik thekson koordinimin e duhur ndërmjet institucioneve të ndryshme në garantimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes, sidomos kur gjykata urdhëron largimin e dhunuesit nga shtëpia, duke ngarkuar shërbimet sociale vendore me gjetjen e strehimit për dhunuesin, gjë që shpesh nuk është e mundur. Megjithatë siç u theksua më lart, duhet të mbahet parasysh interesi më i mirë i viktimës dhe mungesa e disponueshmërisë së strehimit për dhunuesit nuk duhet të përbëjë arsye për moszekutimin e urdhrave të mbrojtjes.

Raporti vjetor statistikor i Ministrisë së Drejtësisë përmban një seksion për kërkesat për urdhër mbrojtjeje të pranuar nga gjykatat. Megjithatë, ka dallim ndërmjet kërkesave të pranuar dhe dhënies së titujve ekzekutivë për mbrojtje dhe nuk ka asnjë informacion mbi monitorimin e këtyre urdhrave të mbrojtjes dhe rasteve kur ato nuk respektohen. Ligji parashikon qartë masat për të trajtuar shkeljet e urdhrin të mbrojtjes qoftë nga dhunuesit apo nga autoritetet gjatë detyrave të tyre monitoruese. Pa të dhëna të disponueshme është e vështirë të garantohet dhe të kërkohet llogaridhënie për këtë. Megjithatë, nuk ka asnjë tregues se kjo gjë është bërë në mënyrë të mjaftueshme. Përsëri, mungesa e të dhënave të disponueshme e bën të vështirë vlerësimin se në çfarë mase Ministria i ka kryer detyrat e saj ligjore.

Një detyrë tjetër e Ministrisë së Drejtësisë është të bashkërendojë punën me institucionet e tjera nën kompetencën e saj për organizimin e programeve të trajnimit mbi dhunën me bazë gjinore dhe atë në familje. Të dhënat e Ministrisë së Drejtësisë tregojnë se ka pasur 4 sesione trajnimi për këtë temë në vitin 2020 dhe nga një në 2021 dhe 2022 me mbi 88 zyrtarë të trajnuar, duke përfshirë gjyqtarë dhe prokurorë. Pra kjo përgjegjësi është duke u kryer siç duhet në përputhje me ligjin. Sa i përket rolit të saj në mbikëqyrjen e ofrimit të ndihmës juridike falas në përputhje me legjislacionin në fuqi, Ministria e Drejtësisë raporton se ekziston një mekanizëm monitorues për formatet e ndryshme në të cilat ofrohet ndihma juridike parësore dhe dytësore në Shqipëri. Sipas të dhënave nga Ministria e Drejtësisë, për vitin 2021, nga 8153 seanca këshillimi të ofruara, 625 kanë qenë për gra të mbijetuara të dhunës, abuzimit seksual dhe trafikimit, ose 8% e totalit të rasteve. Në vitin 2022, nga 4761 këshillime të ofruara, 445 ishin për të mbijetuarat e dhunës dhe 71 për të mbijetuarat e abuzimit seksual dhe trafikimit, ose 11% e totalit. Duhet theksuar se që nga viti 2021 numri i rasteve pothuajse është dyfishuar, duke nxjerrë në pah një përmirësim të konsiderueshëm në ofrimin e ndihmës juridike falas. Megjithatë, numri i të mbijetuarave të dhunës që përfitojnë ndihmë juridike falas është ende i ulët në krahasim me numrin total të

⁶⁵Raporti i Avokatit të Popullit për 2020-2021

⁶⁶Po aty.

rasteve, prandaj mund të bëhen më shumë përpjekje për të rritur numrin e grave të mbijetuara të dhunës që përfitojnë nga ky shërbim. Ky shqetësim është ngritur edhe në raportin e Avokatit të Popullit në vitin 2021.

Në lidhje me mbledhjen e të dhënave dhe unifikimin e sistemeve të mbledhjes së të dhënave ndërmjet institucioneve të ndryshme në kompetencë të saj, duhet theksuar se raporti vjetor statistikor i Ministrisë së Drejtësisë përmban të dhëna mbi veprën penale të dhunës në familje të parashikuar nga neni 130 i Kodit Penal. Në tre vitet e fundit, raporti statistikor përmban gjithashtu një seksion të veçantë për urdhrat e mbrojtjes të lëshuar dhe ofron informacion shtesë, si gjinia, mosha, ndarja urbane-rurale dhe marrëdhënia mes dhunuesit dhe viktimës. Megjithatë, e gjithë gama e informacionit dhe të dhënave që mund të vihen në dispozicion ende nuk përdoret mjaftueshëm dhe nuk ka një sistem apo bazë të dhënash të centralizuar për mbledhjen dhe publikimin e këtyre të dhënave, prandaj nevojitet më shumë harmonizim për shfrytëzimin e plotë të të dhënave.

Në përmbyllje, pika fokale gjinore vuri në dukje se do të ishte edhe më e efektshme të shtoheshin çështjet e barazisë gjinore në përshkrimin e punës të stafit në departamente të ndryshme brenda ministrisë. Kjo do të lehtësonte rolin e pikës fokale gjinore. Gjithashtu, koordinimi dhe komunikimi në kohë ndërmjet institucioneve përgjegjëse u pa si një nga dobësitë në zbatimin e LDHF në Shqipëri.

Institucionet përgjegjëse për Arsimin, Punësimin dhe formimin profesional

S3/1. Ministria përgjegjëse për arsimin dhe ministria përgjegjëse për punësimin dhe formimin profesional, sipas fushës së përgjegjësisë që mbulojnë, kanë këto detyra:

- a) harton programet mësimore për shkollat e mesme dhe të larta për rregullat e sjelljes në familje;
- b) përgatit tekste shkollore dhe materiale të tjera plotësuese për edukimin e nxënësve dhe/ose studentëve me mendësitë e ndalimit të dhunës në marrëdhëniet familjare;
- c) parashikon programe për arsimimin parauniversitar e profesional të të miturve dhe të rinjve nga 18 deri në 21 vjeç, që janë dhunues, dhe të të miturve që janë viktima, me qëllim rehabilitimin, riintegrimin dhe rishoqërimin e tyre.

Numri i viteve që një person kalon në shkollë ka rezultuar të ketë një korrelacion pozitiv me një ulje të viktimizimit në të ardhmen si dhe ushtrimit të dhunës fizike dhe seksuale. Shkollat, nga niveli fillor deri te institucionet e arsimit të lartë, trajnimit profesional dhe arsimit jo-formal, janë mjedise të rëndësishme për ndryshime normative dhe kanë potencialin për të adresuar pabarazitë gjinore dhe për të parandaluar DHBGJ-në.⁶⁷ Ato kontribuojnë në përpjekjet

⁶⁷ SIDA. 2015. Gender Based Violence and Education. Online: <https://cdn.sida.se/publications/files/-gender-based-violence-and-education.pdf>

parandaluese, të cilat duhet të vendosen në qendër të legjislacionit, por edhe të politikave që lidhen me çrrënjosjen e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në vend.

Në përgjithësi, LDHF nuk ka një theks të fortë tek parandalimi. Edhe përgjegjësitë që i janë caktuar ministrisë përgjegjëse për arsimin nuk janë të mjaftueshme për të arritur realisht përpjekjet parandaluese. Edhe në këtë rast, Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk ka qenë aktive në kryerjen e përgjegjësisë të parashikuara me ligj. Nuk ka përpjekje sistematike për të përgatitur dhe përfshirë çështjet e barazisë gjinore në kurrikulat shkollore, përveç disa fushatave ndërgjegjësuere. Kur punon me nxënësit, është e rëndësishme të shkohet përtej eventeve që kryhen vetëm një herë ose përtej një klase apo leksioni mbi barazinë gjinore, por të përfshihen këto tema gjatë gjithë vitit shkollor. Një model që mund të shërbejë si shembull i mirë është “Mënyra daneze e prindërimit”, e cila përfshin klasa empatie për fëmijët që fillojnë që në kopsht dhe vazhdojnë deri në arsimin parauniversitar. Ministria e Arsimit dhe Sportit gjithashtu mund të konsiderojë të angazhohet më shumë me anën sportive të institucionit për të testuar modele të suksesshme të ndryshimit të sjelljeve dhe qëndrimeve.

Mekanizmat Vendorë

4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në parashikimet e legjislacionit në fuqi për vetëqeverisjen vendore, në kuadër të zbatimit të këtij ligji, kanë këto detyra:
- a) angazhimin në krijimin e strukturave të specializuara të shërbimit social për rastet e dhunës në familje, lidhur me mënyrën e referimit të rasteve të dhunës në familje, si dhe monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes e të urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes;
 - b) ngritjen e qendrave sociale e të rehabilitimit për viktimat dhe ofrimin e shërbimeve për to; koordinimin e punës me qendrat ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse dhe qendrave të emergjencës për trajtimin e menjëhershëm të viktimave të dhunës në familje;
 - c) ngritjen e strukturave e të qendrave publike për trajtimin, trajnimin dhe rehabilitimin e dhunuesve;
 - ç) marrjen e masave, në bashkëpunim me organet ligjzbatuese, për ndarjen e dhunuesit nga familja, me qëllim lënien në përdorim të banesës familjare viktimës dhe fëmijëve;
 - d) marrjen e masave për zbatimin e vendimit gjyqësor, nga organet vendore të vendbanimit dhe/ose vendqëndrimit të viktimës;
 - dh) bashkëpunimin me shërbimin e provës, për monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbikëqyrjen elektronike të personave që u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor.

Sistemi i referimit ka bërë një rrugë të gjatë që nga viti 2007 kur u krijuan MKR-të e para në vend. Nga 10 të themeluara në periudhën 2013-2017, tashmë të 61 bashkitë kanë krijuar MKR, megjithëse secili ka profilin, sfidat, sukseset dhe nivelin e vet të funksionalitetit. Ligji për DhF kërkon që njësitë e qeverisjes vendore të krijojnë struktura të specializuara të shërbimeve sociale për referimin e rasteve dhe monitorimin e urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm

të mbrojtjes. Ndërkohë që të gjitha bashkitë kanë krijuar mekanizma referimi, monitorimi i urdhrave të mbrojtjes mbetet i paplotësuar dhe një boshllëk i rëndësishëm në rrugën e referimit.

Një detyrë tjetër thelbësore e mekanizmave të referimit është t'u mundësojnë të mbijetuarave të kenë akses në shërbimet e rehabilitimit. Kjo është një nga fushat problematike që kërkon kohë, burime dhe vullnet për t'i bërë MKR-të plotësisht funksionale. Monitorimi i mekanizmave të referimit në vitin 2020⁶⁸ tregoi se ndonëse ka përpjekje nga bashkitë për të ofruar shërbime, si strehëzat e emergjencës dhe programet e rehabilitimit, numri është ende i kufizuar dhe paketa e plotë e shërbimeve gjithëpërfshirëse është ende e pafinancuar ose me mungesa.

Krahas programeve të rehabilitimit për të mbijetuarat, ligji kërkon që njësitë e qeverisjes vendore të krijojnë edhe programe rehabilitimi për dhunuesit dhe kjo kërkesë duhet të shtohet në urdhrat e mbrojtjes. Megjithatë, gjatë lëshimit të urdhrave të mbrojtjes, gjykatat shpesh nuk përfshijnë në vendimet e tyre një dispozitë që dhunuesi të regjistrohet në një program rehabilitimi, që do të thotë se ata nuk përdorin nenin 10/1 të ligjit të DhF.⁶⁹ Përveç gjyqtarëve që nuk mandatojnë programet për dhunuesit, vetë këto programe janë embrionalë në Shqipëri. Ato ofrohen nga disa OJQ, ndërsa programet publike ende nuk janë krijuar. Një vlerësim i programeve për dhunuesit në Shqipëri tregoi se ato janë të kufizuara në shërbimet e ofruara, si dhe në mbulimin gjeografik. Shumica e programeve ekzistuese nuk kanë një qasje të unifikuar dhe nuk janë gjithmonë në përputhje me praktikat më të mira. Ndërkohë që ekzistojnë programe të përgjithshme për dhunuesit, nuk ka shërbime të tilla që ofrohen për autorët e dhunës seksuale në mënyrë që të parandalohet përsëritja e veprës penale.⁷⁰

Një monitorim⁷¹ në disa bashki midis viteve 2017 dhe 2019 ka treguar më tej se:

- Numri i rasteve të adresuara nga mekanizmat me një shumësi shërbimesh është ende i vogël krahasuar me numrin e rasteve të raportuara.
- Jo të gjithë anëtarët marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e grupeve teknike të punës, dhe vetëm një numër i vogël institucioneesh kryen detyrat themelore për secilin rast.
- Në disa bashki, nëpunësit e barazisë gjinore/koordinatorët vendorë për DHF kryejnë gjithashtu funksione të tjera që nuk lidhen me detyrat e tyre primare dhe kjo e shton më tej barrën e madhe të detyrave që ata kanë si nëpunës të barazisë gjinore.

⁶⁸ Ju lutem shihni raportin e UNDP këtu: <https://ëëë.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/al/Analysis-of-the-Functioning-of-the-Coordinated-Referral-Mechanism-of-Cases-of-Domestic-Violence-at-the-Local-Level-in-Albania.pdf>

⁶⁹ Shihni vendimin 51-2020-2703

⁷⁰ Ëork Ëith Perpetrators European Netëork. 2022. Summary of adopted GREVIO reports relevant for Perpetrator Programmes (PP) for domestic and gender-based violence (Shihni kapitullin për Shqipërinë). Online: https://ëëë.ëork-ëith-perpetrators.eu/fileadmin/ËËP_Netëork/redakteure/Istanbul_GREVIO/GREVIO/Adopted_Grevio_Reports.pdf

⁷¹ GADC. 2020. Monitorimi i Objektivit të Tretë të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2016-2020. Gjetjet kryesore dhe rekomandimet.

- Shumica e bashkive kanë burime të pamjaftueshme për ofrimin e shërbimeve apo kryerjen e aktiviteteve ndërgjegjësuere mbi barazinë gjinore dhe shpesh mbështeten në fondet e donatorëve për ta mbyllur boshllëkun.
- Ndonëse parashikohet me ligj, në disa nga bashkitë e monitoruara, bashkëpunimi i gjykatës së rrethit gjyqësor me zyrën e përmbaruesve gjyqësorë është pothuajse jo-funksional. Asnjë nga urdhrat e mbrojtjes apo urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes nuk shkon direkt në zyrën e përmbarimit.
- Ndërkohë që sistemi REVALB përdoret gjerësisht nga bashkitë, jo të gjitha fusin të dhëna në sistem dhe jo të gjitha rastet pasqyrohen, gjë që mund të jetë për shkak të volumit të madh të punës së koordinatorëve vendorë të DHF-së. Megjithatë, duhet theksuar se vitet e fundit ka një rritje të përdorimit të sistemit. Një vlerësim nga viti 2020 tregoi se vetëm 26 e përdornin sistemin për të shtuar të dhëna mbi të mbijetuarat që mbështeteshin nga MKR. Në vitin 2022, raportimi nga MSHMS tregoi se mbi 40 e kishin përdorur sistemin në 2021 dhe mbi 30 në 2022 deri në maj. Ndonëse kjo është inkurajuese, për të marrë një pasqyrë të plotë të punës së MKR-ve dhe individëve të mbështetur me të gjitha shërbimet e disponueshme rast pas rasti, është e rëndësishme për të gjitha bashkitë që të gjitha rastet e raportuara të futen në sistem.

Përsa i përket detyrës për të bashkëpunuar me përmbaruesit gjyqësorë për monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes, ky i fundit është një nga institucionet më pak aktive në MKR. Problemet me përmbaruesit gjyqësorë dhe ekzekutimin e urdhrave të mbrojtjes janë diskutuar më herët në kuadër të përgjegjësive të MD-së dhe MSHMS-së, megjithatë duhet ripërsëritur se nevojitet më shumë trajnim për përmbaruesit gjyqësorë dhe duhet të rritet pjesëmarrja e tyre në MKR në mënyrë që MKR-të të përmbushin detyrat që u janë caktuar në ligjin e DHF dhe VKM 327.

Konkluzione

Analiza e zbatimit të legjislacionit nga ana e autoriteteve përgjegjëse të listuara në LDHF tregoi se:

- Nuk ka mekanizma të qartë llogaridhënieje për institucionet dhe autoritetet përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit në fuqi kundër dhunës me bazë gjinore.
- Asnjë nga institucionet nuk i ka zbatuar plotësisht të gjitha parashikimet e ligjit në lidhje me rolin e tyre si autoritete përgjegjëse për zbatimin e ligjit.
- Sfida në burimet njerëzore dhe financiare në nivel qendror dhe vendor pengojnë shpesh zbatimin e plotë të përgjegjësive në parandalimin dhe adresimin e dhunës me bazë gjinore në mënyrë efikase.
- LDHF duhet t'i nënshtrohet një tjetër rishikimi tërësor për ta sjellë atë sa më pranë standardeve ndërkombëtare dhe adresimit të nevojave të viktimave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Duhet një ligj që siguron mbrojtje nga të gjitha format e dhunës kundër grave, dhe jo vetëm në marrëdhëniet familjare.

- Institucionet në nivel qendror dhe vendor duhet të krijojnë dhe ndjekin mekanizma më të mirë koordinimi ndërmjet tyre dhe institucioneve të tjera të varësisë për të zbatuar në mënyrë sa më efikase kuadrin ligjor në fuqi.
- Mekanizmi i Koordinuar i Referimit në nivel vendor është qasja kyçe për identifikimin dhe ofrimin e gjithë gamës së domosdoshme të shërbimeve për viktimat e dhunës. Është e rëndësishme të investohet më tepër kohë, burime njerëzore, financiare dhe infrastrukturore për të përmirësuar funksionimin e tyre.
- Duhet të hidhet më tepër dritë mbi dhunën me bazë gjinore ndaj grupeve të marginalizuara të grave për të hartuar politika të bazuara në të dhëna dhe evidenca si edhe për të adresuar nevojat e tyre që kanë specifikat e tyre.
- Mbledhja e të dhënave duhet zgjeruar në të gjitha institucionet përgjegjëse, duhet të jetë e rregullt dhe e centralizuar për të mundësuar një panoramë sa më të qartë dhe koherente të dhunës me bazë gjinore. Fragmentizimi i tyre shpesh krijon paqartësi dhe nuk lejon adresimin e hendeqeve kryesore.
- Duhet të ketë mekanizma më të qartë llogaridhënieje të të gjithë aktorëve të përfshirë në zbatimin e legjislacionit në fuqi kundër dhunës me bazë ligjore. Marrja e masave ndëshkuese në mungesë të zbatimit të detyrimeve ligjore është një hap i domosdoshëm që duhet të kthehet në praktikë të mirëvendosur dhe të qëndrueshme.

Seksioni V – Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore: Një vit zbatim

Ky seksion fokusohet në zbatimin e objektivit strategjik III të SKBGJ për luftimin e DHBGJ-së për vitin 2021 dhe 2022 deri në shtator. Kjo do të mundësojë që të kuptojmë më mirë se çfarë masash janë marrë deri më tani dhe gjithashtu do të mbështetet në mësimet e nxjerra nga SKBGJ e mëparshme.

Një nga objektivat e Strategjisë së mëparshme Kombëtare për Barazinë Gjinore (2016-2020) ishte shtimi i Mekanizmit të Koordinuar të Referimit nga 29 në 61 komuna. Kjo u arrit deri në fund të zbatimit të SKBGJ-së pasi të 61 bashkitë në Shqipëri kanë MKR të paktën formalisht të krijuara. Sidoqoftë, niveli i funksionalitetit të tyre varion shumë. Edhe në vlerësimin e SKBGJ-së së mëparshme u vu re se ndonëse kjo është një arritje pozitive dhe objektivi u arrit, këto zhvillime duhet të jenë afatgjata dhe të qëndrueshme. Prandaj, u identifikua si një nevojë që SKBGJ e ardhshme të fokusohet në përmirësimin dhe forcimin e efektivitetit dhe funksionalitetit të tyre, duke mundësuar burimet e nevojshme njerëzore, infrastrukturore dhe financiare, që janë thembra e Akilit e masave efektive për të zhdukur dhunën ndaj grave.

Për sa i përket shërbimeve, gjatë zbatimit të SKBGJ-së së mëparshme, numri i shërbimeve të disponueshme u rrit nga 13 në 22. Më e rëndësishmja, gjatë kësaj periudhe u shtua një linjë kombëtare e cila ofron mbështetje falas 24/7 për të mbijetuarat, si dhe u ngrit qendra e parë për trajtimin e dhunës seksuale. Është e mirëpritur dhe një arritje pozitive edhe shtimi i 7 qendrave të emergjencës. Megjithatë, duhet theksuar se pavarësisht përmbushjes së objektivit të përcaktuar në SKBGJ, disponueshmëria e shërbimeve është ende në nivele të ulëta dhe duhet bërë më shumë për të siguruar mbulim të gjerë gjeografik, cilësinë e shërbimeve dhe aksesin për grupe të ndryshme të të mbijetuarave, siç janë gratë me aftësi të kufizuara. Masat e suksesit nuk duhet të mbështeten vetëm në numra dhe në ekzistencën de jure të shërbimeve. Cilësia e shërbimeve të tyre, mbulimi i të gjithë popullsisë, aksesin dhe disponueshmëria e shërbimeve duhet gjithashtu të maten në mënyrë që të kuptohen realisht masat mbrojtëse në fuqi për të mbijetuarat e dhunës.

Përafrimi i kuadrit ligjor penal që trajton dhunën me bazë gjinore në përputhje me standardet dhe rekomandimet ndërkombëtare është bartur në SKBGJ-në e re 2021-2030. Në periudhën e mëparshme të zbatimit, pavarësisht disa përmirësimeve, ende kishte rekomandime urgjente nga GREVIO, veçanërisht në lidhje me përkufizimin e përdhunimit, të cilat nuk ishin adresuar plotësisht. Masa III.1.1.a e SKBGJ-së së re parashikon një analizë të kuadrit ligjor civil dhe penal që trajton dhunën me bazë gjinore që do të kryhet në vitin 2022. Ka rishikime të vazhdueshme të Kodit Penal, i cili përfshin edhe masat lidhur me dhunën ndaj grave. Për këtë arsye, tashmë ka filluar një punë për këtë masë të SKBGJ, e cila është në përputhje me afatin kohor të parashikuar në Planin e Veprimit.

Siç u përmend në seksionet e mëparshme të këtij raporti, mbledhja e të dhënave duhet të jetë një masë kyçe, një përpjekje parandaluese si dhe një burim për vendimmarrje për çrrënjosjen e dhunës ndaj grave dhe vajzave. Aktualisht, mbledhja e të dhënave është e shpërndarë ndërmjet institucioneve të ndryshme, secili me sistemet e veta për mbledhjen dhe paraqitjen e të dhënave,

gjë që shpesh çon në shifra të ndryshme që mjegullojnë prevalencën e dhunës ndaj grave. Prandaj, një nga masat e SKBGJ-së është përafrimi i sistemeve të mbledhjes së të dhënave dhe sigurimi i ndarjes sipas kategorive të ndryshme për të kuptuar më mirë fenomenin. Ndonëse kjo masë ishte planifikuar të fillonte në vitin 2021, sipas kërkesave zyrtare për informacion, puna për këtë masë ende nuk ka filluar.

Një nga sfidat e identifikuara nga vlerësimi i punës së MKR-ve, siç është vlerësimi i kryer nga UNDP në vitin 2020 dhe monitorimi i MKR-ve i kryer nga Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim ndërmjet viteve 2018 dhe 2021, tregoi se jo të gjithë anëtarët e MKR janë aktivë në përmbushjen e detyrimeve të tyre ligjore, disa nuk marrin pjesë në mbledhjet e grupeve teknike ose nuk janë në dijeni të detyrave të tyre.⁷² Prandaj, një nga masat e parashikuara në SKBGJ është forcimi i kapaciteteve të koordinatorëve vendorë të DhF për të zbatuar ndëshkimin e institucioneve të ndryshme nëse nuk kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre si anëtarë të MKR-ve. Ndërsa MSHMS ka kryer një sërë sesionesh trajnimi për koordinatorët vendorë të DhF-së dhe anëtarët e tjerë të MKR-ve, ajo ende nuk është fokusuar në këtë temë. Duhet të theksohet se vetë masa është e paqartë dhe nuk ka asnjë sqarim se si mund ta zbatojnë këtë masë koordinatorët vendorë të DhF pasi nuk ka asnjë dispozitë në ligj për këtë rol.

Një masë tjetër me datë fillimi vitin 2021 është përmirësimi i infrastrukturës dhe kushteve në 12 strehëzat ekzistuese të emergjencës. Ndërsa një masë e tillë është e rëndësishme për të siguruar funksionimin e duhur të strehëzave ekzistuese, duhet të ketë një masë tjetër për të rritur numrin e strehëzave të disponueshme emergjente pasi shumë gra, veçanërisht ato nga zonat rurale, nuk kanë akses dhe shpesh janë të izoluar në shtëpi me dhunuesit. Në fakt, sipas informacioneve të ndara nga MSHMS, tani ekzistojnë 16 strehëza emergjente në nivel bashkie dhe qendra të tjera të shërbimeve të specializuara për viktimat e mitura të dhunës seksuale janë në përgatitje e sipër, gjë që është e mirëpritur. MSHMS duhet gjithashtu të fokusohet në funksionalitetin e strehëzave të tilla emergjente dhe në përmirësimin e kushteve të tyre nëpërmjet rrjedhave të qëndrueshme të financimit.

Roli i OJQ-ve në luftën kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri është shumë i rëndësishëm. Ky rol njihet në të gjitha pjesët e legjislacionit që kanë të bëjnë me dhënien fund të DHBGJ-së. Prandaj, ekziston edhe një masë dhe tregues specifik në SKBGJ për rritjen e fondeve në dispozicion të OJQ-ve në baza vjetore, e cila duhet të kishte filluar në vitin 2021. Megjithatë, nuk ka të dhëna fillestare të disponueshme për këtë nga viti 2020 dhe 2021 që do të shërbenin për të bërë krahasime në vitet e ardhshme. Ndërsa ka të dhëna për disa prej OSHC-ve të financuara, të dhënat e tjera janë nga Fondi Social, gjë që e bën të vështirë dallimin midis fondeve të alokuara për OSHC-të dhe atyre të alokuara për njësitë e qeverisjes vendore. Megjithatë, ka fonde për OSHC-të që ofrojnë shërbime, siç është linja telefonike kombëtare.

Masa III.2 e SKBGJ parashikon ndryshime në ligjin për strehimin social për të garantuar lehtësim fiskal për qiradhënësit që japin me qira shtëpinë e tyre për të mbijetuarat e formave të ndryshme

⁷²GADC. 2020. Monitorimi i Objektivit të Tretë të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazinë Gjimore 2016-2020. Gjetjet kryesore dhe rekomandimet.

të dhunës. Një analizë ligjore ishte parashikuar të fillonte në vitin 2021, por sipas informacioneve të marra kjo masë ende nuk është zbatuar.

Së fundi, në vitin 2021 duhet të kishin filluar përpjekjet për të siguruar që bashkitë të kenë skema të riintegritimit socio-ekonomik për të mbijetuarat e dhunës. Ndërkohë që ka disa përpjekje, kryesisht të udhëhequra nga OSHC-të, për të siguruar që riintegrimi socio-ekonomik u ofrohet të mbijetuarave të dhunës, ende nuk ka përpjekje të centralizuara nga autoritetet publike përkatëse për të siguruar që skema të tilla të jenë të institucionalizuara dhe të disponueshme në nivel vendor. Në SKBGJ ka edhe masa të tjera që lidhen me DHBGJ-në, megjithatë kjo analizë u fokusua vetëm në ato që sipas Planit të Veprimit duhet të kishin filluar ose në vitin 2021 ose 2022. Siç shihet nga tabela e mëposhtme dhe nga analiza e mësipërme, nuk është bërë shumë deri më tani për sa i përket zbatimit të objektivit specifik të SKBGJ për luftimin e DHBGJ/DHF. Kështu, bëhet i rëndësishëm vlerësimi dhe monitorimi i zbatimit të strategjisë në baza vjetore ose dy herë në vit, jo në mes dhe në fund të zbatimit të saj. Kjo do të siguronte monitorim dhe llogaridhënie më të mirë për palët përkatëse të interesit.

Masa	Afati kohor	Autoriteti përgjegjës	Statusi
III.1.1.a Analiza e kuadrit ligjor civil dhe penal mbi dhunën me bazë gjinore, dhunën në familje, seksizmin dhe evidentimi i parashikimeve të cilat nuk ndalojnë apo favorizojnë praktika të dëmshme dhe stereotipe gjinore, si dhe masave që duhet të ndërmerren.	Gjysma e parë 2022 – gjysma e dytë 2022	MSHMS, MD, Avokati i Popullit, KMD, SoM, OJQ-të, organizatat ndërkombëtare	Ka filluar
III.1.2.e. Harmonizimi i sistemeve të mbledhjes së të dhënave dhe disagregimi domosdoshmërisht sipas rasteve të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, me qëllim që të mundësohet	Gjysma e 2-të 2021 – gjysma e 2-të 2022	Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithsme e Policisë, MD, MSHMS, INSTAT, Avokati i Popullit, KMD, OJQ-të, Organizatat ndërkombëtare	Nuk ka filluar

lehtësisht krahasimi i tyre ndër vite.			
III.1.2.g. Fuqizimi i kapaciteteve të Koordinatorëve / Koordinatorëve Vendorë për të njohur dhe parashtruar në mbledhjet e Komiteteve Drejtuese të MKR-ve, nevojën për aplikimin e ndëshkimeve sipas legjislacionit në fuqi, për punonjëset dhe punonjësit, si dhe institucionet përkatëse anëtare të këtyre mekanizmave, që nuk zbatojnë detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre.	Gjysma e parë 2022 – gjysma e 2-të 2022	MSHMS, NJVV-të, organizatat ndërkombëtare	Nuk ka filluar
III.2.2.a. Përmirësimi i kushteve/ infrastrukturës/ burimeve të 12 strehëzave ekzistuese të emergjencës të ngritura deri në 2020 në nivel bashkie, me qëllim që të plotësojnë standardet e miratuara për funksionimin e tyre.	Gjysma e 2-të 2021 – gjysma e 2-të 2025	NJVV-të, MSHMS/Shërbimi Social Shtetëror, MFE, OJQ-të, organizatat ndërkombëtare	Ka filluar
III.2.4.a. Rritja e përvitshme e fondeve të dhëna nga shteti për mbështetjen e OJF ofruese shërbimesh të specializuara (me	Gjysma e parë 2021 – gjysma e 2-të 2030	MSHMS, MFE, NJVV-të, organizatat ndërkombëtare	Nevojiten më shumë të dhëna për të bërë një vlerësim

fokus linjën telefonike të ndihmës, këshillimin psikologjik, strehimin, etj).			
III.2.6.a. Analiza e kuadrit ligjor dhe politikave për të evidentuar mundësinë e aplikimit të lehtësirave fiskale për qiradhënësit / qiradhënëset që i japin banesat e tyre për strehim social, veçanërisht për rastet e grave, të rejave dhe vajzave të dhunuara/trafikuar, nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, të moshuara, nëna të vetme, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese, etj.).	Gjysma e parë 2022 – gjysma e 2-të 2022	Ministria e Brendshme, MSHMS, MFE, MD, OJQ-të, organizatat ndërkombëtare	Nuk ka filluar
III.2.6.e. Mbështetja e bashkive (trajnimi dhe mentorimi) për të zhvilluar dhe zbatuar skema/plane të integritit socio-ekonomik të grave dhe vajzave viktime të dhunës në familje e dhunës me bazë gjinore	Gjysma e parë 2021 – gjysma e 2-të 2023	Ministria e Brendshme, MSHMS, MFE, OJQ-të, organizatat ndërkombëtare	Ka filluar me fonde nga donatorët

Konkluzione:

Strategjia Kombëtare e Barazisë Gjinore është një nga instrumentet kryesore që tregon punën e kryer në praktikë për adresimin e tematikave të ndryshme që lidhen me barazinë gjinore në Shqipëri, përfshirë këtu luftën kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Strategjia e re 2021-2030 është ndërtuar bazuar në mësimet, arritjet dhe sfidat e strategjisë së kaluar. Disa prej masave të parashikuara në strategji që duhet të kishin filluar ndërmjet vitit 2021 dhe 2022 kanë nisur ndërkohë që të tjera ende nuk kanë filluar zbatimin ose nuk ka informacion të disponueshëm. Do të ishte e rekomandueshme të zhvilloheshin rishikime të strategjisë çdo 6 muaj në mënyrë që të kuptohet sa më mirë situata e zbatimit dhe të mos pritët deri në mes të strategjisë për të parë progresin e kryer. Gjithashtu përveç monitorimit të strategjisë do të ishte efikase edhe vlerësimi i zbatimit të saj dhe arritjet e strategjisë për çdo vit zbatimi.

Seksioni VI - Analizë krahasuese e kuadrit legjislativ dhe praktikës së mirë të vendeve të tjera

Dhuna me bazë gjinore dhe dhuna në familje është një fenomen mbarëbotëror, që prek të gjitha shtetet dhe shoqëritë. Shumica e tyre kanë miratuar dhe zbatuar korniza ligjore dhe institucionale për ta adresuar këtë fenomen shqetësues. Për këtë arsye një analizë e ligjeve të vendeve të ndryshme u ndërmor për të identifikuar praktika të mira e të reja të cilat mund të përdoren për të përmirësuar kuadrin ligjor shqiptar. Më poshtë ofrohet një përmbledhjeve e gjetjeve kryesore sipas vendeve duke theksuar elementet që mungojnë në legjislacionin shqiptar, të cilat do ta përmirësonin atë.

Andorra: Ligji për çrënjosjen e dhunës me bazë gjinore dhe në familje në Andorra përmban një seksion të tërë kushtuar të drejtave të viktimës. Ky seksion rendit të gjitha shërbimet e përgjithshme dhe të specializuara për personat e mbijetuar të cilët duhet të kenë akses të garantuar për të siguruar mbrojtjen e tyre. Një element i rëndësishëm i theksuar në këtë pjesë të ligjit është e drejta e anonimitetit dhe konfidencialitetit të të mbijetuarve. Gjithashtu, ai u jep të mbijetuarve të drejtën të marrin informacion për gjendjen e autorit, pavarësisht nëse ata janë pjesë e procedurës ose kanë bërë ankesë apo jo. **Anonimati dhe konfidencialiteti nuk përmenden në LDHF në Shqipëri.** Ndërsa ka ligje që mbrojnë të dhënat, është e rëndësishme që këto të jenë parimet thelbësore të LDHF.

Rekomandim për Shqipërinë: Përfshirje në LDHF e një neni të veçantë mbi të drejtat e të mbijetuarve të dhunës dhe theksimin e parimit të konfidencialitetit.

Argjentina: Ligji për mbrojtjen gjithëpërfshirëse të grave në Argjentinë **njuh edhe dhunën simbolike.** Kjo lloj dhune sipas këtij ligji, synon që nëpërmjet modeleve, mesazheve, vlerave, ikonave apo shenjave stereotipike të transmetojë dhe riprodhojë dominimin, pabarazinë dhe diskriminimin në marrëdhëniet shoqërore, duke natyralizuar nënshtrimin e grave në shoqëri. Gjithashtu, në kuadër të Këshillit Kombëtar për Gratë, **ligji përfshin themelimin e Observatorit të Dhunës ndaj Grave, i ngarkuar me monitorimin, mbledhjen, prodhimin, regjistrimin dhe sistemin e të dhënave dhe informacionit për dhunën ndaj grave.**⁷³ Ky është i ngjashëm me një observator të femcidit, por me fushëveprim më të gjerë pasi parashikon mbledhjen dhe sistematizimin e të dhënave që kanë lidhje me të gjitha format e dhunës ndaj grave.

Ekador: Një Observator i ngjashëm gjendet edhe në Ekuador me detyra të ngjashme dhe me përgjegjësi shtesë për të mbikëqyrur zbatimin e ligjit. **Duke pasur parasysh fragmentarizimin e mbledhjes së të dhënave për dhunën ndaj grave në Shqipëri, krijimi i një observatori të tillë në kuadër të Këshillit Kombëtar për Barazinë Gjinore, me burimet e duhura, ose i vendosur në një**

⁷³World Bank. 2019. Compendium of International and National Legal Frameworks on Domestic Violence. Online: <https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/31146/CompendiumDomesticViolencePt2.pdf?sequence=3&isAlloëed=y>

institucion tjetër të të drejtave të njeriut, mund të jetë një praktikë pozitive për t'u miratuar.

Observatori mund të mbledhë të dhëna nga institucione të ndryshme dhe të krijojë dhe shpërndajë këto të dhëna të centralizuara me qëllim që të kuptojë më mirë fenomenin dhe të hartojë politika rreth parandalimit dhe çrrënjësjes së dhunës bazuar në prova. Nëse aktet e dhunës në familje vazhdojnë, ligji parashikon që gjyqtari mund t'i komunikojë aktet e dhunës organizmit, institucionit, sindikatës, shoqatës profesionale ose vendit të punës së agresorit.⁷⁴

Rekomandim për Shqipërinë: Shtimin e një entiteti që të observojë në mënyrë sistematike dhunën ndaj grave, sidomos femicidin.

Shumë ligje për parandalimin e dhunës ndaj grave që në fillim përvijojnë parimet kyçe që mbështesin ligjin, duke përfshirë parimin e barazisë, mosdiskriminimit, mbrojtjen e interesit më të mirë të fëmijës, privatësinë e informacionit etj. Ligji shqiptar duhet të shtojë këto parime si udhërrëfyes për të gjitha autoritetet përgjegjëse në zbatimin e ligjit. Mund t'i referohemi Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili përmban nene të veçanta për këtë.

Armenia: Në Armeni, Ligji për Parandalimin e Dhunës në Familje, Mbrojtjen e Viktimave dhe Rivendosjen e Paqes (2017) **përfshin neglizhencën si një formë dhune.** Në mënyrë të veçantë ai e përkufizon neglizhencën si “dështim të qëllimshëm për të ofruar kushte minimale të nevojshme të jetesës (ushqim, veshje, strehim, kujdes shëndetësor dhe shërbim mjekësor, arsim) për fëmijën nga një prind ose kujdestar ligjor, ose kushte minimale të nevojshme të jetesës (ushqim, veshje, strehim, kujdesi shëndetësor dhe shërbimi mjekësor) për prindërit e paaftë ose në disavantazh nga fëmijët e tyre të aftë dhe të rritur kur prindi ose kujdestari ligjor ose fëmijët e rritur të aftë kanë informacionin dhe burimet e duhura, si dhe akses në shërbimet përkatëse”.⁷⁵ Më tej, **ligji armen përfshin paralajmërimin si një nga mekanizmat mbrojtës.** Ai zbaton paralajmërimin përpara se një rast të kërkojë ndërhyrje urgjente dhe mund të jetë një praktikë e mirë për të parandaluar përshkallëzimin e një rasti. Paralajmërimi “do të zbatohet kur Policia identifikon për herë të parë një rast dhune brenda familjes, nuk ka elemente të dukshme të shkeljes dhe nuk ka arsye për ndërhyrje emergjente. Vendimi paralajmëruar duhet të përfshijë një njoftim për sanksionet ligjore të zbatueshme në rast të dhunës së vazhdueshme ose të përsëritur. Paralajmërimi lëshohet sa më shpejt që të jetë e mundur pasi mësohet për rastin.”⁷⁶ Rekomandim për Shqipërinë: **Ky lloj mekanizmi mbrojtës, pra paralajmërimi para se rasti të shkojë për ndërhyrje emergjente, mund të shtohet përpara nxjerrjes së urdhrave të mbrojtjes në legjisllacionin shqiptar.**

Së fundi, ligji përmban një nen të veçantë për konfidencialitetin e informacionit në lidhje me viktimat e dhunës, ku ndalohet zbulimi i një informacioni të tillë pa pëlqimin e viktimës përmes mediave ose kanaleve të tjera. Më tej, neni parashikon se “shkelja e të drejtës së paprekshmërisë

⁷⁴ Article 32

⁷⁵ Armenia. 2017. Parandalimi i dhunës në familje, mbrojtja e viktimave dhe rivendosja e paqes në familje. Neni 3

⁷⁶ Armenia. 2017. Parandalimi i dhunës në familje, mbrojtja e viktimave dhe rivendosja e paqes në familje. Neni 6

së jetës private ose familjare sjell përgjegjësi ligjore dhe dëmi i shkaktuar ndaj personit do të shpërblehet siç përcaktohet në ligj.”⁷⁷

Rekomandim për Shqipërinë: Duke marrë parasysh numrin e madh të rasteve kur informacioni privat shpërndahet në media në Shqipëri, një përcaktim i tillë specifik në ligjin për DhF do të kishte kuptim dhe do të ndihmonte në mbrojtjen e të mbijetuarit nga riviktimizimi.

Bolivi: Në Bolivi, Ligji Gjithëpërfshirës për t’u garantuar Grave një jetë pa dhunë, përfshin femicidin dhe dhunën mediatike në përkufizimin e tij të formave të ndryshme të dhunës. Femicidi përkufizohet si veprim i dhunës ekstreme që cenon të drejtën themelore të jetës dhe shkakton vdekjen e grave për shkak të gjinisë së tyre. Dhuna mediatike është dhuna e prodhuar nga masmedia përmes publikimeve, shpërndarjes së mesazheve dhe imazheve e stereotipave që promovojnë nënshtrimin dhe/ose shfrytëzimin e grave, të cilat fyejnë, shpifin, diskriminojnë, çnderojnë, poshtërojnë ose minojnë dinjitetin, emrin dhe imazhin e tyre.⁷⁸ **Duke pasur parasysh se të dyja këto forma të dhunës janë të përhapura në Shqipëri, do të ishte një praktikë e mirë përfshirja e tyre në LDHF si forma të njohura të dhunës.** Ligji bolivian gjithashtu njeh dhunën kundër të drejtave dhe lirive seksuale si çdo veprim ose mosveprim që pengon ose kufizon ushtrimin e të drejtave të grave dhe vajzave për të gëzuar një jetë seksuale të lirë, të sigurt, afektive dhe të plotë ose që cenon lirinë e tyre të zgjedhjeve seksuale.

⁷⁷ Armenia. 2017. Parandalimi i dhunës në familje, mbrojtja e viktimave dhe rivendosja e paqes në familj. Neni 22

⁷⁸ Bolivia. 2013. Ligji Gjithëpërfshirës për t’u garantuar grave një jetë pa dhunë. Neni 7

Kutiza 7

Neni 17, Ligji Gjithëpërfshirës për Garantimin e Grave një jetë pa dhunë në Bolivi.

- Parandalimi strukturor përfshin të gjitha ato masa të një natyre integrale që synojnë modifikimin e qëndrimeve, praktikave, reagimeve, veprimeve dhe mosveprimeve që kanë si efekt dhe pasojë dhunën ndaj gruas, si dhe zëvendësimin e saj me qëndrime në sjelljen e individit, çiftit, familjes, komunitetit, shoqërisë dhe shtetit, nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe edukimit brenda familjes, në shkollë dhe në nivele të tjera akademike, në punë, në qendrat e kujdesit shëndetësor... organizatat politike dhe sindikatat, organizatat sociale dhe çdo fushë tjetër ndërveprimi shoqëror.
- Parandalimi Individual. Ai u referohet masave që synojnë forcimin dhe fuqizimin e çdo gruaje dhe promovimin e aftësive të saj për të identifikuar çdo manifestim të mundshëm të dhunës apo agresionit ndaj saj, duke e përballuar me vendosmëri dhunën, me qëllim parandalimin e shfaqjes ose vazhdimin të saj
- Parandalimi kolektiv. Masat e krijuara për të parandaluar dhunën dhe për të mbrojtur gratë përmes organizatave, institucioneve ose çdo komuniteti të cilit i përkasin për nga afërsia (komitetet e lagjeve, sindikatat, komunitetet, kombet, vendasit vendas (campesinos), ndërkulturor dhe afro-bolivian). II. Prioritet duhet t'i jepet parandalimit në mjediset familjare, komunitare, arsimore, shëndetësore, punës dhe komunikimit.

Burimi: Banka Botërore. 2019. Përmbledhje e Kornizave Ligjore Ndërkombëtare dhe Kombëtare për Dhunën në Familje.

Përveç kësaj, ekziston një strategji gjithëpërfshirëse parandaluese në ligjin bolivian që fillon nga parandalimi strukturor në atë individual dhe kolektiv. Këto masa, siç përshkruhen në ligj, trajtojnë shkaqet rrënjësore të dhunës dhe ia vlen të përmenden si një praktikë e mirë për të përmirësuar pjesën e LDHF mbi mekanizmat e parandalimit.

Rekomandim për Shqipërinë: Krijimi i një strategjie të veçantë për parandalimin e dhunës që të jetë sistematik dhe të kërkojë ndryshime në mendësi dhe sjellje.

Një tjetër risi e ligjit bolivian është krijimi i “Shtëpive Komunitare për Gratë në zonat rurale”, ku gratë e organizuara mund të përcaktojnë krijimin e Shtëpive të Komunitetit për Gratë, për të cilat Qeveria Komunale Autonome do të sigurojë infrastrukturën e nevojshme. Ato që janë të artikuluar në rrjetin e promotorëve të komuniteteve në komunitete të ndryshme që do të marrin pjesë dhe do të kryejnë detyrat e orientimit, parandalimit dhe zbulimit të rasteve të dhunës, mund të nënshkruajnë marrëveshje me autoritetet publike dhe institucionet private.⁷⁹

Rekomandim për Shqipërinë: Një praktikë e tillë në nivel komunitar mund të replikohet në Shqipëri duke marrë për bazë njësitë administrative që mund të shërbejnë për këtë qëllim, sidomos

⁷⁹ Bolivia. 2013. Ligji Gjithëpërfshirës për t'u garantuar grave një jetë pa dhunë. Neni 30

administratorët socialë të cilët sipas VKM 327 duhet të luajnë rol në mekanizimin e koordinuar të referimit në nivel vendor.

Kolumbi. Në Kolumbi, neni 14 i ligjit për ndërgjegjësimin, parandalimin dhe sanksionimin e diskriminimit dhe dhunës ndaj grave paraqet ndër të tjera detyrat e familjes për të promovuar të drejtat e grave në të gjitha fazat e jetës dhe eliminimin e të gjitha formave të dhunës dhe pabarazisë ndaj grave. Këto detyra familjare përfshijnë, ndër të tjera, parandalimin e akteve që kërcënojnë ose shkelin të drejtat e grave, mos kryerjen e veprimeve ose sjelljeve që përfshijnë keqtrajtim fizik, seksual, psikologjik dhe trashëgimlënës ndaj grave dhe masa të tjera në respektimin dhe promovimin e pjesëmarrjes së grave në vendimet familjare, duke siguruar të drejtat e tyre seksuale dhe riprodhuese si dhe autonominë.

Rekomandim për Shqipërinë: Në kuadër të ndërhyrjeve në qelizat bërthamore familjare si mënyrë për të ndryshuar mendësitë dhe normat shoqërore do të ishte me vlerë përfshirja e edukimit familjar më qartësisht në LDHF dhe përcaktimi i përgjegjësiwe institucionale në këtë fushë.

Kroaci. Në Kroaci, midis një liste shteruese të të drejtave të viktimave, përfshihet koncepti i një personi të besuar, që mund të shoqërojë viktimën në të gjitha procedurat dhe shërbimet përkatëse. Ligji përcakton gjithashtu një komision në kuadër të ministrisë përgjegjëse për çështjet e drejtësisë, i cili është përgjegjës për marrjen e të dhënave të mbledhura nga autoritetet përkatëse dhe publikimin e një raporti vjetor mbi zbatimin e ligjit. **Kjo është një praktikë që mund të shkruhet në LDHF dhe të aplikohet edhe në Shqipëri me themelimin e Institutit Parlamentar.** Edhe pse për SKBGJ dhe Planin e Veprimit 2016 -2020 ka një vlerësim, nuk ka monitorim dhe raportim sistematik mbi zbatimin e LDHF për të garantuar zbatimin në praktikë të masave të parashikuara në ligj. Edhe pse në Shqipëri çdo strategji ka mekanizmat e monitorimit, problemi qëndron se si bëhet ky monitorim. Kuvendi i Shqipërisë mes komisioneve dhe nënkomisioneve parlamentare, nënkomisionit të barazisë gjinore dhe parandalimit të dhunës ndaj grave dhe grupit vullnetar parlamentar të grave deputete mund të bëjë shumë për monitorimin dhe kërkesën e llogarisë. Kuvendi i Shqipërisë e ka detyrim në kuadër të strategjisë së miratuar për një parlament me ndjeshmëri gjinore.

Kutiza 8

Ligji për Parandalimin dhe Çrrënjosjen e Dhunës ndaj Grave

- Qasja ndërkulturore: njohja e ekzistencës së komuniteteve, popujve dhe kombësive të ndryshme që përbëjnë shtetin, duke respektuar të gjitha ato shprehje në kontekste të ndryshme kulturore. Sipas kësaj qasjeje, praktikat diskriminuese që favorizojnë dhunën nuk pranohen.
- Qasja ndër breza: njohja e ekzistencës së nevojave dhe të drejtave specifike në çdo fazë të jetës, fëmijërisë, adoleshencës, pjekurisë dhe moshës madhore; dhe të vendosë prioritetin e identifikimit dhe trajtimit të dobësive në këto faza të jetës.
- Qasja ndërsektoriale: identifikoni dhe vlerësoni kushtet sociale, ekonomike, politike, kulturore, fetare, etnike, gjeografike, fizike dhe të tjera që janë pjesë e njëkohshme e identitetit individual dhe komunitar të grave dhe përshtatni veprimet me këto realitete, shërbime dhe politikat publike që synojnë parandalimin dhe çrrënjosjen e dhunës ndaj grave dhe kujdesin, mbrojtjen dhe kthimin e të drejtave të viktimës.

Burimi: Banka Botërore. 2019. Përmbledhje e Kornizave Ligjore Ndërkombëtare dhe Kombëtare për Dhunën në Familje.

Ekuador. Në Ekuador, Ligji për Parandalimin dhe Çrrënjosjen e Dhunës ndaj Grave paraqet idenë e përgjegjësisë së përbashkët, sipas së cilës shteti është përgjegjës për garantimin e të drejtës së grave: vajzave, adoleshenteve, grave të rritura dhe grave të moshuara, për një jetë pa dhunë. Shoqëria, familja dhe komuniteti janë përgjegjës për pjesëmarrjen në veprimet, planet dhe programet për çrrënjosjen e dhunës ndaj grave, të ndërmarra nga shteti në të gjitha nivelet. Këto tre institucione angazhohen në formulimin, vlerësimin dhe kontrollin social të politikave publike që janë krijuar për këtë qëllim. Përveç kësaj, ligji përmban një seksion mbi qasjet kryesore që mbështesin të gjitha masat për parandalimin dhe çrrënjosjen e dhunës.

Së fundi, ligji ekuadorian prezanton një sistem paralajmërimi të hershëm si një mekanizëm për të shmangur femicidin duke analizuar informacionin që përmban regjistri kombëtar i dhunës ndaj grave dhe duke identifikuar nivelin e rrezikut bazuar në një model sasior ose cilësor për identifikimin e rrezikut për një viktimë të mundshme.

Guatemala. Në Guatemalë, ekziston një interpretim gjithëpërfshirës dhe i gjerë i dhunës ndaj grave, duke mos e kufizuar atë në dhunën në familje. Në këtë drejtim, neni 7 i Ligjit Kundër Femicideve dhe formave të tjera të dhunës ndaj grave e përkufizon dhunën ndaj gruas në radhë të parë si një krim kundër grave të kryer nga kushdo qoftë, publikisht apo privatisht. Ai gjithashtu përfshin shprehimisht mizogjininë si një nga rrethanat në të cilat ndodh dhuna ndaj grave.

Rekomandime

Të përgjithshme:

1. Kërkohej një institucion shtetëror (agjenci ose komisioner) i kompletuar me burime njerëzore dhe financiare që të koordinojë, zbatojë, monitorojë të gjitha detyrimet ligjore dhe të politikave që lidhen me barazinë gjinore dhe dhunën me bazë gjinore.
2. Ligji i DHF duhet të shtojë një nen specifik që parashtron me detaje të drejtat e viktimës që raporton dhunën.
3. Ligji i DHF duhet të shtojë një nen specifik ku të parashtrihen parimet në zbatimin e tij, si parimi i mos-diskriminimit, vendosja e interesit të viktimës, veçanërisht viktimës fëmijë, në qendër të shërbimeve, parimi i ruajtjes së të dhënave personale etj. Këto janë të nevojshme dhe duhet të përshkojnë të gjitha nenet e ligjit.

Ndërgjegjësimi dhe parandalimi

4. Është e domosdoshme përfshirja në kurrikulën mësimore të çështjeve të barazisë gjinore dhe dhunës me bazë gjinore jo vetëm për Fakultetin e Shkencave Sociale, por edhe për fakultetet e tjera.
5. Të dy strategjitë, SKBGJ (2021 – 2030) dhe SKA (2021 – 2026) duhet të harmonizojnë më mirë masat që lidhen me barazinë gjinore.
6. Përfshirja në kurrikulën mësimore parauniversitare të çështjeve të barazisë gjinore nuk duhet bërë në mënyrë të cunguar duke përfshirë një seancë mësimore, por duhet shtrirë më gjatë në kohë dhe të zgjerohet në përmbajtje.
7. Një strategji e veçantë për angazhimin me median dhe sektorin privat duhet të hartohet dhe zbatohet.
8. Të specifikohet në tekstin e ligjit shpeshësia dhe qëndrueshmëria e trajnimeve për profesionistët që luajnë rol në parandalimin dhe adresimin e dhunës me bazë gjinore.
9. Duhet institucionalizuar trajnimi i vazhdueshëm për ofruesit e shërbimeve në baza vjetore për të shkuar përtej sesioneve që ndodhin një herë në disa kohë.
10. Institucioni koordinues duhet të marrë masa që trajnimet e organizuara si nga institucionet publike, ato private apo tjetër të jenë të mirëkoordinuara, të ditura dhe të regjistruara.
11. Një seancë trajnuese për të krijuar aleatë në punën me burra dhe djem nuk mjafton për të arritur qëllimet për parandalimin e DHBGJ/DHB. Këto trajnime edukuese dhe ndërgjegjësuese duhet të organizohen më shpesh, të paktën çdo vit për kohëzgjatjen e SKBGJ-së.
12. Të punohet në mënyrë të vazhdueshme për të sjellë ndryshime sistemike, të qëndrueshme dhe në shkallë sa më të gjerë të perceptimeve dhe sjelljeve që lejojnë vazhdimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave.
13. Trajnimi dhe ndërgjegjësimi i ofruesve të shërbimeve, veçanërisht policisë, për mosdiskriminimin dhe sigurimin e mbrojtjes në mënyrë të barabartë për të gjithë ata që

raportojnë dhunën, pavarësisht se cilit grup i përkasin dhe pa paragjykime, duhet të jetë i vazhdueshëm.

Mbrojtja

14. Të rishikohet neni 8 i ligjit për të përfshirë shprehimisht detyrimin për të ofruar informacione në një gjuhë të kuptueshme për çdo viktimë të dhunës, në linjë me kërkesat e Konventës së Stambollit. Neni 8 gjithashtu të rishikohet për të përfshirë në morinë e informacioneve në dispozicion të viktimës të gjitha llojet e shërbimeve, jo vetëm shërbimet sociale.
15. VKM 327 duhet të shtojë dhënien e informacionit viktimave jo vetëm nga ana e Koordinatorit Vendor të Dhunës por të gjithë përfaqësuesit e institucioneve që marrin pjesë në MKR në mënyrë që të jetë i harmonizuar edhe me ligjin.
16. Do ta bënte më koherente, veçanërisht për praktikuesit, nëse ligji për DhF-në do të kishte një seksion specifik për shërbimet mbështetëse dhe mënyrën se si ato duhet të koordinohen dhe t'i referohen legjislacionit tjetër përkatës.
17. Duhet të krijohet një ligj për dhunën me bazë gjinore, me mbrojtje më gjithëpërfshirëse për personat e mbijetuar të të gjitha formave të dhunës.
18. Ligji i DHF duhet të rishikohet që të përfshijë shpjegimin e detajuar të mekanizmave të mbrojtjes, përveç urdhrave të mbrojtjes, në mënyrë që të mos ketë vend për paqartësi.
19. Të përfshihen në urdhrat e mbrojtjes viktimat të formave të tjera të dhunës, jo vetëm të dhunës në familje.
20. Strategjitë kombëtare që targetojnë grupe vulnerabël, si për shembull personat me aftësi të kufizuara, të komunitetit Rom dhe Egjiptian dhe të komunitetit LGBT, duhet të përfshijnë më tepër masa për parandalimin dhe adresimin e dhunës kundër grave dhe vajzave nga këto komunitete dhe të harmonizohen më mirë me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore.
21. Duhet marrë masa të menjëhershme për të inkurajuar të gjithë personat që përjetojnë dhunë që ta raportojnë atë përmes fushatave informuese dhe punës në komunitete lokale dhe rurale.
22. Më shumë financim dhe mbështetje për organizatat e grave Rome e Egjiptiane do të ndihmonte në rritjen e shkallës së raportimit dhe aksesit në shërbime.

Politikat e integruara

23. Një shpjegim më i detajuar i rolit koordinues në nivel qendror do t'i bënte më të qarta përgjegjësitë dhe detyrat raportuese që të kuptoheshin më mirë ndërmjet institucioneve të ndryshme.
24. Duhet të kodifikohet në ligj që INSTAT-it t'i caktohen përgjegjësi specifike si mbledhja e të dhënave, kryerja e studimeve sasiore.
25. Ligji mund të shtojë përgjegjësitë e medias ndër të tjera:
 - Miratimi i kodeve të etikës dhe masave të tjera të vetërregullimit, veçanërisht lidhur me shpërndarjen e përmbajtjeve diskriminuese të lidhura me dhunën ndaj grave, që

- justifikojnë ose përforcojnë tolerancën ndaj asaj dhune ose që cenojnë të drejtat e grave.
- Të caktohet një hapësirë minimale e lirë për shpërndarjen e mesazheve që promovojnë vlerat e përcaktuara në LDHF.
26. Duke pasur parasysh rëndësinë e parandalimit dhe edukimit, rol që duhet të mbahet nga institucionet arsimore, si dhe rëndësinë e pavarësisë financiare dhe riintegrimin ekonomik të grave të mbijetuara të dhunës, LDHF duhet të rishikohet për të përcaktuar qartë detyrat e çdo institucioni në lidhje me përgjigjen e koordinuar kundër dhunës dhe riintegrimin e personave të mbijetuar dhe të shtojë përgjegjësitë e ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe ministrisë përgjegjëse për punësimin.
27. Krijimi i një sistemi apo baze të dhënash të centralizuar për të harmonizuar dhe adresuar fragmentimin e të dhënave ndërmjet institucioneve të ndryshme.

Zbatimi i legjislacionit nga institucionet në nivel qendror dhe vendor:

28. Duhet të ketë mekanizma më të qartë llogaridhënieje të të gjithë aktorëve të përfshirë në zbatimin e legjislacionit në fuqi kundër dhunës me bazë ligjore. Marrja e masave ndëshkuese në mungesë të zbatimit të detyrimeve ligjore është një hap i domosdoshëm që duhet të kthehet në praktikë të mirëvendosur.
29. Jo të gjitha dispozitat e ligjit janë zbatuar ndër vite nga institucionet shqiptare ndaj duhet të ketë mekanizma që institucionet të jenë më proaktive në rolet dhe përgjegjësitë e tyre.
30. Mekanizmi i Koordinuar i Referimit në nivel vendor është një nga strategjitë më të mira të adresimit të dhunës me bazë gjinore ndaj duhet punuar fort për rritjen e efikasitetit të tij.
31. Duhet të ketë burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për të mundësuar zbatimin e legjislacionit.
32. Duhet të rriten burimet në dispozicion të ministrisë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit të dhunës në mënyrë që të luajë vërtet rol koordinues dhe të drejtojë punën e autoriteteve të tjera përgjegjëse për të zbatuar ligjin.
33. Të shtohen më tepër mekanizma monitorimi të zbatimit të ligjit dhe të strategjisë së barazisë gjinore.
34. Të rriten kapacitetet profesionale të përfaqësuesve të institucioneve të ndryshme që luajnë një rol në menaxhimin dhe adresimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Rekomandime për LDHF nga praktikantët më të mira në vende të ndryshme të botës

35. Sigurimi i tolerancës ose reduktimit të orarit të punës për gratë që ndodhen në situatë dhune, pa cenuar të drejtat e tyre të punës dhe të pagave.
36. Të ngrihen njësi Lëvizëse Kundër Dhunës me personel dhe pajisje të specializuara për pritjen e ankesave dhe asistencën e menjëhershme, në koordinim me prokurorët e çështjes, në vendin ku është ngritur ngjarja, me prioritet veprimin e tij në zonën rurale.

37. Mekanizmat e financimit për masa të ndryshme mbrojtëse dhe zbatimin e ligjit. Shumë ligje për dhunën ndaj grave përmbajnë nene të tilla specifike, të cilat mungojnë në legjislacionin shqiptar.

38. Përfshirja e një seksioni të veçantë që fokusohet në parandalimin në LDHF.

Anekse

Lista e personave të intervistuar:

Emri i Institucionit	Personi i kontaktuar	Pozicioni
Parlamenti i Shqipërisë	Lindita Nikolla	Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë
Anëtare e Kuvendit të Shqipërisë, Kryetare e Komisionit të Ligjeve	Klotilda Ferhati	Anëtare e Kuvendit të Shqipërisë
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Nertila Topulli Brunilda Dervishaj	Drejtoare e Përgjithshme Drejtorja e Politikave dhe e Zhvillimit Të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale/ Shefe e Sektorit të Barazisë Gjinore
Ministria e Drejtësisë	Tetis Lubonja	Pika fokale gjinore
Ministria e Brendshme	Romina Kuko	Zëvendës Ministre
Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	Alma Katragjini	
Këshilli i Lartë Gjyqësor	Naureda Llagami	Kryetare
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	Robert Gajda	Komisioneri
Avokati i Popullit	Erinda Ballanca	Avokati i Popullit
President i GREVIO	Iris Luarasi	
Bashkia Tiranë	Anisa Subashi, Migena Spaho, Anjeza Bojaxhi,	Drejtoreshë e përgjithshme e shërbimit social Tiranë Drejtoare e përfshirjes dhe mbrojtjes sociale Koordinatore e DHF
Bashkia Shkodër	Lorena Bardeli Filip Vila	Koordinatore e DHF Drejtor i Shërbimit Social
Bashkia Vlorë	Rezarta Andoni	Kordinatore e DHF
Bashkia Korçë	Inelda Hasankolli	Kordinatore e DHF
Bashkia Elbasan	Marsida Sejdini Ervin Muco	Nëpunëse gjinore Drejtor i Shërbimit Social
Bashkia Pogradec	Arbi Basho	Kordinator i DHF
Bashkia Pukë	Anjeza Doda	Kordinatore e DHF
INSTAT	Elsa Dhuli Majlinda Nesturi	Drejtoare
Qendra për Nisma Ligjore	Aurela Bozo	

AËEN	Ines Leskaj	
Koalicioni kundër Trafikimit të qenieve njerëzore	Brikena Puka dhe /ose Mariana Meshi/ Arian Cala	Drejtorë të OSHC-ve përkatëse Vatra, Të Ndryshëm & të Barabartë Tjeter Vizion
3 eksperte	Arta Mandro Aurela Anastasi	
Ekspert	Agustela Nini	
2 ish-deputete	Eglantina Gjermeni Vasilika Hysi	Ish-deputete

Lista e plotë e ligjeve dhe politikave në lidhje me dhunën me bazë gjinore

Viti 1995

- Ligji nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar)
- Ligji nr. 7995, datë 20.09.1995 "Për nxitjen e punësimit" (i ndryshuar)
- 1998 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- 1999 Ligji nr. 8454, datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" (i ndryshuar)
- 2002 Ligji nr. 8876, datë 04.04.2002 "Për shëndetin riprodhues" (i ndryshuar)

2004

- Ligji nr. 9188, datë 12.2.2004 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal"
- Ligji nr. 9198, datë 01.07.2004 "Për barazinë gjinore në shoqëri" (shfuqizuar)
- Strategjia Kombëtare për HIV/AIDS 2004-2010

2005

- Ligji nr. 9398, datë 12.05.2005 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin për Avokatin e Popullit"

2006

- Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" (i ndryshuar)

2007

- Strategjia e parë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Eliminimin e Dhunës në Familje (SKBGj-EDhF) 2007-2010.

2008

- Ligji nr. 9914, datë 12.05.2008 "Për disa shtesa në Ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 'Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare'"
- Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri"
- Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar)
- Ligji nr. 10039, datë 22.12.2008 "Për ndihmën juridike" (shfuqizuar)

2009

- Ligji nr. 10192, datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese ndaj pasurisë" (i ndryshuar)

2010

- Ligji nr. 10221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

- Ligji nr. 10237, datë 18.2.2010 "Për shëndetin dhe sigurinë në punë" (i ndryshuar)
 - Ligji nr. 10295, datë 01.07.2010 "Për faljen"
 - Ligji nr. 10347, datë 4.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve" (shfuqizuar)
- 2011
- Ligji nr. 10399, datë 17.03.2011, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" (i ndryshuar)
- 2013
- Udhëzim i Përbashkët nr. 21, datë 21.06.2013, ndërmjet MPÇSSHB dhe Ministrisë së Financës "Për përcaktimin e procedurave për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm"
- 2014
- Plani Kombëtar i Veprimit për Gratë Sipërmarrëse 2014-2020
 - Plani Kombëtar i Veprimit për përfshirjen e burrave dhe djemve si partnerë të grave dhe vajzave në masat për barazinë gjinore dhe kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.
 - Programi për Nxitjen e Punësimit "Për punëkërkuessit e papunë në vështirësi", nr. 48, datë 11.01.2012, ndryshuar me nr. 192, datë 02.04.2014.
 - Programi i Nxitjes së Punësimit përmes Trajnimit të Vazhdueshëm nr. 47, datë 16.01.2008, ndryshuar me nr. 193, datë 02.04.2014
- 2015
- Ndryshimet e miratuara në Kodin Zgjedhor me Ligjin 74/2012 për të garantuar 50% gra në këshillat vendorë në NjQV-të e reja
- 2016
- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit 2016-2020
 - Ligji nr. 70/2016 "Për zejtarinë në Republikën e Shqipërisë", miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë më 30.06.2016
 - Korniza Ligjore (Ligji nr. 44/2016, datë 21.04.2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar)
- 2018
- Për Disa Shtesa Dhe Ndryshime Në Ligjin Nr. 9669, Datë 18.12.2006, "Për Masa Ndaj Dhunës Në Marrëdhëniet Familjare", të ndryshuar me ligjin nr. 47/2018, 23.07.2018
- 2019
- Ligji nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale Në Republikën E Shqipërisë"
 - Ligji nr. 15/2019 "Për nxitjen e punësimit"
 - "Mbi Arovimin e dokumentit politik" Vlerësim i reformës së paaftësisë në sistemin e mbrojtjes sociale dhe plani i veprimit 2019-2024 për zbatimin e tij, nr. 380, datë 05.06.2015
 - Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale, 2020–2023, dhe të Planit të Veprimit në zbatim të saj, nr. 866, datë 24.12.2019
 - Vendimi nr. 864, datë 24.12.2019 "Për miratimin e dokumentit politik kombëtar për moshimin, 2020–2024, dhe të planit të veprimit për zbatimin e tij
 - Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2022, nr. 659, datë 10.10.2019
- 2020

- Ligji nr. 125/2020 “Për Disa Shtesa Dhe Ndryshime Në Ligjin Nr. 9669, Datë 18.12.2006 “Për Masa Ndaj Dhunës Në Marrëdhëniet Familjare”, Të Ndryshuar.
- Ligji 35/2020 Për Disa Shtesa Dhe Ndryshime Në Ligjin Nr. 7895, Datë 27.1.1995, “Kodi Penal I Republikës Së Shqipërisë”, Të Ndryshuar
- Ligj Nr. 124/2020 Për Disa Shtesa Dhe Ndryshime Në Ligjin Nr. 10221, Datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen Nga Diskriminimi”

2021

- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit 2021-2030

Referenca dhe Bibliografi

Avokati i Popullit, 2016. Report on the Implementation of CEDAË Convention in Albania. <http://www.un.org.al/sites/default/files/CEDAË-Avokati-EN.PDF>

Albanian Disability Rights Foundation, 2018. Raport Vlerësimi. Dhuna ndaj grave e vajzave nga komunitete të pafavorizuara.

Albanian Disability Rights Foundation (2018). Report on access to services for ëomen from disadvantaged communities.

Beijing Platform Retrieved from <http://beijing20.unwomen.org/en/in-focus/environment#sthash.exlvkExv.dpuf>.

Armenia, 2017. Parandalimi i dhunës në familje, mbrojtja e viktimave dhe rivendosja e paqes në familje.

Bolivia, 2013. Ligji Gjithëpërfshirës për t'u garantuar grave një jetë pa dhunë.

Council conclusions on Combating Violence Against Women, and the Provision of Support Services for Victims of Domestic Violence. <https://eige.europa.eu/gender-based-violence/data-collection>

Commissioner for Protection against Discrimination. Annual Report 2018 and 2019

Committee on the Elimination of Discrimination against women (2016) Concluding observations on the fourth periodic report of Albania. file:///C:/Users/user/Downloads/CEDAW_C_ALB_CO_4-EN.pdf

Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women. Applications and Implications of the Article 11 in shoes and textile industry in Albania. Albanian NGO's Shadoë Report. Gender Alliance for Development Centre Albania June 2016

Council of Europe (2016). Balanced Participation of Women and Men in Decision Making. Retrieved from <https://rm.coe.int/analytical-report-data-2016-/1680751a3e>

Council of Europe. September 2018. Report by Mijatovic Dunja. <https://rm.coe.int/report-on-the-visit-to-albania-from-21-to-25-may-2018-by-dunja-mijatov/16808d2e22>

Danish Institute for Human Rights. No date. Study on Homophobia, Transphobia and Discrimination on DCM 327

Determinants of Female Labour Force Participation in the Western Balkans. Retrieved from <http://staging.bitsia.com/aer/wp-content/uploads/2017/12/Determinants-of-Female-Labour-Force-Participation-in-the-Western-Balkans.pdf>

Dhëmbo E., Duci V., Intimate partner violence and sexual violence among young people in Albania, AWEN, 2021. https://aëenetëork.org/ëp-content/uploads/2021/07/AËEN-Dhuna-EN-pages-web_compressed.pdf

European Parliament resolution of 26 November 2009 on the elimination of violence against Women. https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-7-2009-0098_EN.html

European Commission (2008) EU Gender Equality Laë. Retrieved from [file:///C:/Users/Gadcuser/AppData/Local/Temp/Rar\\$Dla5552.22956/ËEUEUGenderEqualityLaëKE8008432ENC30Oct%202008%20\(2\).pdf](file:///C:/Users/Gadcuser/AppData/Local/Temp/Rar$Dla5552.22956/ËEUEUGenderEqualityLaëKE8008432ENC30Oct%202008%20(2).pdf)

European Commission Progress report 2017, 2018 and 2019 for Albania

European Commission.(2016) Gender Equality in Europe. European network of legal experts in gender equality and non-discrimination. <file:///C:/Users/user/Downloads/GenderEqualityLaëinEurope-HoëareEURulestransposedintonationallaëin2016.pdf>

Explanatory Report to the Council of Europe Convention on preventing and combating violence against Women and domestic violence. <https://rm.coe.int/1680a48903>

Fact Sheet: Violence against Women and Girls ëith Disabilities. https://www.un.org/Womenëatch/daw/csw/csw57/side_events/Fact%20sheet%20%20VAËG%20ëith%20disabilities%20FINAL%20.pdf

GADC, 2020. Monitorimi i Objektivit të Tretë të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazinë Gjimore 2016-2020. Gjetjet kryesore dhe rekomandimet.

GREVIO,2017. Baseline Evaluation Report Albania. <https://rm.coe.int/grevio-first-baseline-report-on-albania/16807688a7>

Gender Equality Index for the Republic fo Albania, 2020. INSTAT, MoHSP and EIGE

Government of Albania- United Nations Programme of Cooperation. Gender report 2015-2016. GREVIO, 2017. Baseline Evaluation report. <https://rm.coe.int/grevio-first-baseline-report-on-albania/16807688a7>

Grounds of Sexual Orientation and Gender Identity. <https://rm.coe.int/study-on-homophobia-transphobia-and-discrimination-on-grounds-of-sexua/16809c908c>
<https://eca.unWomen.org/sites/default/files/Field%20Office%20ECA/Attachments/Publications/2019/11/ĚAVE SVReport191119 ěeb.pdf>

National-population-survey-violence-against-Women-and-girls-Albania.
<https://www.undp.org/albania/publications/national-population-survey-violence-against-Women-and-girls-albania>

IDRA and UN Women. 2018. Sexual harassment and other forms of gender-based violence in the public spaces in Albania. Tirana: UN Women

IDRA and UN Women. 2019. Sexual harassment and other forms of gender-based violence in the public spaces in Albania – Korça and Shkodra. Tirana: UN Women

Institute of Political Studies (2018). Standards of political representation. Retrieved from <http://isp.com.al/wp-content/uploads/2018/07/STANDARDS-OF-REPRESENTATION-IN-POLITICAL-PARTIES.pdf>

ILGA, 2022. Annual Review: 2021. <https://www.ilga-europe.org/files/uploads/2022/04/annual-review-2021.pdf>

INSTAT, 2019. Dhuna ndaj Grave e Vajzave në Shqipëri.
<http://www.instat.gov.al/media/6123/publication-violence-against-Women.pdf>

INSTAT, 2022. Gratë dhe Burrat në Shqipëri 2021. <http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/barazia-gjinore/publikimet/2021/grat%C3%AB-dhe-burrat-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-2021/>

Instituti i Statistikave i Shqipërisë, 2022. Gratë dhe Burrat në Shqipëri, 2021.
<http://www.instat.gov.al/media/8713/burra-dhe-gra.pdf>

Institute of Statistics (2011) Albania Time Use Survey 2010-2011. Retrieved from [file:///C:/Users/Gadcuser/AppData/Local/Temp/Rar\\$Dla5552.29424/time use survey 2011 AL.pdf](file:///C:/Users/Gadcuser/AppData/Local/Temp/Rar$Dla5552.29424/time use survey 2011 AL.pdf)

Institute of Statistics (2019) Violence against Women and Girls in Albania.

Institute of Statistics Institute of Public Health, Albania, the DHS Program ICF Rockville, Maryland, USA (October 2018) Albania Demographic and Health Survey 2017-18 Retrieved from [file:///C:/Users/Gadcuser/AppData/Local/Temp/Rar\\$Dla5552.33794/ADHS-2017-18-Complete-PDF-FINAL-ilovepdf-compressed-1.pdf](file:///C:/Users/Gadcuser/AppData/Local/Temp/Rar$Dla5552.33794/ADHS-2017-18-Complete-PDF-FINAL-ilovepdf-compressed-1.pdf)

Institute of Statistics (2018). National Population Survey, Violence against Women and Girls in Albania. Retrieved from <https://www.undp.org/content/dam/albania/NeëPublications/VAË%20Survey%202018.pdf>

Institute of Statistics. Men and Women in Albania 2018 and 2019. <http://www.instat.gov.al/en/about-us/activities/promotion-of-statistical-literacy/Women-and-men-in-albania-2018/>

International Labour Organization (ILO), 2016. Albania Decent Ëork Country Progame Document 2012 – 2015. https://www.ilo.org/budapest/countries-covered/albania/ËCMS_195198/lang--en/index.htm

Këshilli i Evropës, 2016. Inkurajimi i pjesëmarrjes së sektorit privat dhe medias në parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje: neni 17 i Konventës së Stambollit. <https://rm.coe.int/1680a48903>

Këshilli i Evropës. Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit). <https://rm.coe.int/168046246b>

Ligji Nr. 22/2018 Për Strehimin Social. <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/12/ligj-nr.-22-dt.-3.5.2018.pdf>

Ligji Nr. 111/2017 Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti. <https://www.drejtesia.gov.al/ëp-content/uploads/2019/02/LIGJ-nr.-111-2017-date-14.12.2017.pdf>

Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”. <http://special.aipa.al/ligji-nr-932014-per-perfshirjen-dhe-aksesueshmerine-e-personave-me-aftesi-te-kufizuara/>

Ligji Nr.9669, datë 18.12.2006, Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare (ndryshuar me ligjin nr.9914, datë 12.5.2008, nr.10 329, datë 30.9.2010, 47/2018, datë 23.7.2018. 125/2020). <https://www.parlament.al/Files/Akte/20201020140600ligj%20nr.%20125%20dt.%2015.10.2020.pdf>

NSGE 2021-2030. P. 69. https://shendetesia.gov.al/ëp-content/uploads/2022/02/ËEB_Strategjia-Kombetare-EN.pdf

OSCE, 2019. Mirëqenia dhe Siguria e Grave në Shqipëri. https://www.osce.org/files/f/documents/c/8/434849_1.pdf

Organization for Security and Co-operation in Europe (2019) Well-being and safety of women. Retrieved from [file:///C:/Users/Gadcuser/AppData/Local/Temp/Rar\\$Dla5552.5661/OSCE%20Report%20on%20Women%20ëellbeing%20and%20security .pdf](file:///C:/Users/Gadcuser/AppData/Local/Temp/Rar$Dla5552.5661/OSCE%20Report%20on%20Women%20ëellbeing%20and%20security .pdf)

Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025 (këtu e në vijim “PKVBPPRE 2021-2025”). <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/359>

Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025. <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/03/Plani-Kombetar-PAK- 2021-2025 AL.pdf>

Regional Research Promotion Programme (RRPP). (no date). Women’s inclusion in socio-economic life:

Republic of Albania. Employment and Skills Strategy 2014-2020. P. 46. Online: <https://shtetiëeb.org/wp-content/uploads/2014/02/Albania EMP-SKILLS-STRATEGY-February22.pdf>

SIDA, 2015. Gender Based Violence and Education. <https://cdn.sida.se/publications/files/-gender-based-violence-and-education.pdf>

Strategjia kombëtare e Arsimit 2021-2026. <https://arsimi.gov.al/ëp-content/uploads/2021/05/Draft-Strategjia-per-Arsimin-2021-2026-1.pdf>

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030. <https://shendetesia.gov.al/ëp-content/uploads/2022/02/WEB Strategjia-Kombetare-AL.pdf>

Taylor, A., 2021. 30% of murders in Albania in 2021 committed against Women and girls. Euractiv. https://www.euractiv.com/section/politics/short_news/30-of-murders-in-albania-in-2021-committed-against-Women-and-girls/

UN Women. (2016). Gender Brief: Albania. Online: <http://eca.unWomen.org/en/digital-library/publications/2016/10/albania-gender-brief>

UN Women. Analysis of the Functioning of the Coordinated Referral Mechanism of Cases of Domestic Violence at the Local Level in Albania, 2019. <https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/al/Analysis-of-the-Functioning-of-the-Coordinated-Referral-Mechanism-of-Cases-of-Domestic-Violence-at-the-Local-Level-in-Albania.pdf>

UN Women, 2021. Measuring the Shadow Pandemic: Violence Against Women during COVID-19. Albania Country Report. <https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2022-03/Measuring-shadow-pandemic-Albania.pdf>

UN Women, 2022. Measuring the shadow Pandemic of Violence Against Women. Albania Country Report. <https://albania.unWomen.org/sites/default/files/2022-03/Measuring-shadow-pandemic-Albania.pdf>

UNDP, 2018. Nowhere to turn. Gender-based violence against Roma Women. Report of a field study of Roma communities in Albania, Montenegro and the former Yugoslav Republic of Macedonia. https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/eurasia/NowhereToTurn_Roma_UNDP_RBEC.pdf

Vendimi Nr. 327, datë 2.06.2021, Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës. <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/07/VKM-Nr.-327-dat%C3%AB-2.06-00000002.pdf>

WAVE Network. 2019. Mapping of Sexual Violence Services in the Western Balkans and Turkey. UN Women. https://eca.unWomen.org/sites/default/files/Field%20Office%20ECA/Attachments/Publications/2019/11/ÈAVE_SVReport191119_web.pdf

Work With Perpetrators European Network. 2022. Summary of adopted GREVIO reports relevant for Perpetrator Programmes (PP) for domestic and gender-based violence. https://www.work-with-perpetrators.eu/fileadmin/WWP_Network/redakteure/Istanbul_GREVIO/GREVIO/Adopted_Grevio_Reports.pdf

World Bank. 2019. Compendium of International and National Legal Frameworks on Domestic Violence. <https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/31146/CompendiumDomesticViolencePt2.pdf?sequence=3&isAllowed=y>

World Health Organization, 2021. <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/violence-against-Women>